

Pse shumica e grave janë banore të Xhehennemit

Abdulaziz esh-Shenavi

ABDUL-AZIZ ESH-SHENAVI

PSE SHUMICA NGA GRATË JANË BANORE TË XHEHENNEMIT

Titulli i origjinalit:

En-nisa ektheru ehlin-nar

Përktheu:

Osman Abazi

Lektor:

Muhamet Reçica

Korrektor:

Osman Abazi

Ballina:

Lulzim Islami

Mob: 044 640-318

osmanabazi@hotmail.com

web-site: ardhmeriaislame.info

Ndalohet rreptësisht botimi i këtij libri pa lejen e përkthyesit

Botimi i dytë

Thevabin e këtij libri ia bëj hedije shpirtit të Muhammedit s.a.v.s., familjes së tij, shokëve të tij, të gjithë evliave dhe dijetarëve të sinqertë të ummetit tonë dhe shpirtrave të prindërve të mi.

O All-llah, pranoje prej nesh.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha:

“Shikova Zjarrin (Xhehennemin), e pashë se shumica e banorëve të tij ishin gra dhe shikova në Xhennet, e pashë se shumica e banorëve të tij ishin fukaratë.” (transmetuan Buhariu dhe Muslimi nga Umran Ibn Husajni).

Fjala e përkthyesit

Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve dhe paqja e Tij qoftë me njeriun më të mirë, me të Dërguarin e fundit të All-llahut, Muhammedin s.a.v.s., me familjen, shokët dhe pasuesit e tij.

Muhammedi s.a.v.s. tha: **“Nuk lashë pas vete sprovë më të madhe për burrat se sa gratë.”**

Isha në Mekke në Haxhë dhe duke vizituar disa nga libraritë e saja më ra në sy libri me titull “Pse shumica nga gratë janë banore të Xhehennemit”. Posa e pashë, e bleva menjëherë, me shpresë se do të jetë një libër i begatshëm dhe i nevojshëm për popullin tonë. Dhe pasi që e lexova,

vendosa që ta përkthej në gjuhën tonë, duke e parë nevojën e madhe të popullit tonë për të.

Të gjithë ne jemi dëshmitarë se gruaja muslimane shqiptare ka arritur në një pikë shumë të ulët të moralit. Derisa ajo më herët ishte e ruajtur, e mbrojtur, e mbuluar dhe e moralshme, sot ajo ka humbur edhe pikën e fundit të marrës, është bërë lojë me të cilën luajnë njerëzit, sikurse luajnë fëmijët me top, duke e hedhur atë nga një dorë në tjetrën, përveç atyre që All-llahu i madhërishtëm i ka mbrojtur.

All-llahu i madhërishtëm i mbrojti të drejtat e grave kur ato i konsideronin si shtazë, i blenin dhe i shitnin dhe bisedohej se a është ajo njeri apo shejtan. Ai zbriti një prej sureve (kaptinave) më të gjata me emrin e tyre “En-Nisa – Gratë” dhe i mbrojti të drejtat e tyre edhe në shumë kaptina të tjera të Kur’anit. Prandaj, nuk duhet të mashtrohemi me thirrjet bashkëkohore, të cilat në veçanti vijnë nga Perëndimi, kinse për të drejtat e femrave, sepse me to, në të shumtën e rasteve, është për qëllim zhveshja e gruas prej çdo morali, tërheqja e saj në fushën e imoralitetit dhe shfytëzimi i saj për devijimin e muslimanëve nga feja e drejtë dhe e pastër.

Mjafton njeriu të shikojë gjendjen e gruas në shumë vende perëndimore dhe të kuptojë se në çfarë gjendje të mjerueshme ka arritur ajo. Por, kjo nuk do të thotë se asaj nuk i janë mohuar edhe shumë të drejta edhe në shumë vende muslimane, gjë që ka ndodhur vetëm për një arsye: **nga mospraktikimi i parimeve kur’anore dhe të Sunnetit të Muhammedit s.a.v.s. në to.**

Ky libër nuk është për t’i demoralizuar gratë, apo për t’ua humbur shpresën atyre, por është vërejtje dhe qortim për atë që do t’u ndodhë në këtë dhe në botën e ardhme, po qe se largohen nga rruga e All-llahut të madhërishtëm. E mendoj se në këtë libër ka këshilla të mjaftueshme për të mençurit dhe për ata që ia kanë frikën Krijuesit të kësaj Gjithësie. Unë porosis që ky libër i mrekullueshëm të merret shumë seriozisht nga të gjithë, e posaçërisht nga nënat, vajzat dhe motrat tona.

All-llahu i madhërishtëm e shpërbleftë me Xhennetin Firdevs atë që ndihmon përhapjen, botimin, komunikimin dhe shpërndarjen e këtij libri, e All-llahu e shpërbleftë me shpërblimin më të mirë edhe autorin e tij.

“All-llahu thotë të vërtetën dhe Ai udhëzon në rrugën e drejtë”.

Lutja jonë e fundit është: *“Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të botëve”.*

ZJARRI - XHEHENNEMI

Përshkrimi i Zjarrit:

Erdhi një ditë Xhibrili a.s. te i Dërguari s.a.v.s. në një kohë që nuk i vinte atij më herët. Ai i doli përpara dhe i tha: **“O Xhibril, ç’është me mua që po të shoh me pamje (ngjyrë) të ndryshuar”?** Xhibrili a.s. i tha: “Nuk erdha te ti para se All-llahu i madhërishtëm urdhëroi për çelësat e Zjarrit”. I

Dërguari i All-llahut s.a.v.s. i tha: **“O Xhibril, ma përshkruaj Zjarrin dhe më trego pamjen e Xhehennemit”!** Xhibrili a.s. i tha: **“All-llahu i madhërishëm urdhëroi që Xhehennemi të ndizet një mijë vjet derisa u zbardh, pastaj urdhëroi të ndizet një mijë vjet të tjera derisa u skuq dhe pastaj urdhëroi që të ndizet edhe një mijë vjet të tjera derisa u nxi, e ai është i zi dhe i errët, nuk ndriçojnë gacat e tij dhe nuk fiket flaka e tij. Pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën, sikur të hapet nga Xhehennemi një vrimë sa maja e gjilpërës, do të vdisnin nga nxehtësia e tij të gjithë ata që janë në tokë, pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën, sikur një teshë e teshave të Zjarrit të virret në mes të qiellit dhe tokës, do të vdisnin nga nxehtësia e tij të gjithë ata që janë në tokë, sikur një rojë nga rojat e Xhehennemit t’u shfaqej banorëve të tokës dhe ata ta shikonin atë, do të vdisnin të gjithë ata nga pamja e tij e shëmtuar dhe era e tij e qelbur, pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën, sikur një hallkë e hallkave të zinxhirëve të banorëve të Zjarrit, të cilat All-llahu i përshkruajti në Kur’an, të vendoset mbi malet e tokës, do t’i coptonte ato dhe nuk do të ndalej derisa të depërtonte në tokën më të ulët.”**

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. i tha: **“Më mjafton, o Xhibril, që të mos coptohet zemra ime dhe të vdes”.**

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. e shikoi Xhibrilin, e pa se ai po qante dhe i tha: **“A po qan, o Xhibril, kurse ti e ke atë pozitë të lartë të All-llahu”?**

Xhibrili a.s. u përgjigj: **“E përse të mos qaj? Unë e meritoj më tepër të qaj, sepse në diturinë e All-llahut mund të jem në një gjendje tjetër nga ajo që jam tani, ku ta di, ndoshta sprovohem ashtu sikurse është sprovuar Iblisi, i cili ishte nga sundimtarët (një prej xhindëve) dhe ku ta di, ndoshta sprovohem ashtu sikurse u sprovuan Haruti dhe Maruti.”**

Atëherë qajti i Dërguari i All-llahut s.a.v.s., qajti Xhibrili a.s. dhe vazhduan të qajnë përderisa nuk thirri një thirrës: **“O Xhibril, o Muhammed, All-llahu ju ka siguruar ju të dyve që ta kundërshtoni Atë”.** Pas kësaj u ngrit Xhibrili në qiell. I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. me këtë rast kaloi pranë disa ensarëve (banorët e Medinës), të cilët qeshnin dhe po luanin, e u tha: **“A qesheni, kurse pas jush është Xhehennemi?! Sikur ju të dini atë që unë e di, do të qeshnit pak, do të qanit shumë, nuk do të mund ta gëlltitnit ushqimin e pijen dhe do të dilnit nëpër kodrina duke vajtuar për All-llahun e madhërishëm.”** Atëherë dikush thirri: *“O Muhammed, mos ua humb shpresën robërve të Mi, në të vërtetë të kam dërguar lehtësues dhe nuk të kam dërguar vështirësues.”* Atëherë i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Përforconi dhe afroni.”** (transmetoi Taberani në El-Evset prej Omer Ibnul-Hattabit).

Tha i Sinqerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s.: **“Zjarri juaj, ky është një pjesë e shtatëdhjetë pjesëve të zjarrit të Xhehennemit dhe sikur ai të mos fikej**

me ujë dy herë, askush nuk do të kishte në të dobi.” (transmetoi Ibn Maxhe prej Enesit).

Pishtari ndriçues s.a.v.s. tha:

“Zjarri juaj ky, të cilin e nder i biri i Ademit, është një pjesë e shtatëdhjetë pjesëve të nxehtësisë së Xhehennemit”. Thanë: “Pasha All-llahun, ky na është i mjaftueshëm o i Dërguar i All-llahut”! U përgjigj s.a.v.s.: **“Atij i është dhënë përparësi për gjashtëdhjetë e nëntë pjesë, ku çdo pjesë e tij është e ngjashme me nxehtësinë e asaj pjese.”** (transmetoi Muslimi nga Ebu Hurejre).

Ai i cili nuk flet me hamendje s.a.v.s. tha: **“Kush gënjen për mua me qëllim, le t’i përgatisë vetes një ulëse para dy syve të Xhehennemit”. I thanë: “O i Dërguar i All-llahut, a ka ai sy”? Ai u përgjigj: “A nuk e dëgjuat All-llahun e madhërishëm duke thënë: “Kur ai (Xhehennemi) i sheh ata prej së largu, i dëgjon atij edhe vëlimin edhe kërhamzën e tij”** (kaptina El-Furkan : 12), dhe tha: **“Do të dalë një qafë nga Zjarri, e cila ka dy sy që sheh dhe gjuhë që flet, e thotë: Jam përcaktuar për çdonjërin që i ka shoqëruar All-llahut zot tjetër, ajo i sheh ata më mirë se sa shpendët, të cilat e vrojtojnë kokrrën e susamit dhe i gëlltit ata.”**

Në transmetimin e Tirmidhiut përmendet se ajo qafë, e cila del nga Zjarri thotë: **“Unë jam përcaktuar për tre persona: për çdo tiran kryeneç, për çdonjërin që i është lutur ndonjë zoti përveç All-llahut dhe për skulptorët.”** (transmetoi Muslimi prej Ebu Hurejres).

ËSHTË RRETHUAR XHENNETI ME VËSHTIRËSI DHE ËSHTË RRETHUAR ZJARRI ME EPSHE

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha:

“Kur All-llahu e krijoi Xhennetin dhe Zjarrin, e dërgoi Xhibrilin në Xhennet dhe i tha: Shikoje atë dhe shiko atë që kam përgatitur për banorët e tij.” Ai shkoi dhe shikoi atje atë që ka përgatitur aty për banorët e tij, pastaj u kthi dhe tha: **“Pasha fuqinë Tënde, kushdo që dëgjon për të, do të hyjë në të.”** Atëherë All-llahu urdhëroi që ai të rrethohet me vështirësi dhe i tha: **“Kthehu atje dhe shiko atë që kam përgatitur aty për banorët e tij”.** Ai u kthye atje dhe e gjeti atë të rrethuar me vështirësi, pastaj u kthye tek Ai dhe i tha: **“Pasha fuqinë Tënde, kam frikë se nuk do të arrijë të hyjë aty askush”.** Atëherë All-llahu i tha: **“Shko te Zjarri dhe shiko atë që kam përgatitur për banorët e tij”.** Ai pa aty zjarrin duke ngrënë zjarrin, pastaj u kthye dhe tha: **“Pasha fuqinë Tënde, kushdo që dëgjon për të, nuk do të hyjë aty”.** Atëherë All-llahu urdhëroi që ai të rrethohet me epshe dhe tha: **“Kthehu o Xhibril atje dhe shiko.”** Ai u kthye dhe tha: **“Pasha fuqinë Tënde, kam frikë se nuk do të shpëtojë pa hy aty askush.”** (transmetoi Tirmidhiu prej Ebu Hurejres).

DISKUTIMI NDËRMJET XHENNETIT DHE ZJARRIT

Ai të cilit i është dhënë tubimi i fjalëve s.a.v.s. tha:

“Diskutuan Xhenneti dhe Zjarri, e Xhenneti tha: te unë hyjnë të dobëtit dhe të varfërit. Kurse Zjarri tha: te unë hyjnë tiranët dhe mendjemëdhentë. All-llahu Zjarrit i tha: ti je dënimi im, hakmirrem me ty kundër atij që dëshiroj. Kurse Xhennetit i tha: ti je mëshira ime, e mëshiroj me ty atë që Unë dëshiroj.” (transmetoi Tirmidhiu prej Ebu Hurejres).

Muhammedi s.a.v.s. poashtu tha:

“U grindën Xhenneti dhe Zjarri te Zoti i tyre, e Xhenneti tha: o Zot ç’është me mua që tek unë hyjnë vetëm të dobëtit e njerëzve dhe masa e ulët e tyre? Kurse Zjarri tha: ç’është me mua që tek unë hyjnë vetëm tiranët dhe mendjemëdhentë? All-llahu Xhennetit i tha: ti je mëshira ime, e mëshiroj me ty atë që Unë dëshiroj. Kurse Zjarrit i tha: ti je dënimi im, e dënoj me ty atë që Unë dëshiroj dhe që të dyve do t’u mbushi. Për Xhennet krijon ata që dëshiron, kurse në Zjarr nuk i bën mizori askujt nga krijesat e Tij dhe kur ata hedhën aty, ai thotë: a ka më. Kështu derisa Zoti të vendosë aty të gjithë së bashku (ata që janë për Zjarr), atëherë ai mbushet, mbështillet zjarri me zjarr dhe thotë: kurrë, kurrë, kurrë.” (transmetuan Buhariu dhe Daru Kutuniu prej Ebu Hurejres r.a.).

ANKESA DHE TË FOLURIT E ZJARRIT

U ankua Zjarri te Zoti i tij dhe tha: **“O Zot, një pjesë imja e ha pjesën tjetër. Atëherë All-llahu i caktoi atij dy frymëmarrje: një frymëmarrje në Dimër dhe një frymëmarrje në Verë, frymëmarrja e tij në Dimër është ngricë, kurse frymëmarrja e tij në Verë është vapë.”**(transmetuan Buhariu dhe Tirmidhiu prej Ebu Hurejres r.a.).

Sahabiu i ndritur Ebu Hurejre - Abdurr-Rahman Ibn Sahr - r.a. tha: Ishim me të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s. kur ai dëgjoi një rënie të rëndë, pastaj na tha: **“A e dini ç’është kjo?”** Thamë: **All-llahu dhe i Dërguari i Tij janë më të ditur.** Pastaj tha: **“Kjo rënie ishte një rënie e një guri, i cili është hedhur në Zjarr para shtatëdhjetë vjetëve dhe ai rrokullisej në Zjarr derisa tani arriti fundin e tij.”** (transmetoi Muslimi prej Ebu Hurejres r.a.).

XHEHENNEMI ËSHTË ME SHKALLË (të cilat janë teposhtë)

All-llahu i madhërishëm thotë: *“Njemend munafikët (dfytyrshët) janë në shkallët më të ulëta të Zjarrit...”* (kaptina En-Nisa : 145).

Pra, Zjarri është shtatë shkallë, pozita apo kate.

All-llahu në Kur'an thotë "edrak" e nuk thotë "derexhat", sepse arabët për çdo gjë që lëshohet teposhtë i thanë "edrak", kurse për ato që ngjiten lart i thanë "derexhat", prandaj për Xhennetin thotë "derexhat", ndërsa për Zjarrin thotë "edrak". Munafikët janë në shkallët më të ulëta të Zjarrit, e ajo është fundrrina, si shkak i mosbesimit të ashpër të tyre dhe si shkak i shumë dëmtimeve dhe tradhtive që u bënë besimtarëve.

Ndonjëherë pozitat e Zjarrit dhe shkallët e tij përmenden me emrin "derexhat", sikurse thotë All-llahu i madhërishëm kur përmendi banorët e Xhennetit dhe të Zjarrit: *"... për të gjithë ata ka shkallë (derexhat) sipas asaj që kanë punuar..."* (kaptina El-En'am : 132). Poashtu, All-llahu i madhërishëm thotë: *"A mund të jetë i barabartë ai që ndoqi kënaqësinë e All-llahut me atë që arriti hidhërimin e Tij dhe vend i tij është Xhehennemi, e sa përfundim i keq që është ai. Të gjithë ata kanë shkallë (derexhat) tek All-llahu..."* (kaptina Ali Imran : 161-162).

DYERT E XHEHENNEMIT

All-llahu i madhërishëm thotë: *"Ai i ka shtatë dyer..."* (kaptina El-Hixhr : 44). D.m.th. ato janë kat mbi kat. Një ditë Ali Ibn Ebu Talibi r.a. i pyeti shokët e tij: a e dini se si janë dyert e Xhehennemit? Ata thanë: janë si dyert tona. Ebul-Haseni r.a. tha: jo, ato janë kështu njëra mbi tjetrën. Tha'lebiu shtoi: pastaj vendosi njëren dorë mbi tjetrën: All-llahu vendosi Xhennetet mbi tokë dhe zjarret mbi njëri-tjetrin, e më i ulëti i tyre është Xhehennemi, pastaj mbi këtë është El-Hutame, pastaj Sekari, pastaj El-Xhehimi, pastaj Ledha, pastaj Es-Seir dhe mbi këtë është El-Havije. Pastaj çdo kat është më i nxehtë se ai më lart për shtatëdhjetë herë.

Një ditë i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. falej i vetmuar në Xhaminë e tij, aty kaloi një beduine, e cila u lidh pas tij, duke mos e ditur ai, atëherë ai e këndoi këtë ajet: *"Ai (Xhehennemi) i ka shtatë dyer, çdo derë e tij ka pjesën e ndarë (që do të hyjë në të)." (kaptina El-Hixhr : 44).* Pasi që beduinja e dëgjoi këtë ajet, i ra të fikët dhe i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. dëgjoi rënien e saj, e ndërpreu namazin, kërkoi ujë, të cilin ia hodhi asaj në fytyrë derisa asaj i erdhë vetëdija dhe u ul, atëherë i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. e pyeti: **"Oj filane, ç'është me ty?"**. Beduinja tha: Këtë që këndove është nga Libri i All-llahut, apo diç nga vetja jote? Ebul-Kasimi s.a.v.s. u përgjigj: **"Oj beduine, kjo ishte nga Libri i zbritur i All-llahut"**. Atëherë beduinja tha: Pra, çdo pjesë e trupit tim do të dënohet në një derë të tij. I Sinqerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. i tha: **"Oj beduine, çdo derë e tij ka pjesën e caktuar, pronarët e çdo dere do të dënohen aty sipas veprave të tyre"**. Beduinja tha: Pasha All-llahun, unë jam grua e varfër, nuk kam pasuri, unë nuk kam tjetër përveç shtatë robërve, o i Dërguar i All-llahut, ty të bëj dëshmitar se

çdonjërin nga robërit po i vendosi në njërën nga dyert e Xhehennemit dhe ata janë të lirë për hirë të All-llahut.

Xhibrili a.s. erdh me të shpejtë tek ai dhe i tha: **“O i Dërguar i All-llahut, përgëzoje beduinen se All-llahu e fali atë, ia ndaloi asaj shtatë dyert e Xhehennemit dhe ia hapi tetë dyert e Xhennetit”**.

Dyert e Xhehennemit janë nga hekuri, shtroja e tyre është me therra, mbulesa e tyre është errësira, toka e tyre është nga bakri, plumbi dhe xhami, zjarri është mbi ta dhe nën ta, mbi ata ka hije të zjarrit dhe nën ta ka po asi hije, ndërsa distanca nga një derë deri te tjera është sa udhëtimi pesëqind vjet. I Gjithfuqishmi dhe i Urti i përshkruajti se ato janë të mbyllura për banorët e tij, e thotë: *“Vërtet ato (dyert) u janë atyre të mbyllura fort.”* (kaptina El-Humeze : 8).

FUNDRINA E XHEHENNEMIT

Ai i cili nuk flet me hamendje s.a.v.s. tha:

“Vërtet guri i madh hidhet nga buza e Xhehennemit, duke u rrokullisur aty shtatëdhjetë vjet dhe nuk arrin fundin e tij.” (transmetuan Nesaiu dhe Tirmidhiu prej Utbe Ibn Gazevanit).

Poashtu ai s.a.v.s. tha: **“Sikur një gur të hidhet në Xhehennem, do të rrokullisej në të shtatëdhjetë vjeshta para se të arrijë fundin e tij.”** (transmetuan Ibn Hibani dhe El-Bejhekiu prej Ebu Musa El-Eshariut).

Poashtu vula e të gjithë pejgamberëve s.a.v.s. tha: **“Njëmend, njeriu e flet një fjalë të cilën nuk e konsideron të rëndë, rrëshqet me të në Zjarr shtatëdhjetë vjeshta.”** (transmetuan imam Ahmedit dhe Tirmidhiu prej Ebu Hurejres r.a.).

NËNTËMBËDHJETË ROJAT E XHEHENNEMIT

All-llahu i madhërishëm thotë: *“Mbi atë (Zjarrin) vigjëlojnë nëntëmbëdhjetë”* (kaptina El-Muddeththir : 30).

Është thënë se ata janë: nëntëmbëdhjetë mijë melekë, duke u bazuar në fjalën e All-llahut të madhërishëm: *“E Ne nuk e bëmë numrin e tyre, përveç se sprovë për ata që nuk besuan...”* (El-Muddeththir : 31).

Është thënë se ata janë: nëntë melekë, në dorën e secilit ka çekan me dy degë, kur me të godet, e hedh të goditurin shtatëdhjetë mijë vjeshta.

Disa hebrenj u thanë disa shokëve të Muhammedit s.a.v.s.: a e di i Dërguari juaj se sa është numri i rojave të Xhehennemit? Ata thanë: nuk e dimë derisa nuk e pyesim atë. Një njeri erdhi tek i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. dhe i tha: o Muhammed, u mundën sot shokët e tu. Ebul-Kasimi s.a.v.s. pyeti: **“E si u mundën ata?”**. Ai tha: disa hebrenj i pyetën ata se a e di i Dërguari juaj numrin e rojave të Xhehennemit? Vula e të gjithë pejgamberëve s.a.v.s. tha: **“E çfarë thanë ata?”**. Ai u përgjigj: ata thanë:

ne nuk dimë derisa të mos e pyesim të Dërguarin tonë. I Dërguari mëshirë për të gjitha botërat s.a.v.s. tha: **“Nuk munden ata të cilët janë pyetur për atë që nuk e dinë, e thanë: ne nuk dimë derisa ta pyesim të Dërguarin tonë, ndërsa ata (hebrenjtë) e pyetën të Dërguarin e tyre, Musain a.s. dhe i thanë: na paraqit All-llahun haptazi. M’i sillni armiqtë e All-llahut, unë do t’i pyes ata për tokën e Xhennetit, e cila është miell i pastër i bardhë”**. E kur ata erdhën, thanë: o Ebul-Kasim, sa është numri i rojave të Xhehennemit? I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Kaq dhe kaq”**, duke sinjalizuar një herë dhjetë dhe një herë nëntë. Ata thanë: po. I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Çfarë është toka e Xhennetit?”**. Ata heshtën, pastaj thanë: simite, o Ebul-Kasim. I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Simite prej miellit të pastër të bardhë”** (transmetoi Tirmidhiu prej Xhabirit).

VLIMI I XHEHENNEMIT ÇDO DITË NË GJYSMË TË DITËS

Pishtari ndriçues s.a.v.s. i tha sahabiut të ndritur Safvan Ibn El-Muattal r.a.: **“Kur të lindë dielli, falu derisa ai të nivelohet me kokën tënde sa një shtizë, e kur ai të nivelohet me kokën tënde, atëherë ajo është koha kur vlon Xhehennemi dhe hapen dyert e tij derisa ai të shmanget nga krahu yt i djathtë.”** (transmetuan Ibn Maxhe, imam Ahmedi dhe Hakimi në El-Mustedrek).

Sahabiu i ndritur Ebu Hurejre r.a. tha: I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Kur të ashpërsohet nxehtësia, ta ftohni atë me namaz, sepse nxehtësia e ashpër është prej frymës së Xhehennemit.”** (transmetuan Buhariu dhe Muslimi).

Ebul-Kasimi s.a.v.s. i tha sahabiut të ndritur Amr Ibn Abese r.a.: **“Fale namazin e Sabahut, pastaj ndërpreje faljen e namazit derisa të lindë dielli dhe të ngritet, sepse ai lind në mes të dy brinjëve të shejtanit dhe atëherë i bëjnë sexhde (përrulje) pabesimtarët, pastaj falu, sepse namazi në atë kohë është i dëshmuar derisa hija të shkurtohet sa një shtizë, pastaj prapë ndërpreje faljen e namazit, sepse atëherë vlon Xhehennemi dhe kur hija të kalojë përpara, atëherë falu.”** (transmetoi Muslimi).

Xhehennemi do të vlojë në Ditën e Kijametit, All-llahu i madhërishëm thotë: *“Dhe kur Xhehennemi të ndizet (të skuqet apo të vlojë)”* (kaptina Et-Tekvir : 12). Ai ndizet për shkak të gjynaheve të njerëzve dhe si shkak i hidhërimit të All-llahut.

Poashtu Xhehennemi do të vlojë kur banorët e tij hyjnë aty, All-llahu i madhërishëm thotë: *“Sa herë që Xhehennemi të pushojë, Ne i shtojmë atij ndizjen (flakën, vlimin)”* (kaptina El-Isra : 97).

ZEMËRIMI DHE FISHKËLLIMA E XHEHENNEMIT

I Gjithëfuqishmi dhe i Urti thotë: “...e Ne për ata që nuk besojnë Ditën e Gjykimit, kemi përgatitur zjarr të fortë. Që posa ai t’i shohë ata nga një vend i largët, i dëgjojnë atij zemërimin dhe fëshkëllimen” (kaptina El-Furkan : 11-12).

Dhe All-llahu i madhërishëm thotë: “Dënimi në Xhehennem është edhe për ata që nuk i besuan Zotit të tyre; sa vend i keq është ai! Kur të hidhen në të, ata do t’ia dëgjojnë atij kërhamzën e ai vlon. Nga zemërimi, ai gati copëtohet...” (kaptina El-Mulk : 6-8).

LËNDËT DJEGËSE TË TIJ JANË NJERËZIT DHE GURËT

Lëndët djegëse të Xhehennemit janë gurët nga squfuri, ata që nuk besuan dhe ata që i shoqëruan Atij që është Një dhe i Vetmi. Është thënë se gurët janë idhujtë të cilët janë adhuruar përveç All-llahut: “Ju, dhe ajo që adhuroat ju pos All-llahut, do të jeni lëndë e Xhehennemit dhe keni për të hyrë në të. Sikur të kishin qenë ata zota, ata nuk do të hynin në të, po që të gjithë do të jenë aty përgjithmonë” (kaptina El-Enbija : 98-99).

ZINXHIRËT DHE PRANGAT E XHEHENNEMIT

Ai i cili dëgjon dhe di çdo gjë thotë: “Ne për jobesimtarët kemi përgatitur zinxhirë, pranga e zjarr të ndezur” (kaptina El-Insan : 4).

Poashtu Ai thotë: “... dhe Ne u vëmë prangat në qafat e atyre që nuk besuan...” (kaptina Sebe’ : 33).

All-llahu i madhërishëm dhe i Vërtetë thotë: “Se me të vërtetë te Ne ka pranga e zjarr. Edhe ushqim që nuk gëlltitet edhe dënim të dhimbshëm”. (El-Muzzemmil : 12-13).

Ato pranga janë në qafat dhe në këmbët e tyre.

Ibn Abbasi për ata zinxhirë tha: ata futën në analin e tij derisa të dalin nga goja e tij dhe pastaj renditën në atë zinxhirë sikurse renditën kërmijtë në shkop për t’u pjekur.

Kurse Sufjani dhe Mukatili thanë: na ka arritur se zinxhirët hyjnë në anal dhe dalin për gojët e tyre.

Është thënë edhe se: ata mbështillen për qafën e tyre dhe tërhiqen zvarrë me to.

Në disa transmetime është përmendur se: ata hyjnë në anal dhe u dalin për vrimat e hundës së tyre.

Në një transmetim është thënë se: ata hyjnë në gojën e tij dhe i dalin për anal, e ai i thërret shokët e tij: a më njihni mua? Ata i thonë: jo, por ne jemi duke parë poshtërimin tënd, e kush je ti? Ai u thotë shokëve të tij: unë jam filani, për çdonjërin nga ju do të ketë dënim të ngjashëm.

All-llahu i madhërishëm thotë: *“U thuhet Zebanive: kapnie atë, vënia prangat! Pastaj atë shtinie në Xhehennem. Mandej, lidhene atë me një zinxhir të gjatë shtatëdhjetë kut.”* (kaptina El-Hakka : 30-32).

Pabesimtarin e sulmojnë njëqind mijë melekë, ia bashkojnë duart e tij në qafë “vënia prangat” e “pastaj atë shtinie në Xhehennem” dhe “pastaj lidhene atë me një zinxhir të gjatë shtatëdhjetë kut”, vetëm All-llahu e di se për çfarë kuti është fjala, por Ibn Abbasi r.a. tha: shtatëdhjetë kut me kut të melekut.

Është thënë edhe se: çdo kut është sa shtatëdhjetë kut dhe çdo kut më i gjatë se prej këtu e deri në Mekke (folësi ishte në Kufe).

Kurse Mukatili tha: Sikur një hallkë e tij të vendosej në maje të malit, ai do të shkrihej si shkrihet plumbi.

Ndërsa Ka’bi tha: Një hallkë e tij është sa gjithë hekuri i kësaj bote.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. kërkonte strehim te All-llahu nga Zjarri, zinxhirët, prangat, nxehtësia dhe gjembat e tij.

KAMXHIKËT E BANORËVE TË ZJARRIT

I Vërteti dhe i Madhërishmi thotë: *“Për ata janë edhe kamxhikët e hekurtë.”* (kaptina El-Haxh : 21). I godasin dhe i shtyjnë me ta. Është thënë: ata janë kamxhikë të zjarrtë.

I Dërguari i All-llaht s.a.v.s. tha: **“Në dorën e çdo meleku nga rojat e Xhehennemit ka nga një kamxhik me dy degë, kur me të godet, e hedh të goditurin shtatëdhjetë mijë.”**

MËNYRA SE SI HYJNË BANORËT E ZJARRIT NË ZJARR

Në Ditën e Kijametit do t’i takojë Xhehennemi njerëzit si yjet dhe ata do të ikin nga ai, atëherë All-llahu i madhërishëm thotë: ktheni ata tek ai. Dhe ata do t’i kthejnë, e kjo është fjala e të madhërishmit: *“Përkujto ditën kur nga frika ktheheni të ikni, e nuk ka kush që ta prapësojë prej jush dënimin e All-llahut...”* (kaptina Gafir : 33).

Ai i pret ata me flakë dhe xixa para se të hyjnë aty pabesimtarët, e cila gjë ua humb të parit, e kështu ata hyjnë aty të verbër dhe me pranga në duar, këmbë dhe qafat e tyre.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Mes dy krahërorëve të rojave të Xhehennemit është sa mes Lindjes e Perëndimit”.**

Omer Ibnul-Hattabi r.a. tha: **“Përkujtojuani atyre Zjarrin e ndoshta do ta njohin atë, sepse nxehtësia e tij është e ashpër, fundi i tij është shumë thell, pija e tij është qelbësira dhe kamxhikët e tij janë nga hekuri.”**

GJARPËRINJTË DHE SKORPIONËT E XHEHENNEMIT

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Në Zjarr ka gjarpërinj si devet me qafa të gjata, kur ndonjëri nga ata kafshon pabesimtarët, e gjen helmin e tij deri në katërdhjetë vjeshta. Poashtu në Zjarr ka skorpionë të mëdhenj sa mushkët, kur ndonjëri nga ata kafshon pabesimtarin, ai e gjen helmin e tij deri në katërdhjetë vjet.”** (transmetoi Ahmedi prej El-Harth Ibn Ez-Zubejdi).

EL-VEJLU – MJERIMI

I Gjithëdijshmi dhe i Gjithinformuari thotë: *“Atë ditë është shkatërrim (Vejlun) për ata që përgënjeshtroan”* (kaptina El-Murselat : 15). d.m.th. dënim dhe poshtërim për ata që përgënjeshtroan All-llahun, të dërguarët e Tij, Librat e Tij dhe Ditën e ndarjes.

EL-VEJLU: është një luginë në Xhehennem, në të cilën ka lloje të ndryshme të dënimit.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“M’u paraqit mua Xhehennemi, e nuk pashë luginë më të madhe aty se sa El-Vejlu”.**

Poashtu është transmetuar se El-Vejlu është vendtubimi i qelbësirës dhe ndytësirës së banorëve të Zjarrit, ajo pra është shportë e qelbësirave të pabesimtarëve dhe idhujtarëve që kështu të kuptojnë të mençurit se nuk ka gjë më të ndytë, më të qelbur, më të idhët dhe më të errët se sa ajo.

USHQIMI I BANORËVE TË ZJARRIT

I Madhërishmi thotë: *“Ata nuk kanë ushqim tjetër, pos një barishte me ferra helmuese. Që as nuk jep fuqi, as nuk largon uri.”* (kaptina El-Gashije : 6-7).

Ed-Dari’ë: Është një lloj barishte me therra, e ngjitur për tokë, nuk i afrohet asaj asnjë shtazë dhe nuk e hanë, helmi i saj është vrasës dhe është prej ushqimeve më të këqija.

Është thënë edhe se: ajo është pemë nga zjarri.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Do t’ u hidhet banorëve të Zjarrit, me ç’rast largohen ata nga dënimi në të cilin janë, ata atëherë do të kërkojnë ndihmë dhe do t’u jepet ushqim nga barishta me ferra helmuese, që as nuk japin fuqi, e as nuk largojnë uri. Ata prapë kërkojnë ushqim, e u dhurohet ushqim që u mbetet në fyt, atyre u kujtohet se këtë botë e përbinin duke pirë ujë, kështu që kërkojnë ujë, atyre u shfaqet uji i valë me grepa të hekurt, e kur uji i valë u afrohet fytyrave të tyre, ua pjek ato, e kur ai depërton në barqet e tyre, ua këput çdo gjë në barqet e tyre. Atëherë ata thonë: na i thirrni rojat e Xhehennemit, të cilët u thonë: “A nuk u patën arritur juve të dërguarit tuaj me argumente të qarta?” Ata përgjigjen: Po (na kanë ardhur)!” E pra,**

lutuni ju vetë, po lutja e jobesimtarëve është asgjë!” (kaptina Gafir : 50).

Pastaj thonë: na e thirrni Malikun, të cilit i thonë: *“O Malik, le të na heqë qafe Zoti yt!”*. Ai përgjigjet: *“Ju do të mbeteni aty.”*

El-A'meshi tha: jam informuar se mes kërkesës së tyre dhe përgjigjes së Malikut do të kalojnë një mijë vjet.

Pastaj do të thonë: thirrne Zotin tuaj, sepse askush nuk është më i mirë se Zoti juaj, e thonë: *“O Zoti ynë, ne na patën mundur të këqijat dhe si të tillë ishim popull i humbur! Zoti ynë, na nxjerr prej tij, e nëse gabojmë përsëri, atëherë, vërtet, jemi mizorë!”* (kaptina El-Mu'minin : 106-107). E përgjigjja për ta është: *“...heshtni aty, e mos më folni!”*.

Ebud-Derdai r.a. tha: Atëherë do të humbin shpresën për çfarëdo të mire dhe këtu fillojnë të vajtojnë, të pendohen dhe të mallkojnë veten e tyre. (transmetoi Tirmidhiu).

All-llahu i madhërishëm thotë: *“Se me të vërtetë te Ne ka pranga e zjarr. Edhe ushqim që nuk gëlltitet edhe dënim të dhembshëm.”* (kaptina El-Muzzemmil : 12-13).

Ibn Abbasi r.a. tha: “Ushqim që nuk gëlltitet”, ushqim me ferra që ngjitet për fyt, as nuk depërton në brendësi, e as nuk nxirret jashtë.

All-llahu i madhërishëm thotë: *“Pastaj ju, o të humbur e gënjeshtarë! Keni për të ngrënë prej pemës Zekumë! Prej saj keni për t'i mbushur barqet! E menjëherë pas do të pini prej ujit të vluar! Do të pini si deveja e etshme!”* (kaptina El-Vakia : 51-55).

I Madhërishmi thotë: *“A kjo pritje (me shpërblim prej All-llahut) është më e mirë, apo pema e Zekumit.”* (kaptina Es-Saffat : 62).

Poashtu i Madhërishmi thotë: *“Është e vërtetë se pema e Zekumit do të jetë ushqim i mëkatarëve. Vlon si katrani në barqe. Ashtu si vlon uji i valë.”* (kaptina Ed-Duhan : 43-46).

Dhe i Madhërishmi thotë: *“Ajo është një pemë që mbin në fund të Xhehennemit. Frutat e saj janë sikurse koka dreqërish. E ata do të hanë nga ajo dhe do të mbushin barqet prej saj. Pastaj, ata do të kenë kundrejt atij ushqimi edhe ujë të valë”* (kaptina Es-Saffat : 64-67).

Pema e Zekkumit është pema e mallkuar në Kur'an.

Ajo është një pemë që rrënjët i ka në fund të Xhehennemit, ajo rritet me flakën e zjarrit, ashtu sikurse rritet pema me ujë të ftohtë, prandaj banorët e zjarrit, të cilët janë mbi të, patjetër do të zbresin dhe të hanë nga ajo.

Kur njeriu merr diçka nga pema e Zekkumit, ajo merr nga ai po aq.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Sikur një pikë e pemës Zekkum të pikë në këtë botë, do t'ua prishte jetën banorëve të tokës, e si do të jetë me atë që është ushqim i tyre.”** (transmetuan imam Ahmedi, Tirmidhiu, Hakimi dhe Bejhekiu).

All-llahu i madhërishëm thotë: *“Ai sot nuk ka këtu ndonjë mik. As ushqim tjetër përveç të të shplarave”* (kaptina El-Hakka : 35-36).

Tha Hereviu: El-Gislin (të shpëlarat) është ndryshku i banorëve të Zjarrit dhe ajo që rrjedh prej trupave të tyre.

All-llahu i madhërishëm thotë: *“Ky është ujë i valë dhe i ndyrë; le ta shijojnë atë!”* (kaptina Sad : 57).

Ibn Rezini tha: El-Gassak (i ndyrë) është ajo që rrjedh prej ndytësirave të tyre.

Është thënë: El-Gassak është qelbë i trashë me erë shumë të keqe.

Abdullah Ibn Omeri r.a. tha: El-Gassak është qelbi i trashë, sikur një pikë e tij të bjerë në Perëndim, do të qelbëte banorët e Lindjes, e sikur të bjerë në Lindje, do të qelbëte banorët e Perëndimit.

Poashtu është thënë: El-Gassak është të ftohtit e rëndë, i cili nuk mund të përballohet.

Ka’bi r.a. tha: El-Gassak është një burim në Xhehennem, ku tubohen djersët e çdo gjëje të djersitur. Në atë vend të ndytë fundoset njeriu dhe i bie lëkura, mishi dhe eshtrat e tij dhe ai tërheq mishin e tij sikurse e tërheq njeriu teshën e tij.

PIJA E BANORËVE TË ZJARRIT

All-llahu i madhërishëm thotë: *“...e nëse kërkojnë shpëtim, ndihmohen me një ujë si katran që përzhitë fytyrat...”* (kaptina El-Kehf : 29).

I Dërguari i All-llahut s.av.s. tha për fjalën e All-llahut “ujë si katran”: **“Ai është si katrani i valë, kur e afron fytyrën e tij, i bie lëkura e fytyrës në të”** (transmetoi Tirmidhiu prej Ebu Seidit).

Poashtu All-llahu i madhërishëm thotë: *“...mbi kokat e tyre hidhet ujë të valët”* (kaptina El-Haxh : 20).

Tha Muhammedi s.a.v.s.: **“Ujë të valë hidhet mbi kokat e tyre dhe ai depërton deri në brendësinë e tij, pastaj ai tërheq me vete çdo gjë nga brendësia e tij derisa të dalë për këmbët e tij, e kjo është shkrirja, pastaj i rikthehen ashtu si kanë qenë”** (transmetuan Tirmidhiu dhe Hakimi nga Ebu Hurejre).

All-llahu i madhërishëm thotë: *“...në të cilin i jepet ujë të ndyrë (që rrjedh prej lëkurave të djegura). Përpiqet ta përbijë, po nuk mund ta gëlltisë atë...”* (kaptina Ibrahim : 16-17). D.m.th. i jepet ujë i ndyrë me erë shumë të keqe dhe i trashë, të cilin ai nuk mund assesi ta përbijë. I Vërteti thotë: *“... dhe u shuhet etja me ujë të valë që ua copton zorrët e tyre”* (kaptina Muhammed : 15).

El-Hamim është: uji i valët me zjarr të Xhehennemit, i cili përzihet me atë ujë në barqet e banorëve të Zjarrit, i cili ua copton zorrët e tyre dhe ua shkapërderdh lëkurat, sikurse thotë i Gjithëfuqishmi dhe i Urti: *“Që me atë u shkrihet krejt ç’ka në barqet e tyre, e edhe lëkurat”* (kaptina El-Haxh : 20).

TESHAT E BANORËVE TË ZJARRIT

All-llahu i madhërishëm thotë: *“E idhujtarët atë ditë i sheh të lidhur në pranga. Petkat e tyre janë nga katrani (pezhgveja – zifti), kurse fytyrat e tyre do t’i mbulojë zjarri”* (Ibrahim : 49-50).

D.m.th. petkat e tyre do të jenë prej katrani, i cili do t’ua mbulojë atyre lëkurat e tyre derisa të bëhet si këmishë, është përmendur katrani në veçanti si shkak i ndezjes së shpejtë të tij dhe se ai ka erë shumë të keqe dhe ngjyrë të egër. Arabët e lyenin me katan deven e zgjebosur.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Vajturesja (mbi të vdekurin), e cila nuk pendohet para vdekjes së saj, do ringjallet në Ditën e Kijametit e veshur me petkë të katranit dhe me një këmishë të zgjebosur.”** (transmetoi Muslimi prej Ebu Malik El-Eshariut).

Dhe thotë i Madhërishmi: *“... e atyre që nuk besuan u qepën rroba prej zjarri e u hudhet uji i valë mbi kokat e tyre”* (kaptina El-Haxhixh : 19).

Banorëve të Zjarrit u janë qepur teshat nga zjarri sipas madhësisë së trupave të tyre.

Është thënë se: ato tesha janë nga bakri i shkrirë, i cili është bërë zjarr.

Sahabiu i ndritur Semurete Ibn Xhundub tha: i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Disa do t’i kaplojë zjarri deri në gjunjët e tyre, disa deri në belin e tyre, disa deri në qafat e tyre dhe disa do t’i kaplojë zjarri deri në fytyrën e tyre”** (transmetoi Muslimi).

SHTRETËRIT E BANORËVE TË ZJARRIT

All-llahu i madhërishëm thotë: *“Për ata është përgatitur shtrat nga zjarri dhe mbulojë (nga zjarri). E kështu pra i shpërblejmë zullumqarët”* (kaptina El-A’rafë : 41).

D.m.th. se ata kanë shtretër nga zjarri dhe mbuloja nga zjarri.

Poashtu i Madhërishmi thotë: *“Se ata do të kenë shtresa të zjarrit edhe sipër edhe përfundi...”* (kaptina Ez-Zummer : 16).

I quajti ato “dhulel – hije”, sepse ato i mbulojnë ata që janë nën to, d.m.th. në kate, shtresa, mbulojë dhe shtretër. I quajti ato hije duke u përqeshur me ta, sepse ato janë djegëse, kurse hijet mbrojnë prej zjarrit sikurse thotë All-llahu i madhërishëm: *“Shkoni tek ajo hije (mjegull) që ka tri degëzime. Që nuk bën as hije, as nuk mbron prej flakës”* (kaptina el-Murselat : 30-31).

TË QAJTURIT E BANORËVE TË ZJARRIT

I Singerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: **“O ju njerëz, qani, e nëse nuk qani bëhuni kinse po qani, sepse banorët e Zjarrit do të qajnë aq shumë derisa lotët e tyre do të kalojnë nëpër fytyrat e tyre si të jenë kanale, do**

t'u ndërpriten atyre lotët dhe do t'u rrjedhë gjak, i cili do të hapë burime, e sikur anijet të lëshoheshin aty do të lundronin".

Poashtu ai i cili nuk flet me hamendje s.a.v.s. tha: **"Do t'u lëshohet vajtimi banorëve të Zjarrit dhe do të qajnë derisa t'u ndërpriten lotët, pastaj do t'u rrjedhë atyre gjak derisa të bëhen kanale në fytyrat e tyre sikur anijet të lëshoheshin aty, do të lundronin"** (transmetoi Ibn Maxhe prej Enes Ibn Malikut).

DËNIMI MË I ULËT NË MESIN E BANORËVE TË ZJARRIT

Imami i çdo të mire s.a.v.s. tha: **"Njeriu me dënimin më të ulët, në mesin e banorëve të Zjarrit në Ditën e Kijametit, është një njeri të cilit i vendosen nën shputat e tij dy gaca, nga të cilat i vlon truri i tij."** (transmetoi Muslimi prej En-Nu'man Ibn Beshiri).

Ebul-Kasimi s.a.v.s. tha: **"Njeriu me dënimin më të ulët, në mesin e banorëve të Zjarrit në Ditën e Kijametit, është një njeri të cilit i vendosen nën shputat e tij dy gaca, nga të cilat i vlon truri i tij, ashtu sikurse vlon vekshi me ujin e tij."** (transmetuan Buhariu, Tirmidhiu, Muslimi prej En-Numan Ibn Beshirit).

Ibn Abbasi r.a. tha: i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **"Njeriu me dënimin më të ulët nga banorët e Zjarrit është Ebu Talibi - xhaxhai i Muhammedit a.s. - të cili do t'i mbathen dy nalle, nga të cilat do t'i vlojë truri i tij."** (transmetoi Muslimi).

MADHËSIA E BANORËVE TË ZJARRIT DHE PAMJA E KEQE E TYRE

Vula e të gjithë pejgamberëve s.a.v.s. tha: **"Sikur një njeri nga banorët e Zjarrit të nxirret në këtë botë, do të vdesnin banorët e tokës nga pamja e egër dhe nga aroma e ndytë e tij."** (transmetoi Ibn Ebud-Dun'ja prej Ibn Omerit).

Sahabiu i ndritur Ebu Hurejre r.a. tha: Largësia në mes të dy krahërorëve të pabesimtarit (në Xhehennem) është sa udhëtimi tri ditë i kalorësit të shpejtë (transmetuan Buhariu dhe Muslimi prej Ebu Hurejres).

Ai i cili nuk flet me hamendje s.a.v.s. tha: **"Do të zmadhohen banorët e Zjarrit në zjarr derisa në mes të pulpit të veshit të ndonjërit nga ata deri te qafa e tij do të jetë sa udhëtimi shtatëqind vjet, kurse trashësia e lëkurës së tij do të jetë shtatëdhjetë kut dhe dhëmballa e tij do të jetë sa kodra e Uhudit."** (transmetuan imam Ahmedi dhe Taberani prej Ebu Hurejres).

ASHPËRSIA E DËNIMIT PËR GJYNAHQARËT

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Njerëzit me dënimin më të ashpër në Ditën e Kijametit do të jenë skulptorët.”** (transmetoi Muslimi prej Ibn Mesudi).

Poashtu ai i cili nuk flet me hamendje s.a.v.s. tha: **“Nga njerëzit me dënimin më të ashpër në Ditën e Kijametit do të jetë edhe dijetari të cilit nuk i ka bërë All-llahu dobi me diturinë e tij”.**

Ibnul-Mubareku tha:

Tre persona u bëjnë dëm banorëve të Zjarrit, e të gjithë banorët e Zjarrit janë në dëm, e ata janë disa njerëz të cilët janë mbyllur në tabuta prej zjarrit dhe ata gjenden në fund të Xhehennemit, kur ata të bërtasin do të ngriten zërat e tyre mbi krejt banorët e Zjarrit, e ata u thonë: për çfarë arsye veprohet me ju kështu, në dallim prej të gjithë banorëve të Zjarrit? Thonë: ne ishim mendjemëdhenj. Të dytët janë disa njerëz, të cilëve u janë shqyer barqet e tyre dhe i tërheqin zorrët e tyre në zjarr, e u thonë banorët e Zjarrit: për çfarë arsye veprohet me ju kështu në dallim prej të gjithë banorëve të Zjarrit? Thonë: ne i ndërprenim të drejtat e njerëzve me betimet dhe besën tonë. Të tretët janë disa njerëz, të cilët vrapojnë pa u ndalur në mes të Xhehennemit dhe ujit të valë, të cilëve u thonë: për çfarë arsye veprohet me ju kështu, në dallim prej të gjithë banorëve të Zjarrit? Thonë: ne vraponim në mes të njerëzve duke bartur fjalët (nemime).

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha:

“Katër persona do t’u bëjnë dëm banorëve të Zjarrit me gjithë dëmin në të cilin gjinden ata, ata janë njerëz të cilët vrapojnë në mes të ujit të valë dhe Xhehennemit, të cilët mallkojnë veten dhe vajtojnë. Banorët e Zjarrit i thonë njëri-tjetrit: ç’është me këta të cilët na dëmtojnë me gjithë dëmin në të cilin gjendemi? I pari është një njeri, i cili është mbyllur në tabut prej zjarrit, i dyti është një njeri, i cili tërheq zorrët e tij, i tretë është një njeri, të cilit i rrjedh goja e tij qelb dhe gjak dhe i katërti është një njeri, i cili han mishin e tij! I thuhet pronarit të tabutit: ç’është puna me këtë të largët, i cili na dëmton me gjithë dëmin në të cilin gjendemi? Thotë: ky i largëti vdiq duke pasur në qafën e tij pasuri të njerëzve të cilat nuk i kreu (nuk ishte besnik në to). Pastaj i thuhet atij i cili tërheq zorrët e tij: ç’është puna me këtë të largët, i cili na dëmton me gjithë dëmin në të cilin gjendemi? Thotë: këtij të largëtit nuk i interesonte se ku e lagtte urina dhe pastaj nuk pastrohej. Pastaj i thuhet atij të cilit i rrjedh goja qelb dhe gjak: ç’është puna me këtë të largët, i cili na dëmton me gjithë dëmin në të cilin gjendemi? Thotë: ky i largëti shikonte çdo fjalë të ndytë (të pamoralshme) e të keqe, e pëlqente atë dhe i pëlqente amoraliteti. Pastaj i thuhet atij, i cili hante mishin e tij: ç’është puna me këtë të largët, i cili na dëmton me gjithë dëmin në të cilin gjendemi? Thotë: ky i largëti hante mishrat e njerëzve duke bërë gibet (duke i përmendur

njeriut atë që ai e urren) dhe duke i bartur fjalët (nemime)."
(transmetoi Ebu Neimi prej Ismail Ibn Ijash).

DËNIMI PËR ATA TË CILËT I KANË DËNUAR NJERËZIT NË KËTË BOTË

Ai i cili nuk flet me hamendje s.a.v.s. tha: **"Njerëzit me dënimin më të ashpër në Ditën e Kijametit do të jenë ata që më së shumti i kanë dënuar njerëzit në këtë botë."** (transmetoi Ebu Davud Et-Tajalisi prej Halid Ibn Velidit).

DËNIMI I ATIJ QË URDHËROI TË MIRAT, E NUK I BËRI VETË DHE NDALOI NGA TË KËQIJAT, E I BËRI VETË

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **"Do të vihet me njeriun dhe do të hidhet në zjarr, aty ai do të bluhet sikurse bluan gomari me bluarsen e tij, rreth tij sillen banorët e Zjarrit dhe i thonë: o filan, a nuk je ti ai që urdhëroje në vepra të mira dhe ndaloje nga veprat e këqija?! Thotë: unë urdhëroja në vepra të mira, por vetë nuk i veproja dhe ndaloja nga të këqijat, por vetë i bëja."** (transmetoi Buhariu prej Usame Ibn Zejdit).

Shëruesi i zemrave dhe i mendjeve s.a.v.s. tha: **"Do të vihet me njeriun në Ditën e Kijametit dhe do të hidhet në zjarr, atëherë do t'i dalin zorrët prej barkut të tij dhe do të sillet në zjarr, sikurse sillet gomari me gurin blurës të tij, tubohen rreth tij banorët e Zjarrit e i thonë: o filan i biri filanit, ç'është me ty? A nuk je ti ai që na urdhëroje në vepra të mira dhe na ndaloje nga veprat e këqija? Thotë: gjithqysh, unë jam ai, unë u urdhëroja në vepra të mira, por vetë nuk i bëja dhe ndaloja nga të këqijat, por vetë i bëja."** (transmetoi Muslimi prej Usame Ibn Zejdit).

Imami i çdo të mire s.a.v.s. tha: **"Natën e Isras kalova afër disa njerëzve, të cilëve u shkëputnin buzët e tyre me dana të zjarrit, sa herë që ato u shkëputeshin, ua kthenin prapë në gjendjen e parë, thashë: kush janë këta, o Xhibril? Tha: ligjëruesit, d.m.th. nga ata të cilët i urdhëronin njerëzit në të mira, kurse veten e harronin dhe ata e lexonin Librin".**

Muhammedi s.a.v.s. tha: **"Nga njerëzit me dënimin më të ashpër në Ditën e Kijametit është dijetari, të cilit nuk i ka bërë dobi All-llahu me diturinë e tij".**

Ebul-Kasimi s.a.v.s. poashtu tha: **"Ata të cilët urdhërojnë njerëzit në të mira, kurse veten e harrojnë, do t'i tërheqin zorrët e tyre në zjarrin e Xhehennemit, u thuhet atyre: kush jeni ju? Thonë: ne ishim ata që i urdhëronim njerëzit në të mira, kurse veten e harronim".**

PËRQESHJA ME BANORËT E ZJARRIT

All-llahu i madhërishëm thotë: “... *All-llahu përqeshet me ta...*” (kaptina El-Bekare : 15).

Do t’u thuhet banorëve të Zjarrit, duke qenë ata në zjarr: dilni nga aty; u hapën atyre dyert e Zjarrit, e kur të arrijnë tek ato, u mbyllën në fytyrat e tyre, atëherë do të qeshin me ta besimtarët dhe ky është kuptimi i fjalës së All-llahut të madhërishëm: “*Sot ata të cilët kanë besuar qeshen me pabesimtarët.*” (kaptina El-Mutaffifun : 34).

PËRHERSHMËRIA E BANORËVE TË ZJARRIT NË ZJARR

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: “**Kur banorët e Xhennetit të hyjnë në Xhennet dhe banorët e Zjarrit në Zjarr, do të vihet me vdekjen e cila do të vendoset në mes të Xhennetit dhe Zjarrit dhe pastaj do të therret ajo. Pastaj një thirrës do të thërret: o banorë të Xhennetit, ju aty do të jeni përgjithmonë dhe nuk do të vdisni dhe, ju o banorë të Zjarrit, aty do të jeni përgjithmonë e nuk do të vdisni. Atëherë banorëve të Xhennetit do t’u shtohet gëzimi me gëzimin që e kanë dhe do t’u shtohet banorëve të Zjarrit pikëllimi me pikëllimin që e kanë.**” (transmetoi Muslimi prej Ibn Omerit).

Poashtu vula e të gjithë pejgamberëve tha: “**Kur banorët e Xhennetit të hyjnë në Xhennet dhe kur banorët e Zjarrit të hyjnë në Zjarr, do të vihet në Ditën e Kijametit me vdekjen si të ishte një dash i përhimtë, i cili do të vendoset në mes të Xhennetit dhe Zjarrit, e thuhet: o banorë të Xhennetit: a e njihni këtë? Atëherë ata zgjaten dhe shikojnë, e thonë: po, kjo është vdekja. Pastaj thuhet: o banorë të Zjarrit, a e njihni këtë? Ata zgjaten dhe shikojnë, e thonë: po, kjo është vdekja. Atëherë urdhërohet që ajo të therret, pastaj thuhet: o banorë të Xhennetit, ju aty do të jeni përgjithmonë dhe nuk do të vdisni e, o ju banorë të Zjarrit, ju aty do të jeni përgjithmonë dhe nuk do të vdisni**”. Pastaj i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. e këndoi këtë ajet: “*Ti tërhiq atyre vërejtjen për ditën e dëshpërimit, kur të marrë fund çështja, kurse ata janë në huti, ata nuk janë duke besuar.*” (kaptina Merjem : 39). **Pastaj sinjalizoi me dorën e tij kah kjo botë.**” (transmetoi Muslimi prej Ebu Seid El-Hudriu).

KUR U KRIJUA ZJARRI U FRIKËSUAN MELEKËT, DERISA U DRIDHËN ZEMRAT E TYRE

Ibn Mubareku tha: kur u krijua Zjarri (Xhehennemi), u frikësuan melekët derisa u dridhën zemrat e tyre, por kur All-llahu krijoi Ademin, ju qetësuan ato atyre dhe u kaloi ajo gjendje.

Mejmun Ibn Mehrani tha: kur All-llahu krijoi Xhehennemin, e urdhëroi të lëshojë një kërhamëz, saqë nuk mbeti asnjë melek në shtatë qiejt, përveçse ra me fytyrën e tij (në sexhde), atëherë Mbizotëruesi i madhërishëm u tha: ngritni kokat tuaja, a nuk e dini se Unë ju krijova juve që të më bindeni dhe të më adhuronit, kurse Xhehennemin e krijova për kundërshtarët në mesin e krijesave të Mia, e ata thanë: o Zoti ynë, ne nuk jemi të sigurt nga ai derisa mos t'i shohim banorët e tij, e kjo është fjala e të Madhërishmit: “... dhe ata ndaj madhërisë së Zotit të tyre kanë frikë.”

Pra, zjarri është dënim i All-llahut dhe askujt nuk i lejohet që me të të dënojë, prandaj dhe i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ndaloi atë duke thënë: **“Mos dënoni me dënimin e All-llahut.”**

QAJTJA GJATË PËRMENDJES SË ZJARRIT DHE FRIKA NGA AI

Erdhë Xhibrili a.s. te i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. bashkë me Israfilin a.s., të cilët i dhanë selam të Dërguarit s.a.v.s., e Israfil a.s. ishte me krahëror të përulur dhe me pamje të frikësuar, e i Dërguari s.a.v.s. tha: **“O Xhibril, çfarë është me mua që Israfilin e shoh me krahëror të përulur dhe me pamje të frikësuar?”** Xhibrili a.s. u përgjigj: **pak më parë, kur ai zbriti, iu shfaq një pamje e shpejtë e Xhehennemit, prandaj e sheh ti atë me krahëror të përulur.”** (transmetoi Taberani).

Transmetohet se një djalosh të Ensarëve (banorët e Medinës) e kaploi frika e dhikrit, ai qante kur përmendej Zjarri, derisa edhe mbyllej në shtëpi dhe këtë ia përmendën të Dërguarit s.a.v.s., i cili shkoi në shtëpinë e tij. Kur i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. hyri tek ai, ai e përqafoi atë dhe ra i vdekur, atëherë i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Përgatitne shokun tuaj, sepse frika prej Zjarrit ia coptoi mushkëritë e tij.”**

Transmetohet se Isai a.s. kaloi pranë katër mijë grave me pamje të frikësuar, të veshura me këmisha nga lëkura dhe leshi, të cilave u tha: çfarë është ajo që u ndryshoi pamjet, o grumbull i grave? Thanë: përmendja e Zjarrit na ndryshoi pamjen tonë, o biri i Merjemes, vërtet ai që hyn në Zjarr nuk do të shijojë aty as gjumë, e as pije. (transmetoi El-Haraiti në “Libri i varrezave”).

Kur sahabiu i ndritur Selman El-Farisiu r.a. e dëgjoi fjalën e All-llahut të madhërishëm: *“E s’ka dyshim se Xhehennemi është vendpremtimi i të gjithë atyre.”* (kaptina El-Hixhr : 43). Ai iku për tri ditë nga frika duke mos kuptuar asgjë. Kur e kthyen atë te i Dërguari i All-llahut s.a.v.s., ai e pyeti për këtë, e ai tha: o i Dërguar i All-llahut, zbriti ky ajet i All-llahut të madhërishëm: *“E s’ka dyshim se Xhehennemi është vendpremtimi i të gjithë atyre”*, e pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën peygamber, ky ajet ma ka coptuar zemrën time. Atëherë All-llahu i madhërishëm zbriti ajetet: *“E s’ka dyshim se të devotshmit do të jenë në Xhennete dhe burime.”* (kaptina El-Hixhr : 45).

ATA TË CILËT I LUTEN ALL-LLAHUT PËR XHENNETIN DHE KËRKOJNË STREHIM TEK AI PREJ ZJARRIT

I Singerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: “Ai që i lutet All-llahut tri herë për Xhennet, Xhenneti thotë: o Zot, të lutem fute atë në Xhennet. Kurse ai që kërkon strehim tek All-llahu prej Zjarrit tri herë, Zjarri thotë: o Zot, të lutem strehoje atë prej Zjarrit.” (transmetoi Tirmidhiu prej Enesit).

Shëruesi i zemrave dhe i mendjeve s.a.v.s. tha: “Kur është ndonjë ditë e nxehtë, All-llahu dëgjon dhe shikon banorët e qiellit dhe të tokës, e nëse rob i thotë: La ilahe il-lAll-llah - nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut - sa e nxehtë që është kjo ditë, o Zot, të lutem më streho nga zjarri i Xhehennemit, atëherë All-llahu i thotë Xhehennemit: një rob Imi kërkoi strehim tek Unë prej teje, ti pra, dëshmo se Unë e strehova atë. E nëse është ndonjë ditë shumë e ftohtë, All-llahu dëgjon dhe i shikon banorët e qiellit dhe të tokës, e nëse rob i thotë: La ilahe il-lAll-llah, sa e ftohtë që është kjo ditë, o Zot, të lutem më streho prej ngricës së Xhehennemit. Atëherë All-llahu i thotë Xhehennemit: një rob Imi kërkoi strehim tek Unë prej teje dhe prej ngricës tënde, ti pra, dëshmo se e strehova atë.” Thanë: e ç’është ngrica e Xhehennemit? El-Mustafaja (i zgjedhuri) s.a.v.s. tha: “Ajo është një humnerë, në të cilën hedhet pabesimtari dhe në të cilën i ndahen pjesët e trupit nga njëra-tjetra si shkak i të ftohtit të madh.” (transmetoi Bejhekiu prej Ebu Hurejres).

SHUMICA E BANORËVE TË ZJARRIT JANË GRA

I Dërguari analfabet, arab, hashimit dhe kureshit s.a.v.s. tha: “U ndala në derë të Xhennetit dhe pashë se shumica e atyre që hynin në të ishin të varfërit, e aty pashë të pasurit (apo ata që ishin në pozita të larta) të ngujuar, përveç pronarëve të zjarrit, të cilët u urdhëruan të dërgohen në Zjarr. Pastaj u ndala në derë të Zjarrit dhe pashë se shumica e atyre që hynin në të ishin gra.” (transmetuan Ahmed i dhe Nesaiu prej Usame Ibn Zejdi).

Atij që iu dha tubimi i fjalëve s.a.v.s. tha: “M’u shfaq Zjarri dhe pashë se shumica e banorëve të tij ishin gra të cilat mohojnë”. Dikush pyeti: a e mohojnë ato All-llahun? Ai s.a.v.s. tha: “E mohojnë bashkëshortin dhe e mohojnë bamirësinë, nëse ndonjëri nga ato i bënë mirë tërë kohën, pastaj sheh te ti diç jo të mirë. Thotë: kurrë hajr prej teje nuk kam parë.” (transmetuan Buhariu dhe Maliku prej Ibn Abbasit).

Shëruesi i zemrave dhe i mendjeve s.a.v.s. tha: “O grumbull i grave, jepni lëmoshë, sepse unë ju pashë, si shumicë të banorëve të Zjarrit, ju e

shpeshtoni mallkimin, e mohoni të mirën e bashkëshortit dhe nuk kam parë me mendje dhe fe të mangët, të cilat e marrin zemrën e njeriut të vendosur më shumë se ndonjëra nga ju.” Thanë (gratë): e ç’është mangësia e mendjes dhe fesë sonë? Ai s.a.v.s. tha: “A nuk është dëshmia e një gruaje sa gjysma e dëshmisë së një burri (dëshmia e një mashkulli është sa e dy grave)? E kjo pra, është mangësia e mendjes së saj. Dhe kur ajo ka menstruacione a nuk falet dhe a nuk agjëron? E kjo pra, është mangësia e fesë së saj.” (transmetuan Muslimi prej Ebu Seidit, Ibn Maxhe prej Abdullah Ibn Omerit dhe Hakimi prej Ibn Mes’udit).

Ndërmjetësuesi dhe atij që i pranohet ndërmjetësimi s.a.v.s. tha: “O grumbull i grave, ju vërtet jeni shumica e lëndëve djegëse të Xhehennemit, sepse kur juve u jepet, nuk falënderoni, kur sprovoheni, nuk bëni durim, kur nuk u jepet, ankoheni dhe ruajuni të mos i mohoni bamirësitë, e tillë është gruaja e cila është me një burrë, tek i cili i ka lindur dy apo tre fëmijë, e thotë: nuk kam parë prej teje hajr kurrë.” (transmetoi Taberani prej Esma bintu Jezid).

Udhëzuesi dhe përgëzuesi s.a.v.s. tha: “O grumbull i grave, jepni lëmoshë edhe qoftë prej stolive tuaja, sepse ju jeni shumica e banorëve të Xhehennemit, ju e shpeshtoni mallkimin, e mohoni bashkëshortin dhe nuk kam parë me fe dhe mendje më të mangët, të cilat sundojnë burrat e rëndësishëm në çështjet e tyre, se sa gratë. Mangësia e mendjes së tyre shprehet në dëshminë e dy grave, e cila është sa dëshmia e një burri, kurse mangësia e fesë së tyre shprehet në atë se ndonjëra nga ato rrinë duke mos i bërë asnjë sexhde All-llahut aq ditë dhe net sa All-llahu dëshiron.” (transmetoi Hakimi prej Abdullah Ibn Mes’udit).

I Dërguari i mëshirës s.a.v.s. tha: “Prej nëntëdhjetë e nëntë grave, një grua në Xhennet, kurse të tjerat në Zjarr. Kur gruaja muslimane mbetet me barrë, ajo ka shpërblimin e agjëruesit (të çdo dite), falësit (gjatë tërë ditës), muhimit (atij që është në ihram) dhe të Muxhahidit (luftëtarit) në rrugën e All-llahut derisa të lindë dhe qysh në gjidhënjën e parë ajo ka shpërblimin e jetës së një shpirti.” (transmetoi Ebush-Shejh prej Abdullah Ibn Abbasit).

Abdullah Ibn Abbasi tha: U nxi dielli në kohën e të Dërguarit s.a.v.s., me ç’rast ai fali një namaz, në të cilin qëndroi në këmbë gjatë afër leximit të kaptinës El-Bekare, pastaj bëri një ruku të gjatë, u ngrit dhe qëndroi në këmbë pak më pak se qëndrimi i parë, pastaj bëri një ruku të gjatë pak më pak se rukuja e parë, bëri sexhde, pastaj qëndroi me një qëndrim të gjatë pak më pak se qëndrimi i parë, bëri një ruku të gjatë pak më pak se rukuja e parë, pastaj qëndroi në këmbë me një qëndrim të gjatë pak më pak se qëndrimi i parë, bëri një ruku pak më të shkurtë se rukuja e parë, pastaj bëri sexhde dhe u largua kur dielli kishte dalë, atëherë ai tha: “**Dielli dhe hëna**

janë dy nga argumentet e All-llahut, nuk nxinën ato për vdekjen e askujt e as për lindjen e askujt, e kur ju ta shihni këtë, përkujtone All-llahun”. Thanë: o i Dërguar i All-llahut, të pamë se more diçka nga vendi yt, pastaj të pamë se u ktheve mbrapa.

Ebul-Kasimi s.a.v.s. tha: “Unë e pashë Xhenetin dhe e zgjata dorën të marrë një kalavesh, e sikur ta këputja atë, ju do të hanit nga ai sa të mbetet kjo botë, pastaj e pashë Zjarrin dhe nuk kisha parë pamje më të trishtueshme se sa sot dhe pashë se shumica e banorëve të tij ishin gra.” Thanë: për çfarë, o i Dërguar i All-llahut? Ai s.a.v.s. tha: “Sepse ato mohojnë,” dikush tha: e mohojnë All-llahun? Ai s.a.v.s. tha: “E mohojnë bashkëshortin dhe mohojnë bamirësinë, sikur ndonjëres nga ato t’i bësh mirë tërë kohën, pastaj ajo sheh diç jo të mirë te ti, thotë: kurrë prej teje hajr nuk kam parë.” (transmetoi Buhariu prej Ibn Abbasit).

Përgëzuesi dhe qortuesi s.a.v.s. tha: “O ju gra, jepni lëmoshë, sepse shumica juaj jeni lëndë djegëse e Xhehennemit, sepse ju shpeshtoni ankesat, mallkimin dhe mohoni bashkëshortin.” (transmetuan Buhariu, Muslimi dhe Nesaiu prej Xhabirit).

Poashtu ai s.a.v.s. tha: “O ju gra, jepni lëmoshë se ju jeni shumica e banorëve të Zjarrit, sepse ju shpeshtoni mallkimin dhe mohoni bashkëshortin.” (transmetoi Sumevejhi prej Hizam Ibn Halalit ky prej babait të tij).

Ebul-Kasimi s.a.v.s. poashtu tha: “Jepni lëmoshë, o ju gra, edhe qoftë prej stolive tua, meqë ju jeni shumica e banorëve të Zjarrit, sepse ju shpeshtoni mallkimin dhe mohoni bashkëshortin.” (transmetoi imam Ahmedi prej Ibn Mes’udit).

PSE GRATË JANË SHUMICA E BANORËVE TË ZJARRIT?

Më pak gra do të hyjnë në Xhenet, e më shumë prej tyre do të hyjnë në Zjarr dhe kjo si shkak i epshit dhe animet kah zbukurimet e kaluara të kësaj bote, të cilat mbisundojnë ato, si shkak i mendjes së cekët të tyre që të shikojnë kah bota e ardhshme, kështu që dobësohen në punën për botën e ardhme dhe përgatitjen për të dhe, si shkak i animet kah kjo botë, zbukurimi me të dhe për të, pastaj megjithëkëtë ato janë nga shkaqet kryesore të kësaj bote, të cilat i largojnë burrat nga bota e ardhshme si shkak i dëshirës dhe lakmisë që kanë për to. Shumica e tyre janë refuzuese të botës së ardhshme me veten e tyre, larguese të të tjerëve nga ajo, të mashtruara shpejt nga thirrësit të cilët refuzojnë fenë dhe të ngadalshme në përgjigjen ndaj atyre që i ftojnë në botën e ardhme.

Shëruesi i zemrave dhe i mendjeve s.a.v.s. tha: **“Unë nuk lashë pas meje sprovë më të dëmshme për burrat sesa gratë.”** (transmetuan imam Ahmedi dhe Tirmidhiu prej Usames).

Poashtu ai s.a.v.s. tha: **“Janë zhdukur burrat kur u janë bindur grave.”** (transmetuan imam Ahmedi, Taberani dhe Hakimi prej Ebu Bekrete).

Ai i cili nuk flet me hamendje s.a.v.s. poashtu tha: **“Burrat do të vazhdojnë të jenë në hajr përderisa nuk u binden grave.”** (transmetoi Ed-Daru Kutuni prej Sehl Ibn Sa’dit).

GRATË - BANORE TË ZJARRIT

I Singerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: **“Dy lloj njerëzish, të cilët janë banorë të Zjarrit, ende nuk i kamë parë: disa njerëz të cilët mbajnë me vete kamxhik të ngjashëm me bishtat e lopëve i rrahin njerëzit me to (thuhet se është fjala këtu për policinë diktatoriale) dhe disa gra të veshura, të deshura, joshëse dhe ecin duke u picëlluar, kokat e tyre si gungat e shtrembura të deveve, ato nuk do të hyjnë në Xhennet, e as nuk do ta nuhatin aromën e tij, kurse aroma e tij arrin nga largësia kaq e kaq.”** (transmetuan Muslimi dhe imam Ahmedi prej Ebu Hurejre).

Poashtu ai që nuk flet me hamendje s.a.v.s. tha: **“Shikova Xhennetin dhe pashë se shumica e banorëve të tij ishin të varfërit, pastaj shikova Zjarrin dhe pashë se shumica e banorëve të tij ishin të pasurit dhe gratë.”** (transmetoi Ibn Ahmedi prej Abdullah Ibn Omerit).

Pishtari ndriçues s.a.v.s. tha: **“Hyra në Xhennet dhe pashë se shumica e banorëve të tij ishin pasardhësit e besimtarëve dhe të varfërit dhe pashë se gratë dhe të pasurit ishin pakicë.”** (transmetoi Henadi prej Hiban Ibn Ebi Xhebele).

Me një paradite Ebul-Kasimi s.a.v.s. u tha shokëve të tij: **“Të prishurit janë banorë të Zjarrit”,** thanë: o i Dërguar i All-llahut, kush janë të prishurit? Ai s.a.v.s. tha: **“Gratë”,** i thanë: a nuk janë ato nënat, vajzat dhe motrat tona? I Dërguari rahmet për të gjitha botërat s.a.v.s. tha: **“Gjithqysh, por kur atyre u jep, nuk falënderojnë dhe kur sprovohen, nuk durojnë.”** (transmetuan imam Ahmedi, Taberani dhe Hakimi prej Abdurr-Rahman Ibn Shibliti).

GRA, TË CILAVE U ËSHTË NDALUAR XHENNETI

Tha Muhammedi s.a.v.s.: **“Cilado grua e cila kërkon prej burrit të saj shkurorizim pa asnjë arsye, e ka të ndaluar edhe aromën e Xhennetit.”**

(transmetuan imam Ahmedi, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe, Ibn Hibani dhe Hakimi prej Thevban-it).

Vula e të gjithë peygamberëve s.a.v.s. poashtu tha: **“Nëse gruaja kërkon shkurorizim nga burri i saj në atë kohë kur nuk duhet, nuk do të gjejë as aromën e Xhenetit, kurse aroma e tij arrin sa udhëtimi dyzet vjet.”** (transmetoi Ebu Davudi prej Abdullah Ibn Abbasit).

GRA TË MALLKUARA

El-Lanu (mallkimi): përzënia dhe largimi prej mirësisë dhe rahmetit të All-llahut.

Muhammedi s.a.v.s. tha: **“E ka mallkuar All-llahu gruan që u përngjan burrave.”** Err-Rrexhile: është gruaja e cila mundohet t’u përngjajë burrave në të menduarit dhe njohjen e tyre, në këtë kontest është edhe ky hadith: **“Vërtet Ajshja ishte me mendim burrëror, në mesin e grave.”** (transmetoi Ebu Davudi prej Aishes).

Ebul-Kasimi s.a.v.s. tha: **“E ka mallkuar All-llahu “El-Kashiren” - gruaja e cila qëron apo rjep fytyrën e saj apo të tjetërkujt me safran që t’i zbardhet ngjyra - dhe gruan që kështu vepron.”** (transmetoi imam Ahmedi prej Aishes r.a.).

Imami i çdo hajri s.a.v.s. tha: **“I ka mallkuar All-llahu ato gra që u përngjajnë burrave dhe ata burra që u përngjajnë grave.”** (transmetuan Tirmidhiu, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe prej Abdullah Ibn Abbasit).

Ai i cili nuk flet me hamendje s.a.v.s. tha: **“I ka mallkuar All-llahu gratë El-Musevvifat (shpresëdhënëset), të cilën e fton burri i saj në krevatin e tij, e ajo i thotë: prit, tani do të vij, derisa kështu të flejë.”** (transmetoi Taberani prej Abdullah Ibn Omerit).

Vula e të gjithë peygamberëve poashtu tha: **“E ka mallkuar All-llahu gruan El-Mufessile (të keqe), të cilën kur e dëshiron burri i saj, i thotë (duke gënjyer): unë jam me menstruacione.”** (transmetoi Buhariu prej Ebu Hurejres).

Shëruesi i zemrave dhe mendjeve s.a.v.s. tha: **“I ka mallkuar All-llahu gratë që bëjnë tatuazh dhe ato që kërkojnë t’u bëhet tatuazh, ato gra që shkulin qimet prej fytyrës dhe ato që kërkojnë t’u shkulën ato, gratë të cilat ndajnë dhëmbët për zbukurim dhe ato të cilat ndryshojnë krijimin e All-llahut.”** (transmetuan Buhariu, Ebu Davudi, Ibn Maxhe dhe Nesaiu prej Ibn Mes’udit).

Poashtu ai s.a.v.s. tha: **“E ka mallkuar All-llahu atë grua që gërsheton flokët (i vazhdon ato) dhe atë që kërkon t’i bëhet gërshetimi dhe atë grua e cila bënë tatuazh dhe atë që kërkon t’i bëhet tatuazhi.”** (transmetuan imam Ahmedi dhe Ebu Davudi prej Abdullah Ibn Omerit).

Pishtari ndriçues s.a.v.s. poashtu tha: **“Vërtet All-llahu i madhërishëm e urren zërin e vajtueses, ashtu si e urren muzikën dhe e dënon atë, ashtu si e dënon këngëtarin, si dhe nuk vesh hallhalle me zë vetëm ndonjë grua e mallkuar.”** (transmetoi Dejlemiu prej Ebu Umames).

Ai i cili nuk flet me hamendje s.a.v.s. tha: **“Do të shfaqen në kohën e fundit gra, të cilat do të hypin në kolltuqe (makina) në pamje të burrave, do të zbresin me to te dera e xhamisë, të veshura, por të deshura, kokat e tyre si gungat e shtrembura të deveve, mallkoni ato, sepse ato janë të mallkuara, sikur pas juve të ketë ndonjë ummet nga ummetet, ato do t’i shërbejnë atij sikur u shërbejnë juve gratë e popujve të mëparshëm“** (transmetoi Taberani prej Ibn Omerit).

I Dërguari i mëshirës s.a.v.s. tha: **“E ka mallkuar All-llahu vajtuesen dhe dëgjuesen e vajtueses, atë grua që rruan kokën, atë grua që ngrit zërin gjatë ndonjë fatkeqësie, si dhe atë grua që bën tatuazh dhe atë që kërkon t’i bëhet tatuazhi.“** (transmetoi El-Bejhekiu prej Ibn Amirit).

Ai s.a.v.s. poashtu tha: **“I ka mallkuar All-llahu ata burra që u përngjajnë grave (në fjalët, ndejen dhe ecjen e tyre), ato gra që u përngjajnë burrave, i ka mallkuar edhe murgjërit të cilët thonë: ne nuk martohemi dhe murgeshat të cilat thonë të njëjtën gjë, atë që merr rrugën nëpër shkretëtirë vetë dhe atë që kalon natën vetë.”** (transmetuan imam Ahmed, Abdurr-Rrezaki dhe Taberani prej Ebu Umames).

Imami i të devotshmëve s.a.v.s. tha: **“E ka mallkuar All-llahu gërvishtësen e fytyrës së saj, shqyerësen e teshës së saj dhe atë që thërret mallkim e shkatërrim (të cilën gjë e veprojnë gjatë ndonjë fatkeqësie).”** (transmetuan Ibn Maxhe, Ibn Hibani dhe Taberani prej Ebu Umames).

ZJARRI ËSHTË KRIJUAR PËR MENDJELEHTËT

Muhammedi s.a.v.s. tha: **“Vërtet gruaja besimtare në mesin e grave është si sorra me sqep dhe këmbë të kuqe në mesin e sorrave (el-gurab el-a’sam; mund të jetë edhe sorra me bark të bardhë, ose me krah të bardhë, ose me një këmbë të bardhë), kurse Zjarri është krijuar për mendjelehtët, e gratë janë prej mendjelehtëve, përveç asaj që i shërben burrit në çështjet e tij dhe i ndez dritën atij (p.sh. i ndihmon në avdesin dhe çdo shërbim tjetër).”** (transmetoi Hakimi prej Kethir Ibn Murre).

I Sinqerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: **“Gruaja besimtare në mesin e grave është si sorra me sqep dhe këmbë të kuqe në mesin e sorrave (d.m.th. e dalluar në sjelljet e saja të mira si ajo sorrë në mesin e sorrave krejtësisht të zeza), e Zjarri është krijuar për mendjelehtët dhe gratë janë më mendjelehtët, përveç asaj që i shërben burrit në çështjet e tij dhe i ndez dritën atij.”** (transmetoi Ibn Asakiri prej Ebu Shexhere).

Ai s.a.v.s. poashtu tha: **“Nuk do të hyjë në Xhennet prej grave përveç asaj gruaje e cila është e dalluar në mesin e grave si kjo sorrë me sqep dhe këmbë të kuqe në mesin e sorrave.”** (transmetuan Taberani dhe Hakimi prej Amrit).

GRUAJA E CILA DO TË HYJË NË ZJARR PËR SHKAK TË NJË MACEJE

Muhammedi s.a.v.s. tha: **“Do të hyjë një grua në zjarr për shkak të një maceje të cilën e ka lidhur, nuk e ushqeji atë as nuk e la të ushqehet prej insekteve të tokës derisa vdiq.”** (transmetuan imam Ahmedi, Buhariu dhe Ibn Maxhe prej Ebu Hurejres).

VAJTUESJA ËSHTË NË ZJARR

En-Nijaha (vajtimi): ngritja e zërit në ndonjë fatkeqësi duke vajtuar dhe duke përmendur të mirat e të vdekurit.

Është thënë: është qarja për të vdekurin duke përmendur të mirat e tij.

Të goditurit e fytyrës me shuplakë, vajtimi, shqyerja e teshave, të rruarit e flokëve apo shkulja e tyre dhe të luturit për mjerim dhe shkatërrim gjatë ndonjë fatkeqësie janë prej veprimeve të injorancës.

Mustafaja (i zgjedhuri) s.a.v.s. tha: **“Të vajtuarit për të vdekurin është çështje e injorancës, nëse vajtuesja nuk pendohet para vdekjes, do të ringjallet në Ditën e Kijametit me petka prej katrani, pastaj do t’i vlojë asaj një këmishë prej flakës së zjarrit.”** (transmetoi Ibn Maxhe prej Ibn Abbasit).

I Singerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: **“Cilado vajtuese, e cila vdes para se të pendohet, do t’i veshë All-llahu asaj një petkë prej zjarri dhe do ta ngritë atë para njerëzve në Ditën e Kijametit.”** (transmetuan Ebu Ja’la dhe Ibn Adijji prej Ebu Hurejres).

Muhammedi s.a.v.s. poashtu tha: **“Vajtueset në Ditën e Kijametit do të ndahen në dy rreshta: një rresht në të djathtë dhe një rresht në të majtë dhe do të lehin për banorët e Zjarrit sikurse lehin qentë.”** (transmetoi Ibn Asakiri prej Ebu Hurejres).

Imami i çdo hajri s.a.v.s. tha: **“Vajtuesja nëse nuk pendohet, do të ndalet në Ditën e Kijametit në një rrugë në mes të Xhennetit dhe Zjarrit, petkat e saj do të jenë prej katrani dhe fytyrën e saj do ta kaplojë zjarri.”** (transmetuan Ibn Ebu Hatimi dhe Taberani prej Ebu Umames).

Ndërmjetësuesi dhe atij që i lejohet ndërmjetësimi s.a.v.s. tha: **“Vajtueset do të kenë petka prej katrani.”** (transmetoi Taberani prej Abdullah Ibn Omerit).

Vula e të gjithë peygamberëve s.a.v.s. tha: **“Do të dalë vajtuesja në Ditën e Kijametit prej varrit të saj me flokë të shkapërderdhura, e**

pluhrosur, me këmishë të zgjebosur dhe pallto të mallkimit, të vendosura duart mbi kokën e saj dhe duke thënë: mjer për mua, kurse Maliku (roja i Xhehennemit) thotë: Amin (o Zot, përgjigju), pastaj fat i saj është Zjarri.” (transmetoi Ibn En-Nexhxhari prej Enesit).

LAVIRJA ËSHTË NË ZJARR

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Nuk ka mundësi që laviri (prostituti) të jetë besimtar në momentin kur bën prostitucion, nuk ka mundësi që vjedhësi të jetë besimtar në momentin kur vjedh, nuk ka mundësi që konsumuesi i alkoolit të jetë besimtar në momentin kur ai konsumon atë dhe nuk ka mundësi që dikush të marrë diçka të vlefshme, për të cilën gjë njerëzit e shikojnë, e të jetë besimtar kur ai e merr atë.”** (transmetuan Buhariu dhe Muslimi prej Ebu Hurejres).

Në Zebur (Psalme) është thënë: prostitutët do të lidhën për organet e tyre seksuale në Zjarr dhe do të goditen me kamxhik të hekurt, kur ndonjëri prej tyre kërkon ndihmë nga dhembjet e goditjes, i thonë Zebanijet: ku ka qenë ky zë kur ti qesheshe, gëzoheshe dhe lavdërohesh, e nuk vështroje dhe nuk marroheshe prej All-llahut të madhërishëm?

Një ditë Abdullah Ibn Mes’udi r.a. e pyeti të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s.: o i Dërguar i All-llahut, cili mëkat është më i madhi tek All-llahu? Ai s.a.v.s. tha: **“Ti bësh All-llahut shok, kurse Ai të ka krijuar.”** Ai pastaj i tha: vërtet kjo është e madhe, pastaj cili? Ai s.a.v.s. u përgjigj: **“Ta vrasësh fëmijën tënd prej frikës që ushqehet me ty.”** Ibn Mes’udi tha: pastaj cili? I Sinqerti dhe i Vërtetuari tha: **“Të bësh prostitucion me gruan e fqinjit tënd.”**

Atëherë All-llahu i madhërishëm zbriti vërtetim të kësaj: *“Edhe ata që pos All-llahut nuk lusin ndonjë Zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që e ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai e gjen ndëshkimin. Atij i dyfishohet dënimi Ditën e Kijametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë. Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë...”* (kaptina El-Furkan : 68-70). (transmetuan Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe El-Bejhekiu prej Ebu Hurejres).

Në natën e Mi’raxhit i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. pa disa njerëz të cilët në duart e tyre kishin mish të freskët, kurse pranë tyre kishte mish të ndytë me erë të keqe, ata hanin mishin e ndytë dhe e lenin mishin e freskët, atëherë i Dërguari te njerëzit në përgjithësi tha: **“Kush janë këta, o Xhibril?” Xhibrili a.s. tha: “Këta janë ata të cilët i lënë gratë e tyre të lejuara dhe shkojnë tek ato gra të cilat ua ka ndaluar All-llahu atyre.”**

Ebul-Kasimi s.a.v.s. në natën e Mi’raxhit i pa disa gra të vjerra për gjinjtë e tyre, e tha: **“Kush janë këto, o Xhibril?” Xhibrili a.s. tha: “Këto gra**

janë ato të cilat u kanë ngjitur burrave fëmijë, të cilët nuk kanë qenë të tyre.”

Ai i cili nuk flet me hamendje s.a.v.s. tha: **“Hapen dyert e qiellit në gjysmën e natës, atëherë një thirrës thirrë: a ka dikush që lutet, e t’i përgjigjet atij? A ka dikush që kërkon diçka, e t’i dhurohet atij? A ka dikush që është në fatkeqësi, e t’i largohet ajo? Atëherë nuk mbetet asnjë musliman i cili bën një lutje, përveçse do t’i përgjigjet All-llahu i madhërishëm atij, me përjashtim të një prostitute, e cila jeton nga prostitucioni dhe atij që merr pasuritë e njerëzve pa të drejtë (El-Ashshar).”** (transmetuan imam Ahmedi dhe Taberani prej Uthman Ibn Ebil-Asit).

Sahabiu i ndritur Ebu Hurejre r.a. tha: kur zbriti ajeti i mallkimit (el-mulaane), e dëgjova të Dërguarin e All-llahut duke thënë: **“Cilado femër e cila hyn te disa njerëz të cilët nuk janë prej saj, nuk është me All-llahun në asgjë dhe nuk do ta fusë All-llahu atë në Xhennetin e Tij dhe cilido njeri i cili mohon fëmijën e tij dhe ai e shikon atë, në Ditën e Kijametit do të fshihet All-llahu prej tij dhe do ta poshtërojë atë në sy të të parëve dhe të fundit.”** (transmetuan Ebu Davudi dhe Nesai).

GRUAJA DHE MALLKIMI NË ZJARR

I Sinqerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: **“Mallkuesit nuk do të jenë në Ditën e Kijametit ndërmjetësues e as dëshmitarë.”** (transmetoi Muslimi prej Ebud-Derdait).

Derisa pronari i sjelljes së lartë s.a.v.s. ishte në një udhëtim, një gruaje të ensarëve iu bezdis deveja, të cilën ajo e mallkoi, i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. pasi që e dëgjoi i tha: **“Merrne atë nga ajo dhe lëne atë, sepse ajo është e mallkuar.”** Sahabiu i ndritur Umran Ibn Husajn thotë: më duket sikur e shoh tani atë duke ecur mes njerëzve pa iu prezentuar asaj askush. (transmetoi Muslimi prej Umran Ibn Husajnit).

Sahabiu i ndritur Amr Ibnul-As e vizitoi një hallë të tijën, e cila i afroi ushqim atij, por robëresha u vonua, e atëherë ajo i tha: a nuk ngutesh, oj lavire? Amr Ibnul-Asi i tha: SubhanAllah (i lartë e i pastër është All-llahu nga çdo e metë), ti vërtet ke thënë një fjalë të rëndë, a mos e ke parë atë duke bërë prostitucion? Halla e tij tha: jo pasha All-llahun. Atëherë Amr Ibnul-Asi tha: unë e dëgjova të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s. duke thënë: **“Cilido njeri apo cilado femër, e cila i thotë fëmijës së saj: oj lavire, ndërsa nuk e ka parë duke bërë prostitucion, do ta rrahë atë fëmija i saj në Ditën e Kijametit (me tetëdhjetë kamxhik), meqë ato nuk mund të zbatojnë dënimin në këtë botë.”** (transmetoi Hakimi).

GRUAJA, MENDJEMADHËSIA DHE ZJARRI

Vula e të gjithë peygamberëve s.a.v.s. tha: **“Nuk do të hyjë në Xhennet njeriu i cili ka mendjemadhësi në zemrën e tij sa kokrra e melit.”** (transmetoi Taberani prej Abdullah Ibn Abbasit).

Udhëzuesi dhe përgëzuesi s.a.v.s. tha: **“Ai i cili ka mendjemadhësi në zemrën e tij sa kokrra e melit, do ta hedhë All-llahu në Zjarr me fytyrën e tij.”** (transmetuan ed-Daru Kutuni dhe Ibnun-Nexhxhari prej Abdullah Ibn Amrit).

GRUAJA, GIBETI DHE KOPRRACJA JANË NË ZJARR

Imami i çdo hajri s.a.v.s. tha: **“Vërtet robi flet një fjalë në kënaqësi të All-llahut të madhërishëm, të cilës nuk i kushton kujdes, e ngrit All-llahu me të shumë shkallë në Xhennet. Kur robi e flet një fjalë në hidhërim të All-llahut, të cilës nuk i kushton kujdes, hidhet me të në Xhehennem.”** (transmetuan Buhariu dhe En-Nesaiu prej Ebu Hurejres).

Një ditë ishte një grua tek Aishja r.a. me disa gra, e njëra nga ato tha: Pasha All-llahun, unë do të hyj në Xhennet, sepse unë besova, kurrë nuk vodha dhe kurrë nuk bëra prostitucion. Ajo pas kësaj pa një ëndërr se dikush i tha: a ti je ajo që pretendon se gjithqysh do të hysh në Xhennet? E si, pra, kur ti bëhesh koprrace për atë që nuk të pasuron? Si dhe flet atë që nuk të intereson? Kur ajo gdhui, shkoi tek e Singerta, e bija e të Singertit (Ajshja r.a.) të cilën e informoi për ëndërrën e saj, pastaj i tha: tuboi gratë të cilat ishin te ti kur unë thashë atë që thashë. Ajshja r.a. i ftoi ato, e ato erdhën, atëherë ajo u tregoi atë që kishte parë në ëndërr. (transmetoi El-Bejhekiu prej Ebu Selemete Abdurr-Rahman).

I Singerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: **“Dorëlrësia është një pemë në Xhennet, e kush është dorëlrë, ai është kapur për një degë të saj dhe ajo degë nuk do ta lëshojë atë derisa ta fusë në Xhennet. Kurse koprracia është një pemë në Zjarr, e kush është koprrac, ai është kapur për një degë të saj dhe ajo degë nuk do ta lëshojë derisa ta fusë në Zjarr.”** (transmetoi El-Hatibi prej Ebu Hurejres).

Shëruesi i zemrave dhe i mendjeve s.a.v.s. tha: **“Dorëlrësia është prej fisnikërisë së All-llahut, prandaj jepni që All-llahu të është fisnik me ju. All-llahu e krijoi dorëlrësinë në pamjen e njeriut, rrënjën e tij e përforcoi në zemër të pemës Tuba, i përforcoi degët e saj me degët e Sidretul-Muntehas dhe i lëshoi disa degë të saj në këtë botë, kështu që ai që kapet për ndonjë degë të saj, ajo do ta fusë në Xhennet, vëreni dorëlrësia është prej imanit, kurse imani është në Xhennet. Pastaj All-llahu krijoi koprracinë prej hidhërimit të Tij, rrënjët e saj i përforcoi në zemër të pemës Ez-Zekkum dhe i lëshoi disa degë të saj në këtë**

botë, kështu që ai që kapet për ndonjë degë të saj, do ta fusë ajo në Zjarr, vëreni koprracia është prej mosbesimit dhe mosbesimi është në Zjarr.” (transmetoi El-Hatibi prej Ibn Abbasit).

GRUAJA, LËMOSHA DHE ZJARRI

Ai i cili nuk flet me hamendje s.a.v.s. tha: **“Nuk ka asnjë rob i cili jep një lëmoshë, me të cilën dëshiron fytyrën e All-llahut, përveçse do t’i thotë All-llahu atij në Ditën e Kijametit: rob i Im, ti shpresove tek Unë, Unë nuk do të të poshtëroj. Ia ndalova Zjarrit trupin tënd dhe hyr me të në Xhennet për cilëndo derë që dëshiron.”** (transmetuan Ibn Lal dhe Ed-Dejlemiu prej Ebu Hurejres).

Vula e të gjithë peygamberëve s.a.v.s. tha: **“Vërtet All-llahu i fut në Xhennet për një kafshatë buke, një grusht hurme dhe gjëra të ngjashme, të cilat i bëjnë dobi të varfërit, tre persona: pronarin e shtëpisë, i cili ka urdhëruar atë, gruan dashamirëse dhe shërbëtorin, i cili i dhuron atë të varfërit. Falënderimi i qoftë All-llahut, i Cili nuk harroi asnjë prej nesh.”** (transmetuan Hakimi dhe Ibn Asakiri prej Ebu Hurejres).

GRUAJA, GJUHA DHE ZJARRI

Vula e të gjithë peygamberëve s.a.v.s. tha: **“Kush flet shumë, gabon shumë, e kush gabon shumë, i shumohen edhe gjynahet dhe kujt i shtohen gjynahet shumë, Zjarri do të ketë përparësi në të.”** (transmetoi Taberani prej Abdullah Ibn Omerit).

Pishtari ndriçues s.a.v.s. tha: **“All-llahu e mëshiroftë atë njeri, i cili flet mirë, e kështu fiton, ose hesht, e kështu shpëton.”** (transmetoi Ibn Mubareku prej Halid Ibn Imran).

Imami i çdo hajri s.a.v.s. tha: **“Vërtet rob i flet një fjalë në kënaqësi të All-llahut të madhërishëm, të cilës nuk i kushton kujdes, e ngrit All-llahu me të shumë shkallë në Xhennet. Dhe vërtet rob i flet një fjalë në hidhërim të All-llahut, të cilës nuk i kushton kujdes, hidhet me të në Xhehennem”** (transmetuan imam Ahmedi dhe Buhariu prej Ebu Hurejres).

Pronari i moralit të lartë s.a.v.s. tha: **“All-llahu e mëshiroftë atë njeri, i cili flet, e kështu fiton, ose hesht, e kështu shpëton.”** (transmetoi El-Bejhekiu prej Enesit).

GRUAJA DYFYTYRËSHE

I Dërguari për të gjithë njerëzit s.a.v.s. tha: **“Dyfytyrëshi në këtë botë do të vijë në Ditën e Kijametit me dy fytyra prej zjarrit.”** (transmetoi Taberani prej S’ad Ibn Ebu Vekkasit).

GRUAJA, MOSRESPEKTI NDAJ BURRIT TË SAJ DHE ZJARRI

I Dërguari i mëshirës s.a.v.s. tha: **“Cilado grua e cila vdes dhe burri i saj është i kënaqur me të, do të hyjë në Xhennet.”** (transmetoi Hakimi prej Ummu Selemes).

Vula e të gjithë pejgamberëve s.a.v.s. tha: **“Nuk i lejohet asnjë gruaje, e cila beson All-llahun dhe Ditën e fundit të lejojë të hyjë në shtëpinë e burrit atë që ai e urren, e as të dalë ajo duke e urrejtur ai këtë, të mos e respektojë para atij askënd, të mos hidhërohet në të, të mos lëshojë krevatin e tij, të mos e godasë atë, e nëse burri është më mizor se ajo, le t’i afrohet derisa të kënaqet ai, nëse ai e pranon këtë nga ajo, do të jetë begati, do të pranojë All-llahu arsyen e saj, do të fitojë argumenti i saj dhe nuk do të ketë gjynah ajo, e nëse burri i saj refuzon kënaqësinë e saj, ajo me këtë e ka ngritur tek All-llahu arsyen e saj.”** (transmetoi Hakimi prej Muadh Ibn Xhebelit).

GRA TË PREMTUARA ME ZJARR

Këto gra janë lëndë djegëse të Zjarrit dhe ato janë premtuar në Kur’an se do të hyjnë në Zjarr. Ato do të jenë lëndë djegëse të Zjarrit, sepse tek ato janë konfirmuar cilësitë e përhershmerisë në zjarrin e Xhehennemit, e ato janë:

- Ato kanë mohuar All-llahun (fenë, njëshmërinë, emrat, cilësitë dhe begatitë e Tij).
- Ato kanë qenë konfrontuese të së vërtetës si shkak i refuzimit dhe kryeneqësisë së tyre.
- Ato ishin ndaluese të së mirës, nxitonin kah e keqja dhe shkatërrimi në tokë.
- Ato ishin mizore.
- Ato ishin dyshuese dhe nuk u besonin të vërtetave.
- Ato megjithëkëtë i shoqëronin All-llahut, adhuronin përveç All-llahut zot tjetër.

Pra, ato me këto cilësi nuk mund të hyjnë në kënaqësinë e All-llahut dhe janë të përzëna prej mëshirës së Tij, e Kur’ani fisnik përmendi gruan e Nuhut, gruan e Lutit dhe gruan e Ebu Lehebit.

All-llahu i madhërishëm thotë: *“Atyre që mohuan, All-llahu u sjell shembull gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato të dyja ishin në kurorë të dy robërve të mirë nga robërit tanë, por ato të dyja i tradhtuan (në fe) ata të dy dhe këta të dy nuk mund t’i mbrojnë ato fare tek All-llahu, e atyre të dyjave u thuhet: “Hyni të dyjat në zjarr së bashku me ata që hyjnë!”* (kaptina Et-Tahrim : 10).

Emri i gruas së Nuhut ishte Vagile, kurse emri i gruas së Lutit ishte Valihe, ndërsa me fjalën e All-llahut "... por ato të dyja i tradhtuan ata të dy..." shprehet mosbesimi.

Është thënë: i tradhtuan ata të dy në fe dhe ishin idhujtare.

Është thënë: ishin dyfytyrëshe.

Është thënë: tradhtia e tyre ishte bartja e fjalëve, kur All-llahu i shpallte Nuhut a.s. dhe Lutit a.s. diç, ato të dyja ua zbulonin idhujtarëve.

Vagileja u thoshte njerëzve për burrin e saj: ai është i çmendur.

Valiheja e informonte popullin e saj kur vinin mysafirët te burri i saj, meqë ata ishin homoseksual.

Ibn Abbasi r.a. tha: Nuk ka bërë prostitucion asnjëherë asnjë grua e asnjë të dërguari.

Ai i Cili i dëgjon dhe i di të gjitha thotë: *"E edhe gruaja e tij, ajo që barti dru (ferra). E në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur."* (kaptina El-Mesed : 4-5). Është për qëllim Ummu Xhemil bintu Harb.

VAGILEJA

Nëna e besimtarëve, Aishja r.a. tha: zbriti Xhibrili a.s. te i Dërguari s.a.v.s. i cili e informoi se emri i gruas së Nuhut a.s. ishte Vagile, kurse emri i gruas së Lutit a.s. ishte Valihe.

Depërtoi fytyra e diellit mbi shpinën e malit dhe i shtriu rrezet e tij mbi shtëpitë e fshatit, atëherë u zgjua Vagileja nga gjumi duke hapur gojën. Asaj ju kujtua se sot është festa e zotave dhe se ajo nuk ka bërë kurrfarë ushqimi, e as hallve. Si pra të shkojë në faltoren e madhe me duar të zbrazëta. Çfarë t'u thotë shërbëtorëve të zotërave?

Gruaja e Nuhut a.s. u gëzua shumë kur pa se ai nuk është aty. Ku ka shkuar? Pse nuk i shikon mjetet e zdrukthtarisë së tij. Gëzimi i saj u rrit edhe më shumë, kur pa se mjetet e zdrukthtarisë së tij nuk ishin në vendin e tyre. A mos i ka marrë dhe ka shkuar te dikush prej banorëve të fshatit që t'i rregullojë diçka. Me rëndësi është se ai nuk është në shtëpi. Pse nuk punon me zell dhe vendosmëri në përgatitjen e ushqimit dhe të hallves para se të kthehet ai? Sikur burri i saj të ishte prezent, do ta pengonte dhe do ta përqueshte atë. Ai refuzon dhe nuk kënaqet që ta shoqërojë popullin e tij në këso çështjesh.

Ken'ani, i biri i Nuhut a.s. e pa nënën e tij duke përgatitur ushqimin dhe e pyeti: çfarë po bënë, oj nëna ime? Vagileja i tha: po përgatis atë që do t'u prezentojë zotave, a ke harruar se sot është dita festive e zotave? Ken'ani i biri i Nuhut a.s. i tha: a do të shkosh te faltorja e diellit? Gruaja e Nuhut a.s. tha: si mos ta shoqëroj popullin tim në festën e tyre? Ken'ani i biri i Nuhut a.s. tha: do të vij me ty te faltorja e madhe që të festojmë me popullin tonë për zotat tanë. Vagileja doli me birin e saj Ken'anin te faltorja e madhe. Çfarë do t'i thotë burrit të saj sikur ta takojë në rrugë?

Ai është me gjuhë të pastër, i qartë, i matur e i mençur, i butë. Ai është durimtar në diskutim, ka forcë që t'i paraqesë argumentet dhe i di shumë mirë metodat bindëse.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“I dërguari i parë ishte Nuhu dhe ai u dërgua te njerëzit në përgjithësi.”** (transmetoi Ibn Asakiri).

Kur ai u dërgua te populli i tij i kishte pesëdhjetë vjet.

Abdullah Ibn Abbasi r.a. tha: kur ai u dërgua te populli i tij i kishte dyzet vjet.

Abdullah Ibn Sheddadi tha: kur ai u dërgua i kishte 350 vjet.

U ndal Vagileja para statujave të shenjta: Vuddi, Suvai, Jeguthi, Jeuki dhe Nesri, të cilët ishin prej bijve të Ademit a.s., në mesin e tyre Vuddi ishte biri më i madh i tij dhe më bamirësi ndaj tij, ai quhej me emrin Shith ose “dhuntia e All-llahut”, ai ishte musliman, ishte i dashur në popullin e tij dhe kur ai vdiq, njerëzit u përqëndruan rreth varrit të tij në tokën e Bel-it dhe ata u pikëlluan për të shumë. Kur Iblisi pa pikëllimin e tyre për të, iu shfaq atyre në pamjen e një njeriu dhe u tha: unë e shohë pikëllimin tuaj për këtë njeri, a dëshironi që t'u skulpturojë një të ngjashëm si ai, që kur ta shikoni, do ta kujtoni atë?

Thanë: Po.

Ai e skulpturoi atë në Xhami (në pamje të idhullit) prej bakrit dhe plumbit, pastaj kur vdiq tjetri, e skulpturoi edhe atë derisa vdiqën të gjithë dhe ai i skulpturoi të gjithë ata.

Kështu vazhduan të mangësohen çështjet (e besimit të vërtetë), sikurse pakësohen në ditët tona, derisa edhe lanë adhurimin e All-llahut të madhërishtëm me kalimin e kohës dhe atëherë shejtani u tha:

Ç'është me ju që nuk adhuronit asgjë? Thanë: E çka të adhurojmë? U tha: zotat tuaj dhe zotat e baballarëve tuaj? A nuk i shihni ata në xhaminë tuaj? Kështu i adhuruan ata përveç All-llahut. Pastaj u tha atyre: a t'u skulpturoj juve të ngjashëm në klubin tuaj dhe t'i adhuronit? Thanë: Po. Ai i skulpturoi ata të ngjashëm, pastaj u kthye dhe u tha: a t'u bëj në shtëpinë e çdonjërit nga ju nga një skulpturë të ngjashme? Ta keni atë në shtëpi, që kështu ta kujtoni dhe ta adhuronit? Thanë: Po.

Atëherë ai i skulpturoi çdo shtëpie nga një idhull, të cilët filluan t'i adhurojnë përveç All-llahut. Ata filluan t'i adhurojnë ata dhe kështu filloi adhurimi i idhujve prej asaj kohe derisa e dërgoi All-llahu Nuhun a.s. (ai është Nuh Ibn Lamek ibn Methuselahu Ibn Enoku, i cili është Idrisi a.s., Ibn Jaredi Ibn Mahalalelei Ibn Enoshi Ibn Kajnani Ibn Shithi Ibn Ademi a.s.). Nuhu a.s. u quajt kështu si shkak i çarjes së madhe ndaj vetes, kurse në mes të lindjes së tij dhe vdekjes së Ademit a.s. kishte 164 vjet dhe në mes tyre ishin dhjetë shekuj – apo gjenerata (transmetoi Ebu Hatimi).

Është thënë se emri i Nuhut a.s. ishte Es-Seken, është quajtur kështu, sepse njerëzit pas Ademit a.s. gjetën pushim tek ai. Ai ishte babi i tyre dhe i lindën fëmijët Sami, Hami dhe Jafethi. Prej Samit erdhën arabët, persianët

dhe romakët dhe në të gjithë këta ka hajr. Nga Hami erdhën koptët, sudanezët - afrikanët - dhe berberët. Kurse nga Jafethi erdhën turqit, sllavët dhe je'xhuxhët dhe me'xhuxhët dhe në këta nuk ka kurrfarë hajri.

Është thënë se emri i Nuhut a.s. ishte Jeshkur, mirëpo nga qarja e madhe për gabimin e tij, All-llahu i shpalli: o Nuh, sa shumë që qanë? Kështu ai u quajt Nuh. Është pyetur i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. se cili ishte gabimi i tij? Imami i çdo hajri s.a.v.s. tha: **“Ai një ditë kaloi pranë një qeni dhe tha vetmevete: sa i keq që është. Atëherë All-llahu i tha atij: krijo ti më të mirë se ky!”**

Është thënë se u quajt Nuh, sepse qajti pranë popullit të tij 950 vjet, duke i ftuar tek All-llahu i madhërishëm, e kur ata e mohonin, ai qante e vajtonte për ta.

Vagileja filloi t'u lutet, t'u nënshtrohet dhe t'u afrohet zotave duke u prezentuar shërbëtorëve ushqim dhe pije. Kështu ata filluan të flisnin fjalë të pakuptimta, pastaj sinjalizonin nga zotat dhe edhe njëherë shikonin në drejtim të Vagiles, duke sinjalizuar nga ajo, sepse kishte prezentuar kurbana. Cili ishte sekreti i kësaj buzëqeshje të fshehtë? Ajo dëshiron të kuptojë se a janë zotat të kënaqur me të apo jo? Por, ata nuk flasin...mjafton që shërbëtorët e tyre e informuan atë se zotat janë të kënaqur me të, pse pra nuk u përkulesh atyre, nuk u lutesh me përkushtueshmëri dhe me bindje, duke kërkuar ndërmjetësim prej tyre që ta furnizojnë atë?

Vagileja u kthye mbrapa dhe shikoi, ku është djali i saj, Ken'ani? Ku ka shkuar? Pse u zhduk nga ajo si të ishte ndonjë hije? A thua, mos shkoi atje ku janë vallëzueset dhe burrat duke u dëfryer? Çka është duke bërë tani?

Shikimi i Vagiles ra mbi Ken'anin, i cili vallëzonte me vallëzueset dhe gëlltite verën e vjetëruar...pse nuk e lë atë të luajë e të dëfrehet me të rinjtë e tjerë? Ai nuk ndien përgjegjësi dhe nuk kupton nga kjo jetë, përveç fytyrës së saj të qeshur dhe të paqëllimtë?

Vagileja e shoqëroi popullin e saj Beni Rasib në tubimin e tyre të festës së zotave. U kthye ajo edhe një herë te idhujt dhe filloi t'u lutet atyre me ata që luteshin. E fuste dorën në xhepin e saj që të nxjerrë ndonjë copë të parfymosur që me të të fshijë këmbët e zotave.

Dita shkoi shumë shpejt dhe ajo me të shpejtë u kthye në shtëpinë e saj, por aty e gjeti djalin e saj, Ken'anin, fytyrën e të cilit e kishte kapluar pikëllimi dhe hidhërimi. Ajo e pyeti: ç'është me ty, ku ke shkuar, përse më le në faltoren e madhe? Ken'ani, i biri i Nuhut, tha: shkova në treg, ah sikur të mos shkosha. Vagileja tha: pse? Ai u përgjigj: e gjeta aty babain tim. Vagileja tha: çfarë bënte ai në treg? A mos dëshironte të blente disa dërrasa që të ndërtojë disa pajisje?

Ken'ani tha: nuk ka shkuar babai im në treg që të blejë dërrasa, e as të shesë pajisje. Vagileja pyeti: çfarë bënte, atëherë? Ken'ani tha: pyeti ata që ishin në treg. Atëherë doli Vagileja dhe takoi gratë e burrat, të cilët ishin në treg dhe i pyeti: çka bëri burri im sot në treg? Ata thanë: ai sot u tha

njerëzve çudira. A mund të besosh se ai hipi mbi një gur dhe filloi të thotë: *“O populli im, adhurone All-llahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij, unë u kam frikën juve prej dënimit të një dite të madhe.”* (kaptina El-A’raf : 59).

Vagileja pyeti: e çfarë ishte përgjigjja e Benu Rasibit? Ata që ishin në treg i thanë: *“... ne ty të shohim në një humbje të qartë.”* (kaptina El-A’raf : 60).

Vagileja tha: fisnikët dhe paria e Beni Rasibëve kanë të drejtë, si mund të na ftojë ai të adhurojmë vetëm një Zot, ai vërtet është në humbje - në një rrugë të shtrembër. A po dëshiron ai që të adhurojmë një Zot që nuk e shohim dhe t’i lëmë zotat tanë, të cilët qëndrojnë në faltoren e diellit, ata na furnizojnë dhe na ruajnë, pasha All-llahun, ai është gënjeshtar, unë jam e para që nuk do t’i besoj atij dhe nuk do ta pasoj në atë që ai fton.

Vagileja mohoi thirrjen e burrit të saj dhe shpalli mendimin e vendosmërinë e saj qartazi qysh prej momentit të parë.

Një njeri e pyeti të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s.: o i Dërguar i All-llahut, a ka qenë Ademi i dërguar? Imam i çdo hajri s.a.v.s. tha: **“Po, ai ishte i dërguar mukel-lim (që foli me All-llahun)”**. Ai i tha: o i Dërguar i All-llahut, sa është periudha në mes tij dhe Nuhut? Ai i cili flet pa hamendje s.a.v.s. tha: **“Ishin dhjetë gjenerata, të gjithë ishin në fenë Islame.”** (transmetoi Buhariu).

All-llahu e dërgoi Nuhun a.s. te Beni Rasibët, pasi që ata adhuruan idhujtë dhe shejtanët, e kështu ata devijuan dhe bënë mosbesim.

Dërgimi i tij ishte mëshirë për robërit dhe ai ishte i dërguari i parë i cili u dërgua te banorët e tokës.

Vagileja u kthye në shtëpinë e saj dhe e gjeti birin e saj të ulur këmbëkryq, të vendosur kokën e tij në mes të dy krahërorëve të tij dhe sikur ai rënkonte nga një pikëllim e preokupim, ajo i tha atij: çfarë do të bëjmë?

Ken’ani tha: me çfarë fytyre do t’i takojmë banorët e fshatit, kur ata i thanë babait tim: *“... ne vërtet ty të shohim në një humbje të qartë”* dhe i thanë: *“... ky nuk është tjetër, pos njeri sikurse ju, po dëshiron të jetë më i lartë se ju...”*

Vagileja tha: e gjuajtën me gënjeshtër dhe çmenduri.

Ken’ani, i biri i Nuhut, tha: babai im i urrente zotat tanë, përqeshej me ta dhe thoshte: ata janë gurë të cilët i keni gdhendur me duart tuaja, nuk hanë as nuk pinë dhe nuk posedojnë asgjë.

Gruaja e Nuhut a.s. tha: sikur t’u afronte flijime atyre një ditë, të kërkonte kënaqësinë e tyre dhe ta furnizojnë? Por ai këtë nuk e veproi, kurse ai sot kërkon prej neve që të mos i adhurojmë? A nuk i kanë adhuruar ata edhe baballarët tanë? A ishin ata në devijim? Ç’është kjo fe e re, të cilën e shpiki babai yt?

Atëherë erdhë Nuhu a.s., kurse Vagileja u ngrit në drejtim të tij dhe pyeti: ku ishe? Nuhu a.s. tha: isha në treg, atje ku tubohen njerëzit dhe u komunikova shpalljen me të cilën më ka dërguar Zoti im.

Vagileja, sikurse nuk kishte dëgjuar për këto fjalë më herët, i tha: me çfarë shpallje të ka dërguar Zoti yt? Nuhu a.s. tha: që Benu Rasibët të adhurojnë vetëm All-llahun, i Cili nuk ka shoq dhe të heqin prej qafave të tyre adhurimin e idhujve të cilët nuk bëjnë dobi e as dëm.

Vagileja pyeti: a je ti më i mirë se sa baballarët tu, të cilët i adhuruan ata për shumë vjet?

Nuhu a.s. tha: ata ishin në humbje të qartë.

Vagileja tha: ti i prishe ëndërrat e baballarëve tu dhe fyeve gjyshërit tu, e s'i thua pra se All-llahu të ka dërguar te Beni Rasibët me një shpallje me të cilën i fton që ta hedhin adhurimin e Vuddit, Suvait, Jeguthit, Jeukit dhe Nesrit?

Nuhu a.s. tha: mua më ka zgjedhur Zoti im për këtë çështje.

Vagileja pyeti: ti jetove me ne gjatë, e pse fillove me këtë çështje vetëm sot? Sot është festa e idhujve.

Nuhu a.s. i ftoi Beni Rasibët tek All-llahu i madhërishëm, por ata refuzuan, i qortoi ata me dënim, por ata u verbëruan dhe u shurdhuan, i nxiti ata në shpërblim, por ata i vendosën gishtërinjtë në veshët e tyre dhe bënë mendjemadhësi. Mirëpo, ai iu kundërvu atyre, diskutoi me ta, pastaj bëri durim, një kohë të gjatë u zgjati atyre dorën e butësisë së tij, u foli atyre fjalë të ëmbëla, nuk u dobësua në imanin e tij dhe nuk humbi shpresë, nuk lejoi që pashpresa të depërtojë në zemrën e tij, madje ai filloi të sprovohet në thirrjen e tij dhe filloi të luftojë në komunikimin e shpalljes, duke i ftuar ata natën, ditën, fshehtas dhe haptas, ua drejtoi shikimin atyre kah fshehtësia e ekzistencës dhe përsosmëria e krijimit: natë e errët, qiell me plot yje, hënë e cila lëviz, diell i cili ndriçon dhe tokë në të cilën lundrojnë lumenjtë dhe mbijnë në të bimët dhe frutet.

Por, fatkeqësisht, personi më i afërt me të shpenzoi çdo mund dhe nuk humbi asnjë rast që t'i kundërvihet thirrjes së mirësisë. Gruaja e tij, e cila nuk mjaftonte vetëm me mosbesim, por kur vinte ndonjë fqinje e saj, i thoshte: ç'është kjo fe e re me të cilën ka ardhur burri yt? Vagileja përgjigjej: ai po supozon se All-llahu është Krijuesi i qiejve dhe i tokës, se Ai është Furnizuesi i çdo gjëje, se Ai jep vdekje dhe se Ai do t'i ringjallë njerëzit në Ditën e llogarisë, pastaj Xhennet ose Zjarr.

Ajo grua i tha: a i beson ti se njerëzit kur të vdesin do të ringjallen?

Vagileja i tha: unë e gjuajta me gënjeshtër.

Vagileja një ditë e pyeti burrin e saj: ku është Zoti yt, o Nuh? Nuhu a.s. tha: All-llahun nuk e përfshin asnjë vend, e asnjë kohë, sepse ai është Krijuesi i kohës dhe i vendit, Atë nuk e arrijnë shikimet, kurse shikimi i Tij arrin çdo gjë.

Vagileja i tha: si ta dimë ne se Zoti yt ekziston? Nuhu a.s. tha: shenjat e fuqisë së Tij, i lartë e i pastër është Ai nga çdo e metë, shihen në çdo gjë, para nesh është krijimi i Tij, përsosmëria e tij në qiell, të cilin e ngriti pa asnjë shtyllë, në tokën në të cilën çau lumenjtë dhe detërat, në shiun i cili

bie prej qiellit që me të mbinë bimët në të cilat ka jetë për njerëzit dhe shtazët dhe shenja ka në krijimin e vdekjen e njerëzve.

Kur bijtë e Nuhut dëgjuan këtë, thanë: o babai ynë, All-llahu na zgjeroi zemrat tona për hajrin në të cilin je duke ftuar.

Atëherë Vagileja dhe biri i saj Ken'ani u ngritën në këmbë dhe thanë: ua prishe mendjet fëmijëve tu me atë thirrje, kemi frikë se do t'i mallkojnë zotërat dhe të zbresë mbi ta hidhërimi i tyre.

Nuhu a.s. tha: kurse unë u thërras ju të dyve tani, që kështu të spastroj vetën time para Atij që i di dhe i sheh të gjitha, sepse ju jeni familja ime dhe njerëzit më të afërtë tek unë. Unë u ftoj që të dëshmoni ju dy se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, të Vetmit, i Cili nuk ka shoq dhe hidhni ata idhuj që i adhuron përveç All-llahut.

Vagileja e shikoi djalin e saj Ken'anin, e tundi kokën e saj dhe tha: ne nuk do t'i lëmë ata që baballarët tanë i adhuruan.

Ken'ani tha: po, o babai im, unë mendoj se ti duhet t'i ndërprësh këto fjalë dhe t'i lëshë Beni Rasibët dhe çështjen e tyre.

Nuhu a.s. duke urrejtur këtë tha: si ka mundësi ta lë mesazhin, për të cilin më ka urdhëruar All-llahu që t'ua komunikoj njerëzve? Përse këmbëngulni në adhurimin e gurëve ose drunjve të cilët nuk dëgjojnë, nuk shohin, nuk bëjnë dëm e as dobi?

Vagileja tha: a nuk mjafton që ti u shkatërrove ëndërrat bijve tu me këtë thirrje?

“Atyre që mohuan, All-llahu u sjell shembull gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato të dyja ishin në kurorë të dy robërve të mirë nga robërit tanë, por ato të dyja i tradhtuan (në fe) ata të dy dhe këta të dy nuk mund t'i mbrojnë ato fare tek All-llahu, e atyre dyjave u thuhet: “Hyni të dyjat në zjarr së bashku me ata që hyjnë!” (kaptina Et-Tahrim : 10).

Vagileja e tradhtoi burrin e saj me mosbesim dhe u thoshte Beni Rasibëve: ai është i çmendur.

Pra, tradhtia e gruas së Nuhut a.s. dhe e gruas së Lutit a.s. ishte tradhti në fe, ato ishin idhujtare dhe është thënë: ato kanë qenë dyfytirëshe, është thënë edhe se: tradhtia e tyre ka qenë se ato i bartnin dhe ua zbulonin popujve të tyre atë që All-llahu u shpallte atyre.

Nuhu a.s. doli te populli i tij dhe u tha: o populli im, kërkoni falje prej Zotit tuaj, Ai vërtet është Falës i madh: *“Ai ju lëshon nga qielli shi me bollëk. Ju shumon pasurinë dhe fëmijët, ju bën të keni kopshte dhe ju jep lumenj.”* (kaptina Nuh : 11-12).

D.m.th. kërkoni prej Zotit tuaj falje për gjynahet tuaja të mëparshme, duke besuar me sinqeritet, sepse Ai është Falës i madh dhe shumë i mëshirshëm, e kjo prej Tij është shpresëdhënie për pendim, i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **”Istigfari (kërkimi i faljes) është fshirës i gjynaheve.”**

Pasi që Benu Rasibët përgënjeshtroan të Dërguarin e All-llahut Nuhun a.s. një kohë të gjatë, All-llahu i madhërishëm ua ndaloi shiun, ua ndaloi

lindjen grave të tyre për dyzet vjet, kështu që u shkatërruan shtazët dhe bimët e tyre dhe pastaj shkuan te Nuhu a.s. duke kërkuar ndihmë prej tij, e ai u tha: “... *kërkoni falje Zotit tuaj, se Ai vërtet falë shumë*”, që do të thotë se Ai vepron kështu gjithnjë për atë që pendohet... pastaj duke i nxitur në besim u tha: “*Ai ju lëshon nga qielli shi me bollëk. Ju shumon pasurinë dhe fëmijët, ju bën të keni kopshte dhe ju jep lumenj*”.

Meqë Benu Rasibët ishin lakmitarë të mëdhenj në këtë botë.

Imami i çdo hajri s.a.v.s. tha: **“Shpejtoni në adhurim të All-llahut, sepse aty arrihet kjo botë dhe bota e ardhme.”**

Pastaj Nuhu a.s. u tha: ç’është me ju që nuk i frikoheni madhërisë dhe fuqisë së All-llahut i Cili mund t’iu kaplojë me dënim çdonjërin prej jush, d.m.th. nuk keni arsye që të mos frikoheni nga All-llahu.

Vazhdoi Nuhu a.s. të luftojë, të paraqesë dhe t’i shtrojë argument pas argumenti popullit të tij, kështu derisa besuan në të një grup i vogël, të cilët iu përgjigjën thirrjes së tij dhe e vërtetuan shpalljen e tij.

Por, Vagileja vazhdoi me kryeneqësinë e saj ndaj thirrjes së hajrit në të cilën ftonte i dërguari i All-llahut Nuhu a.s. dhe kur vinte tek ajo ndonjë prej fqinjëve të saj që ta pyesë për atë thirrje: se a është më hajr të pasohet ajo apo të largohemi nga ajo? Vagileja i thoshte: sikur në atë thirrje të ketë hajr, unë dhe biri im do ta pasonim atë.

Me këtë rast pyetësi largohet duke larguar prej vetes të gjitha dyshimet rreth zotave të cilët i adhuronin.

Shkuan shumë vjet dhe zemrave të Benu Rasibëve nuk u shkonte thirrja e Nuhut a.s. përveç kryeneqësi e mendjemadhësi dhe për çdo ditë e cila kalonte gruaja e Nuhut a.s. tentonte ta demoralizonte vendosmërinë e burrit të saj derisa ai ftonte në të vërtetën, e i thoshte atij: o njeri, nuk po të pasojnë ty, përveçse një pakicë e të varfërve dhe sikur ata të mos gjendeshin në varfërinë e tyre, nuk do të pasonin as ata.

Benu Rasibët i thanë: o Nuh, ti nuk je tjetër veçse një njeri sikurse ne, ti je një prej neve dhe sikur All-llahu të dëshironte do të dërgonte një melek të Dërguar, të cilin do ta dëgjonim dhe do t’i përgjigjeshemi thirrjes së tij. Pastaj ç’janë këta më të ultit e njerëzve, më të mbeturit e tyre, pronarët e prodhimeve të ndyta dhe mjeshtërve të ulëta, të cilët të pasojnë ty duke mos menduar thellë, pa shoshitur mendimet e tyre dhe pa u pjekur të menduarit e tyre. Sikur thirrja jote të ishte e mirë, ata nuk do të na paraprinin në të, e sikur të ishte e vërtetë ajo që thua, ne të zotët e mendjes, pronarët e mendimeve të pastërta dhe mendjeve balansuese, do të paraprinim me besim në ty dhe në pasimin e udhëzimit tënd.

Pastaj ata anuan kah diskutimi, u thelluan në bisedat boshe dhe vazhduan duke thënë: ne nuk shohim te ti dhe as te pasuesit tu kurrfarë vlere mbi ne, as në mendje, as në të menduar, as në shikim të largët, as në mbrojtjen e interesave dhe as në njohjen e përfundimit dhe fundin e gjithë kësaj, por ne mendojmë se ju jeni gënjeshtarë.

A thua fjalët mendjelehta të tyre, a e pëlcitën butësinë e pastërt të tij? A e ndryshuan ato mendimin dhe mendjen e tij të rëndomtë?

Nuhu a.s. tha: çfarë thuani sikur unë të jem në rrugë të qartë të Zotit tim, një argument dëshmuar i të vërtetës së thirrjes sime dhe se Ai më dha mëshirë dhe mirësi prej anës së Tij, kurse juve ju është verbuar qëllimi, u është përzier çështja dhe tentoni ta mbulonit diellin me krahët tuaj, apo t'i fshini yjet me duart tuaja. A kam mundësi unë t'ju detyroj, ose a kam pushtet unë që me forcë t'ju fus në besim?

Thanë: nëse ti na dëshiron neve udhëzimin dhe pëlqyeshmërinë dhe nëse ti dëshiron prej nesh ndihmën dhe përforcimin, atëherë largo prej tubimit dhe kafazit tënd këta njerëz të përzier, të cilët kanë besuar, hidhi ata prej mbrojtjes tënde, sepse ne nuk kemi mundësi të ecim në retë e tyre, as ta ndjekim metodën e tyre, as të bashkohemi me ta në bindje, e si, pra, t'i përgjigjemi një feje, në të cilën janë të barabartë paria me joparinë dhe mbreti me të mbretëruarit?

Nuhu a.s. u tha: kjo është një thirrje e përgjithshme dhe absolute për të gjithë ju, në të janë të barabartë i Dërguari i juaj dhe i padituri në mesin tuaj, i njohuri në mesin tuaj dhe i panjohuri, të pasurit tuaj dhe të varfërit, të udhëhequrit dhe udhëheqësit tuaj, e nëse unë i përgjigjem kërkesës tuaj dhe i përzë ata që ju dëshironi, atëherë kujt t'i mbështetëm në përhapjen e thirrjes dhe shpalljes time? Si pra, t'i përzë njerëzit të cilët më ndihmuan, kurse nga ju përjetova poshtërim, fjalët e mia depërtuan në shpirtrat e tyre, ndërsa prej jush gjeta vetëm refuzim dhe injorim? Pastaj si do të jetë gjendja ime me ta para All-llahut, kur ata të më akuzojnë dhe të ankohen para All-llahut se unë të mirën e tyre e ktheva me mohim të begatisë dhe bamirësinë e tyre me refuzim? Vëreni, ju vërtet jeni një popull injorant.

Pasiqë u ashpërsua diskutimi në mes tyre dhe të Dërguarit të All-llahut, Nuh a.s., ai u tha atyre: *“O populli im, unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë pasuri, shpërblimi im është vetëm tek All-llahu...”* (kaptina Hud: 29).

O populli im, unë nuk kërkoj pagesë për komunikim dhe thirrje tek All-llahu dhe për besim tek Ai, sepse shpërblimi im për komunikim të shpalljes është prej All-llahut të madhërishtëm.

Pastaj Nuhu a.s. tha: *“Unë nuk u them juve se tek unë janë depot e All-llahut, as nuk u them se unë e di të fshehtë, as nuk u them se unë jam melek, as nuk u them atyre që sytë tuaj i nënçmojnë, se All-llahu nuk u dhuroi atyre të mira. All-llahu e di më së miri se çka ka në shpirtrat e tyre, sepse atëherë unë konsiderohem zullumqar”* (kaptina Hud : 31).

Kur diskutimi u ashpërsua në mes të Nuhut a.s. dhe parisë së Benu Rasibëve, kur u zgjerua distanca e kundërshtimit, ata humbën shpresën në të dhe iu ngushtuan atyre gjoksat e tyre, por ai vazhdoi t'i luftojë ata, të diskutojë me ta, bëri durim në ta, i priti ata gjatë, u foli fjalë të ëmbla, nuk

lejoj që pesimizmi të depërtojë në zemrën e tij dhe vazhdoi të përpiqet në komunikimin e shpalljes së Zotit të tij... ata i thanë:

“Ata thanë: O Nuh, ti polemizove me ne dhe e zgjate polemikën tonë. Urdhëro, nëse flet të vërtetën, sillna pra, të na godasë ajo me çka na kërcënohesh!” (kaptina Hud : 32).

Përse Benu Rasibët shpejtojnë hakmarrjen e të Fortit e Ngadhënjyesit, të dënimit dhe të hidhërimit të Tij? A nuk e dinë ata se belaja është e varur nga të folurit? Përse kërkuan ata prej të Dërguarit të All-llaut, Nuhu a.s., që të lutet si të dëshirojë kundër tyre?

Nuhu a.s. tha: *“Atë ju sjell vetëm All-llahu, po qe se dëshiron, e ju nuk mund ta pengoni.”* (kaptina Hud : 33).

Atë vërtet ua sjell All-llahu i madhërishëm nëse Ai dëshiron zhdukjen dhe dënimin tuaj dhe ju me gjithë shumicën nuk do të fitoni...

Vagileja ishte këmbëngulëse në kryeneqësinë e saj ndaj thirrjes së hajrit me të cilën erdhi burri i saj, Nuhu a.s., madje kërkonte nga Benu Rasibët që të mos e pasojnë atë me të cilën ishte ardhur burri i saj dhe i informonte ata me sekretet e tij, kështu që kur dikush besonte në të, ajo i lajmëronte parinë dhe zullumqarët e popullit të saj. Por, e gjithë kjo nuk goditi vendosmërinë e të Dërguarit të All-llahut Nuh a.s., ai nuk u dobësua, por vazhdoi rrugën e thirrjes duke bartur vështirësitë dhe sprovat e komunikimit të shpalljes së Zotit të tij: *“Ne e dërguam Nuhun te populli i vet, e ai kaloi ndër ata një mijë pa pesëdhjetë vjet...”* (kaptina El-Ankebut : 14).

Për çfarë arsye nuk tha i Gjithëdijshmi, i Gjithinformuari, se ai kaloi ndër ta 950 vjet? A kishte ky për qëllim shumimin e numrit? A thua përmendja e numrit një mijë ka qenë më e shumta në fjalë dhe në numër? Apo mos është fjala se Nuhu a.s. kishte nga jeta e tij një mijë vjet, por pesëdhjetë vjet ia dhuroi një prej fëmijëve të tij, Davudit a.s., e kur i erdhi vdekja, u rikthye në plotësimin e njëmijëshit, e All-llahu e përmendi këtë që të na tërheqë vërejtjen se mangësia ishte prej anës së tij? Dijetarët dhanë mendime të ndryshme për gjatësinë e jetës së tij. Është thënë se: ai jetoj aq sa e përmendi All-llahu në Librin e Tij.

Ibn Abbasi r.a. tha: Nuhu a.s. u dërgua peygamber në moshën dyzetvjeçare, qëndroi në mes të popullit të tij një mijë pa pesëdhjetë vjet dhe jetoj pas përmbytjes edhe gjashtëdhjetë vjet derisa u shumuan dhe u përhapën njerëzit.

Poashtu transmetohet se Abdullah Ibn Abbasi r.a. tha: ai u dërgua peygamber kur i kishte 250 vjet, qëndroi në mesin e popullit të tij një mijë pa pesëdhjetë vjet dhe jetoj pas përmbytjes edhe 200 vjet.

Vehbi tha: jetoj Nuhu a.s. 1400 vjet.

Ka'b El-Ahbari r.a. tha: qëndroi Nuhu a.s. në popullin e tij një mijë pa pesëdhjetë vjet, jetoj pas përmbytjes 350 vjet, kështu që jeta e tij arriti 1650 vjet.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Kur All-llahu e dërgoi Nuhun te populli i tij, ai ishte 250-vjeçar, ai qëndroi në mesin e popullit të tij një mijë pa pesëdhjetë vjet dhe jetoi pas përmytjes edhe 250 vjet. Asnjë pejgamber nuk përjetoi atë që përjetoi Nuhu prej popullit të tij Beni Rasibëve, por ai duroi dëmtimet e tyre dhe qëndroi përballë përqeshjes së tyre...”**

Një ditë një njeri nga Beni Rasibët bartte një fëmijë mbi krahërorin e tij, kur Nuhu a.s. kaloi pranë tij, babai fëmijës së tij i tha: ruaju nga ky që të mos devijosh. Atëherë, fëmija i vogël i tha babait të tij: o babai im, më zbrit mua. Ai e zbriti dhe ai e gjuajti me gurë të Dërguarin e All-llahut, Nuhun a.s. dhe e gërvishi atë. Me këtë rast Nuhu a.s. u hidhërua dhe bëri lutje ndaj tyre.

Është thënë se Nuhu a.s. bëri lutje kundër popullit të tij, pasiqë All-llahu i shpalli atij: *“... nuk do të besoj më askush nga populli yt, përveç atyre që kanë besuar...”* (kaptina Hud : 36).

Në Beni Rasibët u shtuan mëkatet, u shumuan zullumqarët dhe kundërshtuan me forcë të madhe, kurse Nuhu a.s. i ftonte ata natën, ditën, fshehtas, haptas, ishte durimtar i madh, i urtë dhe asnjë prej pejgamberëve nuk përjetoi atë që përjetoi ai. Atij i hynin në shtëpinë e tij dhe dëshironin ta ngulfasin, e goditnin nëpër tubime dhe e dëbonin, megjithëkëtë ai nuk lutej kundër atyre për këto veprime, por i ftonte dhe thoshte: o Zot, fale popullin tim, sepse ata nuk dinë.

Por, a iu zbutën zemrat e tyre dhe a iu përgjigjen thirrjes së tij? Kjo atyre nuk u shtoi përveçse ikje prej tij, derisa kur ai i folte ndonjërit prej tyre, e mbështillte kokën e tij me teshë dhe i fuste gishtat e tij në vesh që të mos dëgjojë asgjë prej fjalëve të tij: *“Dhe sa herë që unë i thirrja ata për t’u falur Ti atyre mëkatet, ata i vënin gishtat e tyre në vesh dhe mbulonin kokat me teshat e tyre dhe vazhdonin në atë të tyren me një mendjemadhësi të fortë.”* (kaptina Nuh : 7).

Ibn Abbasi r.a. tha: Nuhun a.s. e rrihnin, pastaj e mbështillnin me lëkurë të leshtë dhe e hidhnin në shtëpinë e tij, mendonin se ai kishte vdekur, pastaj ai dilte dhe i ftonte prapë derisa humbi shpresën në besimin e popullit të tij. Erdh një njeri me djalin e tij, e ky ishte i mbështetur në shkop, i tha ai djalit të tij: o biri im, ruaju nga ky plak që të mos mashtrojë. Ai i tha: o babai im, më jep atë shkop, të cilin ia jepte, pastaj i thoshte: më zbrit në tokë. Pastaj kur zbriste, e godiste Nuhun a.s. me atë shkop, i gërvishte atij trupin dhe i rridhte gjaku nga koka e tij. Atëherë Nuhu a.s. tha: o Zot, Ti e sheh atë që janë duke bërë robërit e Tu, nëse ka mbetur në ta ndonjë hajr, udhëzoi, e nëse është diç tjetër, më dhuro durim derisa Ti të gjykosh dhe Ti je Gjykatësi më i mirë.

Atëherë All-llahu i shpalli atij duke i hequr çdo shpresë në besimin e popullit të tij dhe e informoi se nuk ka mbetur në kurrizin e meshkujve, e as në mitrat e grave ndonjë që do të besojë.

“E, Nuhut i qe shpallur: “Nuk do të besojë më askush nga populli yt, përveç atyre që kanë besuar (deri më tash), pra mos u brengos për atë që punojnë ata.” (kaptina Hudë : 36).

Është thënë: kur Nuhu a.s. pa se u janë vulosur zemrat popullit të tij, se u janë mbyllur ato, nuk i nënshtroreshin kurrfarë argumenti e sqarimi dhe nuk e dëgjonin të vërtetën e besimin:

“Dhe ata u kurdisën atyre kurthe shumë të mëdha.” (kaptina Nuh : 22).

Do të thotë nxiten që të vritet Nuhu a.s., atëherë ai humbi durimin e tij dhe tha:

“O Zoti im, mos lë mbi tokë asnjë nga jobesimtarët! Sepse, nëse Ti i lë ata, robërit e Tu do t'i humbin dhe prej tyre nuk lind tjetër, vetëm të prishur e jobesimtarë.” (kaptina Nuh : 26-27).

I Gjithëdijsmi dhe Ai që sheh çdo gjë, iu përgjigj lutjes së të Dërguarit të Tij dhe i shpalli atij:

“E, Nuhut i qe shpallur: “Nuk do të besojë më askush nga populli yt, përveç atyre që kanë besuar (deri më tash), pra mos u brengos për atë që bëjnë ata. E, mbaroje anijen nën mbikëqyrjen Tonë dhe me mësimin Tonë, e mos m'u drejto Mua për ata që bëjnë zullum, ata gjithqysh janë të përmbytur.” (kaptina Hud : 36-37).

Pas kësaj i Dërguari i All-llahut, Nuhu a.s., shkoi në një vend larg qytetit dhe filloi të përgatisë dërrasat dhe gozhdat, por ai nuk shpëtoi prej përqeshjes së Beni Rasibëve, e disa prej tyre i thanë: a u mërzite me pejgamberllëkun apo lakmove zdrukthtarinë?

“Dhe ai ndërtonte anijen, e paria e popullit të tij, sa herë që kalonte pranë tij përqeshej me të...” (kaptina Hudë : 38).

Kur ata panë se po përgatitet të ndërtojë anijen dhe më parë nuk kishin parë ndërtim të anijes, thanë: o Nuh, ti pas pejgamberllëkut u bërë zdrukthtar! Dhe thanë: o Nuh, çfarë po bën?

Nuhu a.s. u tha: po ndërtoj një shtëpi që do të lundrojë mbi ujë. Ata u çuditën me të, u përqeshën me fjalën e tij dhe pyetën: pse kjo anije që ti po e ndërton është kaq larg prej lumenjve dhe detrave? A i ke bërë gati kijet që ta tërheqin atë, apo e ke ngarkuar erën që ta bartë atë? Disa të tjerë i thanë: ndoshta do ta bëjë që të lundrojë nëpër rërë.

Nuhu a.s. tha: *“...nëse talleni me ne...”*, d.m.th. nga puna jonë sot gjatë ndërtimit të anijes *“... edhe ne do të tallemi me ju...”*, d.m.th. kur të përmbytëni. Me talljen këtu është për qëllim të qenit injorantë dhe do të thotë ashtu si ju na konsideroni sot për injorantë, edhe ne do t'u konsiderojmë juve për injorantë. Nuhu a.s. ishte i bindur në premtimin e Zotit të tij të madhërishëm dhe se ai bashkë me ata që kanë besuar në të do të tallen me idhujtarët në të ardhmen.

Kur All-llahu i madhërishëm i shpalli Nuhut a.s. që ta ndërtojë anijen, ai tha: o Zot, unë nuk jam zdrukthtar. All-llahu i madhërishëm i tha: gjithsesi, ti do ta bësh atë para syve të Mi.

Atëherë ai e mori në dorën e tij sharrën, por dora e tij gabonte, kështu që Benu Rasibët kalonin pranë tij dhe i thonin: ky i cili supozonte se është i Dërguar, u bë tani zdrukthtar!

Ai e ndërtoi anijen për dyzet vjet.

Është thënë se: ai nuk dinte si ta ndërtojë anijen, e All-llahu i shpalli atij që ta ndërtojë atë si kraharorët e shpendit. E ai e ndërtoi atë për tridhjetë vjet.

Është thënë se: melekët e mësuan atë se si ta ndërtojë.

Abdullah Ibn Abbasi r.a. tha: Nuhu a.s. e ndërtoi anijen për dy vjet.

“E, mbaroje anijen nën mbikëqyrjen Tonë dhe me shpalljen (mësimin, inspirimin) Tonë...” (kaptina Hudë : 37).

Nuhu a.s. tha: o Zot, e ku është druri? All-llahu i madhërishëm i tha: mbilli drunjtë. Atëherë Nuhu a.s. e mbolli drurin e quajtur “saxh” (tectona grandis) për njëzet vjet. Gjatë kësaj kohe ai më nuk ftonte, kështu që populli i tij ndërpreu përqeshjen. Kur pemët u rritën, e urdhëroi Zoti i tij që t’i prejë ato, të cilat ai i teri, e tha: o Zot, si ta ndërtoj këtë shtëpi? All-llahu i madhërishëm i tha: ndërtoje atë në tri pamje, koka e saj le të jetë si koka e gjelit dhe gjoksi i shpendit, kurse bishti i saj le të jetë si bishti i gjelit, bëre atë në kate, bëri asaj dyer anësore dhe forcoje me gozhda të hekurit.

All-llahu i madhërishëm e dërgoi Xhibrilin a.s., i cili e mësoi Nuhun a.s. ta ndërtojë anijen, kështu që dora e tij nuk gabonte më.

Abdullah Ibn Abbasi r.a. tha: shtëpia e Nuhut a.s. ishte në Damask, anijen e ndërtoi prej drurit të Libanit, të cilën e ndërtoi në mes të pusit të Zemzemit dhe Ruknit (të Qabes) dhe të Mekamit. Kur anija u plotësua, në derën e parë i futi egërsirat dhe shtazët, kurse në të dytën i futi shpendët dhe i mbylli ato, ndërsa njerëzit, dyzet burra dhe dyzet gra, i vendosi aty ku nuk mund t’i shkelnin shtazët.

Thuhet se: All-llahu i madhërishëm e dërgoi një erë, e cila barti në anije nga të gjitha gjallesat qift, nga egërsirat, shpendët dhe shtazët.

Poashtu është thënë se: All-llahu i madhërishëm e dërgoi Xhibrilin a.s., i cili i tuboi ato, ai me duart e tij i kapte qiftët, dora e tij e dhathtë binte mbi gjininë mashkullore, kurse dora e tij e majtë mbi atë femërore dhe pastaj i lëshonte në anije.

Nuhu a.s. gjeti vështirësi ta fusë në anije dhinë, të cilën ai e shtyu nga bishti me dorën e tij dhe prej atëherë iu këput ai, u dredhua dhe iu shfaq turpi. Delja shkoi derisa hyri brenda dhe fshiu bishtin e saj, kështu që iu mbulua turpi i saj.

Thuhet se i Dërguari i All-llahut, Nuhu a.s., e ndërtoi anijen me inspirim të All-llahut të madhërishëm dhe me mësimin e Tij. Ai e urdhëroi që të mbjellë drurin, ta prejë atë dhe ta terë, të gjithë këtë gjatë njëqind vjetëve, pastaj e ndërtoi atë për njëqind vjet të tjera. Thuhet se edhe e ndërtoi atë për dyzet vjet (transmetoi Tha’lebiu).

Ka’bi r.a. tha: e ndërtoi për tridhjetë vjet.

Poashtu nuk u pajtuan dijetarët rreth gjatësisë dhe gjerësisë së saj, e Abdullah Ibn Abbasi r.a. tha: gjatësia e saj ishte treqind kut, kurse gjerësia pesëdhjetë kut dhe thellësia ishte tridhjetë kut.

Muhammed Ibn Is'haku duke transmetuar nga Tevrati tha: All-llahu i madhërishëm e urdhëroi atë që ta ndërtojë anijen prej drurit të quajtur "Saxh" (tectona grandis), gjatësinë e saj ta bëjë tetëdhjetë kut, gjerësinë ta bëjë pesëdhjetë kut, brendësinë dhe jashtësinë e saj ta lyejë me zift dhe t'i bëjë asaj një gjoks me të cilin do të çajë ujin.

Katadeja tha: gjatësia e saj ishte treqind kut, kurse gjerësia ishte pesëdhjetë kut.

Hasan El-Basriu tha: gjatësia e anijes ishte një mijë e dyqind kut, kurse gjerësia e saj ishte gjashtëqind kut.

Një ditë havarijtë (apostujt) i thanë Isaut, të birit të Merjemes a.s.: sikur të na ringjallje ndonjë nga njerëzit të cilët e panë anijen që të na flasë për të. Atëherë ai shkoi me ta derisa arritën te një kodrinë e dheut, e mori një grusht dhe dhe tha: a e dini se ç'është këta? Thanë: duhet të jetë Hami, i biri i Nuhut a.s.. Atëherë ai i ra kodrinës me shtagën e tij dhe tha: qohu me urdhërin e All-llahut. Ai menjëherë u ngrit duke shkundur dheun nga koka e tij dhe ishte zbardhur, Isau a.s. i tha: a kështu ke vdekur? Hami, i biri i Nuhut a.s. tha: jo, unë vdiqa i ri, por mendova se tani u bë Kijameti, kështu që u plaka.

Isau a.s. i tha: na trego për anijen e Nuhut a.s., e ai tha: gjatësia e saj ishte një mijë e dyqind kut, gjerësia e saj ishte gjashtëqind kut dhe ishte në tre kat, në një kat ishin shtazët dhe egërsirat, në një kat ishin njerëzit dhe në katin tjetër ishin shpendët. Lartësia e anijes ishte tridhjetë kut dhe në tre kat, çdo katë ishte dhjetë kut, dera e saj ishte sa gjerësia e saj dhe kishte një kapak në pjesën e sipërme që e mbyllte nga lart.

Paria e Benu Rasibëve iu kthyen përqeshjes së tyre. Shikuan anijen e Nuhut a.s. dhe me të ishin një pakicë e atyre që e kishin pasur, e njëri nga mendjemëdhentët tha: përse besimtarët të cilët janë me ty nuk i kanë marrë me vete kovat plot me ujë e t'i derdhin nën anijen tënde, që kështu ajo të ketë bereqet?

Një tjetër tha: a do ta afrosh detin këtu që ne të hipim në anije? Por Nuhu a.s. heshti.

Vagileja shkoi dhe i informoi parinë dhe aristokracinë e Beni Rasibëve për pikëllimin e burrit të saj si shkak i mosbesimit të tyre në thirrjen e tij, ajo nuk mund të fshihte dëfrimin dhe gëzimin e saj për pikëllimet e të Dërguarit të All-llahut, Nuh a.s., ajo pasoi popullin e saj Beni Rasibët dhe ndoqi rrugën e tyre, rrugën e mosbesimit, kështu që tradhtoi besnikërinë martesore. Nuk e frikësonte atë asnjë besim, moral apo ndonjë ndjenjë e përgjegjësisë.

Vagileja shkoi te tempulli i madh, ku ishin Benu Rasibët, të cilët diskutonin gjendjen në të cilën kishte arritur Nuhu a.s., e kur ata e panë gruan e tij,

menjëherë e pyetën për lajmet e burrit të saj, e ajo tha: ai përfundoi ndërtimin e anijes së tij. Ata duke u përqeshur thanë: a është duke supozuar ende se ne do të fundosemi në dënimin e Zotit të tij, kurse ai do të shpëtojë me ata të varfër që e kanë pasuar?

Vagileja u tha: po, ende e thotë atë. Ata thanë: si do të arrijë tek ai uji, kur anijen e tij e ka ndërtuar në tokë? A ka në tokë lumë apo det? A nuk do të ndalet ai nga kërcënimi ndaj nesh, e ne do ta kuptojmë se kujt do t'i vijë dënimi?

“E kur erdhi urdhri ynë (i caktuar për ndëshkim) dhe gufoi (uji) prej furrës...” (kaptina Hudë : 40).

Dijetarët dhanë mendime të ndryshme për fjalën “tenur – furra”, disa thanë: është fjala për sipërfaqen e tokës, sepse arabët sipërfaqen e tokës e quajnë “tenur”, kështu që Nuhut a.s. i është thënë: kur ti sheh ujin në sipërfaqen e tokës, hip ti dhe ata që janë me ty në anije.

Poashtu është thënë: ajo ka qenë një furrë e bukës, e ndërtuar prej guri, e cila ishte e nënës së njerëzimit, Havas dhe ajo kishte mbetur te Nuhu a.s., kështu që atij i është thënë: kur ta shohësh ujin duke gufuar nga furra, ti dhe pasuesit e tu hipni në anije.

Kur uji filloi të gufojë nga furra, e kuptoi këtë gruaja e Nuhut a.s. dhe tha: o Nuh, filloi uji të gufojë nga furra. Atëherë i Dërguari i All-llahut, Nuhu a.s., tha: erdh premtimi i Zotit tim me të vërtetë.

Është thënë se tenuri ishte: vendi i tubimit të ujit në anije. Poashtu është thënë se: është fjala për lindjen e agimit dhe dritën e mëngjesit.

“... Ne i thamë: “Ngarko në të prej çdo krijese nga një çift edhe familjen tënde, përveç për kë është marrë vendimi i hershëm kundër tij, e (ngarkoje) edhe kush ka besuar, po përveç një pakice, të tjerët nuk i kishin besuar atij.” (kaptina Hudë : 40).

I Dërguari i All-llahut, Nuhu a.s., priti se si do të jetë urdhri i All-llahut të madhërishtë, e kur Ai i shpalli, ai barti në anijen e tij nga çdo lloj çift, mashkull dhe femër, që kështu të mbijetojë ai lloj pas tufanit, d.m.th. prej çdo lloji çift, prej të gjitha krijesave me shpirt: prej shtazëve, zvarranikëve, shpendëve dhe prej bimëve.

Katin e parë të anijes Nuhu a.s. e përgatiti për shtazët dhe egërsirat, të mesmin për njerëzit dhe të lartin për shpendët.

Poashtu është thënë se: uji hyri në anijen e Nuhut a.s. katër kut dhe ajo kishte tri dyer. Në një derë ishin shtazët dhe shpendët, në një derë ishin egërsirat dhe në një derë ishin burrat dhe gratë.

Abdullah Ibn Abbasi r.a. tha: ai anijen e bëri me tri barqe, në të parin vendosi egërsirat dhe shtazët, në të mesmin vendosi ushqimet dhe pijet, kurse ai hypi në më të lartin dhe barti me vete trupin e Ademit a.s., të cilin e vendosi në mes të burrave dhe grave.

Thuhet se erdhën gjarpri dhe skorpioni që të hipin në anije, e Nuhu a.s. u tha: ju dyve nuk u barti në anije, sepse ju jeni shkaktar të çdo dëmtimi dhe belaje.

Ata i thanë: ti na bart neve, e ne të garantojmë se nuk do ta dëmtojmë asnjë që ty të përmendë.

Prandaj, ai që i frikohet dëmtimit të tyre dhe e thotë këtë ajet: “*Selam i qoftë Nuhut (prej All-llahut e prej krijesave) në mbarë botën (si kujtim ndaj tij).*” (kaptina Safat : 79), nuk do ta dëmtojë ata.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Ai që thotë kur të ngrysë: Sal-lAllahu ala Nuhin ve ala Nuhin es-selam – All-llahu e lavdëroi Nuhin dhe mbi Nuhin qoftë paqja, nuk do ta kafshojë atë natë skorpioni.”** (transmetoi Ibn Asakiri në historinë e tij prej Ebu Umames).

Thuhet se: i fundit i cili hyri nga shtazët në anije ishte gomari, për bishtin e të cilit u lidh Iblisi. Ai tentonte të ngritej, por Iblisi e rëndonte, sepse ishte ngjitur për bishtin e tij. Atëherë Nuhu a.s. i tha: mjer për ty, ç’është me ty, hyr. Gomari u ngrit, por prapë nuk pati mundësi, atëherë Nuhu a.s. i tha: hyn edhe nëse Iblisi është me ty. Kështu ata hynë që të dytë.

Ata nuk patën mundësi ta bartin me vete luanin, derisa nuk i ranë atij ethet. I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Kur Nuhu barti në anijen e tij prej çdo lloji nga një çift, shokët e tij i thanë: si do të qetësohen shtazët, kur me to është luani? Atëherë All-llahu ia dërgoi atij ethet dhe ato ishin ethet e para të cilat zbritën në tokë.”** (transmetoi Ebu Hatimi).

Nuhu a.s. i barti me vete në anije familjen dhe të afërmit e tij: “... përveç për kë është marrë vendim i hershëm kundër tij”, d.m.th. është marrë vendimi për shkatërrim, e ai është i biri i tij Ken’ani dhe gruaja e tij, Vagileja, të cilët ishin pabesimtarë. Dhe është thënë: barti ata që kanë besuar në Mua. Nuhu a.s. i barti me vete ata të cilët kishin besuar në të: “... po përveç një pakice nuk i kishin besuar atij.” (kaptina Hudë : 40).

Abdullah Ibn Abbasi r.a. tha: besuan prej popullit të tij tetëdhjetë njerëz, tre nga ata ishin djemtë e tij: Sami, Hami dhe Jafethi dhe tri rejat e tij.

Katadeja tha: në anije ishin vetëm tetë persona: Nuhu dhe gruaja e tij (tjetër nga ajo që nuk i besoi), tre djemtë e tij dhe gratë e tyre.

Ibn Is’haku tha: në anije ishin dhjetë, përveç grave të tyre, Nuhu dhe bijtë e tij: Sami, Hami dhe Jafethi dhe gjashtë njerëz të cilët kishin besuar në të, si dhe gratë e tyre.

Ka’b El-Ahbari r.a. tha: ata ishin shtatëdhjetë e dy veta.

Kurse El-A’meshi tha: ata ishin shtatë, Nuhu a.s., tri rejat dhe tre djemtë.

Hami bëri marrëdhënie me gruan e tij në anije, atëherë Nuhu a.s. iu lut All-llahut që t’ia ndryshojë spermën e tij, kështu që erdhën nga ai sudanezët - afrikanët.

Thuhet se Nuhu a.s. u lut kundër djalit të tij, Hamit, që flokët e fëmijëve të tij të mos i kalojnë veshët e tyre dhe kudo që janë ata të jenë robër të Samit dhe Jafethit.

“Dhe ai tha: “Hipni në të, me emrin e All-llahut ajo lundron dhe ndalet. Vërtet, Zoti im është që fal shumë, është mëshirues.” (kaptina Hudë : 41).

Urdhri i All-llahut të madhërishëm erdhi që të hipin, qielli filloi të lëshojë shi të madh dhe Nuhu a.s. hipi në anije me datën dhjetë të muajit Rexheb.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Nuhu hipi në anije me një Rexheb, e agjëroi atë muaj në tërësi dhe anija lundroi deri në ditën e Ashureve, atë ditë u ndal mbi kodrën Xhudij, kështu që Nuhu e agjëroi atë ditë bashkë me ata që ishin me të.”** (transmetoi Taberiu).

Shiu filloi të bjerë me furi dhe pandërprerë, Benu Rasibët ikën nëpër shtëpitë e tyre që të mbrohen në to.

Nuhu a.s. tha: në emër të All-llahut le të jetë lundrimi i saj mbi faqen e ujit dhe në emër të All-llahut është përfundimi i lundrimit të saj.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: “Siguri e ummetit tim prej përmytjes kur ata hipin në anije është të thonë: Bismil-lahil-Melik – në emër të All-llahut i Cili është Mbreti”.

U hapën dyert e qiellit dhe shpërthyen burimet e tokës: *“... kurse uji u bashkua siç ishte caktuar.”* (kaptina El-Kamer : 12).

Vërshimi i kaloi luginat dhe pastaj i kaloi kodrat dhe luginat.

Anija e Nuhut a.s. ishte kopshti i parë zoologjik, i cili lundroi mbi ujë derisa uji përfshiu tokën në përgjithësi dhe i mbuloi kodrat e saj.

“E kur të vendosesh ti dhe kush është me ty në anije, atëherë thuaj: “Falënderuar qoftë All-llahu, i cili na shpëtoi prej popullit zullumqarë.” (kaptina El-Mu'minin : 28).

Anija filloi të lundrojë me urdhërin e All-llahut, nën mbikëqyrjen, kujdesin, mbrojtjen dhe mirësinë e tij: *“Që lundronte në mbikëqyrjen Tonë. (I fundosëm) Si ndëshkim për atë (Nuhun) që ishte mohuar (përbuzur).”* (kaptina El-Kamer : 14).

Nuhu a.s. lëshoi shikimin e tij mbi shpinën e anijes, me ç'rast pa djalin e tij, Ken'anin, i cili iu dhimb derisa ai qante për thellësitë e ujit dhe valët e tij, valë të cilat kishin hapur në brendësinë e tyre varre për pabesimtarët, kurse shkuma e saj u qepte atyre qefin. I Dërguari i All-llahut, Nuhu a.s., shikoi birin e tij, i cili luftonte me vdekjen, pasi që ishte distancuar nga babai i tij, ishte larguar nga feja e tij, e në atë moment atë vdekja e kaplonte dhe ai përleshej me kodra valësh, ai e thirri: *“O djali im, hip bashkë me ne, e mos u bë me mohuesit!”* (kaptina Hudë : 42).

Kthehu dhe bashkohu me ne, por ai dëshiroi të ngjitej në maje të malit. Ai supozoi me paditurinë e tij se tufani nuk do ta arrijë atë dhe se ai me këtë përpjekje do të shpëtojë nga përmytja, e i tha babait të tij: *“Ai (djali) tha: “Unë do të ngjitem në një kodër që do të më mbrojë nga uji (vërshimi)!”, kurse Nuhu a.s. i tha: “... tha: nuk ka sot mbrojtës prej dënimit të All-llahut, pos atë që Ai e ka mëshiruar...”* (kaptina Hudë : 43).

Ken'ani u mundua të mbrohet me një mal apo kodër, e cila do ta shpëtonte, por përmytja dhe vdekja iu afronin. Atëherë iu zbut zemra babait të tij

Nuhut a.s., u shfaq butësia e tij dhe gufoi dhembshuria dhe dashuria e tij në të, kështu që e thirri, e ndoshta thirrja e tij depërton në vendin e besimit të tij në zemër dhe kështu ai beson, e pason të mirën, të saktën dhe rrugën e drejtë ose i kthehet pjekurisë së tij. Por megjithëkëtë, fjalët e babait të tij nuk depërtuan në ndjenjat e tij dhe një valë i ndau ata: *“... vala hyri mes tyre të dyve, e ai (djali) u mbyt në ujë”*, pas kësaj Nuhu a.s. nuk pati mundësi ta shohë djalin e tij dhe frytin e mushkërive të tij. U përmytën të gjithë ata që ishin në tokë.

Nuhu a.s. pastaj i tëri i rrëqethur, duke kërkuar ndihmë dhe duke u ndier në fatkeqësi, u drejtua në një vendstrehim dhe tha: *“... o Zoti im, djali im është i familjes sime, e premtimi Yt është i saktë, kurse Ti je Gjykatësi më i mirë.”* (kaptina Hudë : 45).

All-llahu i madhërishëm kishte premtuar, e premtimi i Tij është i vërtetë, por Ken’ani, i biri i Nuhut a.s., u përmyt, u përmyt edhe gruaja e tij, e edhe idhujtarët dhe pabesimtarët. Shpëtoi i Dërguari i All-llahut dhe ata që besuan në të. Ai, All-llahu, gjykoi që disa njerëz të shpëtojnë dhe disa të tjerë të përmytën. Urdhri u krye dhe caktimi u realizua.

I Gjithëdijsmi dhe i Gjithinformuari thotë: *“... o Nuh, ai (djali) nuk ishte nga familja jote (për të cilën të premtova se do t’i shpëtojë), ai ishte punëkeq...”* (kaptina Hudë : 46).

D.m.th. ai nuk është prej familjes tënde, të cilët të premtova se do t’i shpëtoj, ai ishte i familjes së mohuesve dhe përgënjeshtresve. Pastaj, Ai që dëgjon dhe sheh çdo gjë, thotë: *“... e ti mos më kërko Mua atë që nuk di, Unë të këshilloj që të mos bëhesh nga injorantët!”* (kaptina Hudë : 46).

D.m.th. Unë ta ndaloj këtë kërkesë dhe të këshilloj që kështu të mos jesh prej injorantëve (gabimtarëve).

Nuhu a.s. tha: *“Zoti im, unë mbështetem në mbrojtjen Tënde që të (mos) kërkoj prej teje atë për çka nuk kam njohuri, e në qoftë se nuk më fal mua dhe nuk më mëshiron Ti, do të jem i humbur!”* (kaptina Hudë : 47).

U rrëqeth Nuhu a.s. me rrëqethje të një robi besimtar, i cili frikësohet të ketë rrëshqitur në të drejtën e Zotit të tij, prandaj kërkon strehim tek Ai dhe kërkon faljen dhe mëshirën e Tij. E cila mëshirë e arriti atë dhe zemra iu qetësua atij.

Nuhu a.s. kishte me vete në anije dy margaritarë të ndritur, njëri ishte në vend të diellit, kurse tjetri në vend të hënës, njëri i bardhë si drita e ditës, kurse tjetri i zi si terri i natës, me të ai i dinte kohët e namazeve, kur ngryste errësira e këtij kaplonte dritën e këtij, kurse kur gdhinin, drita e këtij kaplonte errësirën e këtij, sipas orëve të caktuara.

Thuhet se Nuhu a.s. e pa Shejtanin duke kënduar në anije, të cilit i tha: o i mallkuar, kush të futi në shtëpinë time? Iblisi i tha: ti më lejoje mua. Pastaj ia përmendi atë që ndodhi me gomarin, e Nuhu a.s. i tha: çohu dhe dil. Tha Shejtani: ti nuk ke dorë të bartësh me vete. Ai ishte nga ata që udhëhiqnin në shpinën e anijes.

Disa ditë pas përmytjes së banorëve të tokës në përgjithësi, përveç banorëve të anijes, urdhëroi All-llahu i madhërishëm që uji i furishëm të ndërpritej dhe që toka të përbijë ujin: “*E iu pati thënë: “Oj tokë, përbije ujin tënd dhe o qiell, ndërpreje (shiun).”* (kaptina Hudë : 44). Toka e përbiu ujin që ishte mbi të, kurse uji i shiut kaloi në detra: “*... uji u tërhoq.*”, d.m.th. u pakësua vetë dhe pakësoi të tjerat, dhe: “*... urdhri u zbatua.*” (kaptina Hudë : 44).

Anija u ndal mbi malin Xhudij me dhjetë Muharrem, thuhet se ajo u ndal në një mal në Gadishullin Arabik, apo në Musul, kurse disa të tjerë thanë se ajo u ndal në kodrën Tur, ditën e xhuma (e premte), e cila ditë ishte dita e Ashura-s. Nuhu a.s. u tha atyre që ishin me të: ai që është agjërueshëm, le ta plotësojë agjërimin e tij, kurse ai që nuk është agjërueshëm, le ta agjërojë këtë ditë. Ata e agjëruan këtë ditë si falënderim për All-llahun e madhërishëm.

Thuhet se All-llahu i madhërishëm u shpalli kodrave të tokës se anija do të ndalet në njërin nga ato, atëherë të gjitha kodrat zgjatën kokat e tyre, përveç El-Xhudis-ë, e cila nuk e bëri këtë duke u përlur për All-llahun, e anija u ndal mbi të.

Thuhet se El-Xhudij është emër i çdo kodre dhe thuhet se ajo është kodër e Xhenetit, prandaj anija u ndal mbi të.

Poashtu thuhet: All-llahu i fisnikëroi tri kodra me tre persona: El-Xhudinë me Nuhun a.s., Turi Sinan me Musaun a.s. dhe Hiran me Muhammedin s.a.v.s..

Abdullah Ibn Abbasi r.a. tha: me Nuhun në anije ishin tetëdhjetë burra me gratë e tyre dhe qëndruan në të njëqind e pesëdhjetë ditë. Pastaj All-llahu e drejtoi anijen kah Mekka, me ç’rast bëri tavaf (sjellje) rreth Qabës dyzet ditë, pastaj e drejtoi atë kah kodra El-Xhudiji mbi të cilën u ndal. Pas ndaljes së anijes Nuhu a.s. e dërgoi laraskën që t’i sjellë lajmet për tokën, por ajo u ndal mbi një cofinë dhe kështu u vonua, atëherë ai e dërgoi pëllumbin, i cili u kthye me një fletë të ullirit dhe i kishte zhytur këmbët me baltë, nga kjo Nuhu a.s. kuptoi se uji është tërhequr, prandaj ai zbriti në pjesën e poshtme të kodrës El-Xhudij dhe ndërtoi një fshat, të cilin e quajti “Tetëdhjetë”, d.m.th. fshati i tetëdhjetëve në periferi të Musulit. Një ditë kur ata gdhinë, ishin ndarë gjuhët e tyre në tetëdhjetë gjuhë, më e rrjedhshmja prej tyre ishte gjuha arabe, kështu ata filluan të mos kuptojnë gjuhët e njëri-tjetrit, kurse Nuhu a.s. shprehej për ta.

Ka’b El-Ahbari r.a. - i cili ishte hebre, e pranoi Islamin dhe ishte prej dijetarëve të Beni Israilëve - tha: anija lundroi në Lindje dhe Perëndim të tokës para se të ndalej mbi kodrën El-Xhudij.

“*... dhe ajo anija u ndal në (kodrën) Xhudij, e u tha: “I shkatërruar qoftë populli mizor!”* (kaptina Hudë : 44).

Kur i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. emigroi prej Mekkës në Jethrib (Medine), kaloi pranë disa hebrenjve të cilët agjëronin ditën e Ashuras,

imami i çdo mirësie i pyeti ata: **“Ç’është ky agjërime?”**. Thanë: kjo është dita – dita e Ashuras – në të cilën All-llahu e shpëtoi Musaun dhe Beni Israilët prej përmbytjes, në këtë ditë u fundos Faraoni dhe kjo është dita në të cilën anija e Nuhut u ndal mbi El-Xhudijin, prandaj Nuhu dhe Musa a.s. e agjëruan atë ditë si falënderim për All-llahun e madhërishëm. Atëherë vula e të gjithë pejgamberëve s.a.v.s. tha: **“Unë kam të drejtë në Musaun më shumë dhe kam më shumë të drejtë ta agjëroj këtë ditë”**. I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. e agjëroi ditën e Ashuras, madje agjëroi edhe një ditë para apo një ditë pas. (transmetuan Muslimi dhe Ahmedi).

Nuhu a.s. e varrosi trupin e Ademit a.s. në Bejtul-Makdis (në Aksa). Pastaj ai e ndërtoi një shtëpi prej kallami, e i thanë: sikur të kishe ndërtuar një tjetër (më të fortë)? Por Nuhu a.s. u tha: kjo është tepër për atë që do të vdesë.

Thuhet se: ai qëndroi treqind vjet në një shtëpi prej lëkure, e dikush i tha: o i Dërguar i All-llahut, ndërto një shtëpi. Mirëpo Nuhu a.s. i tha: sot apo nesër do të vdes.

Poashtu është thënë se Nuhu a.s. i kaloi pesëqind vjet pa iu afruar grave nga frika prej vdekjes.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Kur atij i erdhi meleku i vdekjes, i tha: o Nuh, o pejgamberi më i madh, o ti që jetove gjatë, o ti që lutja jote ishte e pranuar, si e pe këtë botë? Ai u përgjigj: si një njeri që ka një shtëpi me dy dyer, ka hyrë për njërën dhe ka dalë nga tjetra”**. Apo tha: **“Hyri për njërën, qëndroi aty pak, pastaj doli për derën tjetër”**.

VALIHEJA, GRUAJA E LUTIT A.S.

Doli Lut Ibn Harani – djali i vëllait të Ibrahimit a.s. – me xhaxhain e tij, Halilurr-Rahman (shoku i All-llahut, Ibrahimit a.s.) emigrues te Zoti i tij. Babai i pejgamberëve (Ibrahimit a.s.) iku me fenë e tij, duke lënë vendin dhe popullin e tij me shpresë se do të gjejë vesh që dëgjojnë dhe shpirta të pastër.

Ibrahimi a.s. u ndal në Harran, qëndroi aty sa dëshiroi All-llahu të qëndrojë dhe atë e shoqëronte edhe babai i tij, Azeri, i cili kundërshtonte Ibrahimin a.s. në fenë e tij dhe vazhdonte në mosbesimin e tij. Në atë kohë i përfshiu një thatësi e përgjithshme dhe u shtrenjtuan gjërat. Tarih Ibn Nahuri – Azeri – vdiq në mosbesimin e tij. Jetesa u vështirësua në tokat e Shamit, kështu që Halilurr-Rahman u shpërngul në Egjipt. Në këtë udhëtim e mori me vete edhe djalin e vëllait të tij, Lutin a.s..

Halilurr-Rahmani qëndroi në Egjipt sa All-llahu dëshiroi të qëndrojë aty, pastaj e vendosi të kthehet në Palestinë - e cila ishte tokë e Shamit - , ai vetë u vendos aty, kurse djalin e vëllait të tij, Lutin a.s. e dërgoi në Jordani. All-llahu i madhërishëm e dërgoi Lutin a.s. pejgamber te banorët e Sodomës – i cili ishte qyteti më i madh – dhe fshatrat që ishin rreth saj, e

ato ishin pesë fshatra, fshatrat e popullit të Lutit a.s.: Sibga, Sa've, Gamre (Gomorra), Duma dhe Sodoma.

Banorët e Sodomës ishin pabesimtarë, ishin të pamoralshëm dhe Zoti i tyre për ta thotë: “... *ju, bëni aq punë të shëmtuara sa askush para jush nga tërë bota nuk e ka bërë. Ju jeni që kontaktoni meshkujt, që sulmoni njerëzit në rrugë, që në vendtubimet tuaja bëni punë të ndyta...*” (kaptina Ankebutë: 28-29).

Luti a.s. i tha popullit të tij, duke ua tërhequr vërejtjen: ju u afroheni meshkujve, e kjo bënë që të ndërpritën pasardhësit dhe të anoni prej grave në meshkujt, e ky është homoseksualizmi, e cila gjë nuk ekzistonte në një popull tjetër para popullit të Lutit a.s..

Iblisi i mallkuar ishte thelbi i veprimit të popullit të Lutit a.s., i cili i ftoi që atë veprim ta bëjnë me të, kështu edhe ata filluan pastaj ta bëjnë ndërmjet vete.

Është thënë se: ata këtë vepër e bënë me të huajt. I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Kë e gjeni duke vepruar punën e popullit të Lutit, vritne vepruesin dhe të vepruarin me të”,** dhe tha: **“Më së shumti i frikohem ummetit tim prej veprimit të popullit të Lutit.”** Këtë vepër të popullit të Lutit nuk e bëjnë në mesin e shtazëve asnjë, përveç derrit dhe gomarit.

Sa i përket sulmit në rrugë, është fjala për udhtarët të cilët kur kalonin i sulmonin në rrugë, e vepronin atë punë të shëmtuar me të dhe kështu i merrnin njerëzit nga rruga që të bëjnë amoralitet.

Ummu Hani bintu Ebu Talib r.a. tha: e pyeta të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s. për fjalën e të madhërrishmit: “... *që në vendtubimet tuaja bëni punë të ndyta...*”, e ai tha: **“I gjuanin me gurë ata që kalonin pranë tyre dhe përqesheshin me ta, kjo ishte puna e ndytë që ata e bënë.”**

Poashtu ai s.a.v.s. tha: **“Populli i Lutit uleshin në vendtubimet e tyre, para çdonjërit nga ata kishte nga një kovë, në të cilën kishte gurë për hedhje, e kur kalonte andej pari ndonjë udhëtar, e gjuanin me gurë, e cili prej tyre e godiste, kishte më shumë të drejtë në të (të bëjë imoralitet me të), e kjo është fjala e tij: “që në vendtubimet tuaja bëni punë të ndyta.”** (transmetoi Tha'lebiu prej Muaviut).

Ajshja, Ibn Abbasi dhe El-Kasim Ibn Muhammedi r.a. thanë: pirdheshin në vendtubimet e tyre.

Disa të tjerë thanë: bënë homoseksualitet në vendtubimet e tyre, duke shikuar njëri-tjetrin.

Të tjerët thanë: e sulmonin udhëtarin në rrugë dhe e bënë atë veprim me të. I Dërguari i All-llahut, Luti a.s., i ftoi ata në adhurimin e All-llahut, ua ndaloj me urdhrin e All-llahut ato gjëra, të cilat All-llahu i madhërrishëm ua urrejti: sulmin në rrugë, veprimin e imoraliteteve dhe homoseksualizmin.

Por, populli i tij ishte i pamoralshëm, kishte qëllime të këqija, nuk përfundonin me të këqijat që i bënë, ishin njerëzit me shpirtligësinë dhe

sjelljet më të këqija, nuk kishin kurrfarë marreje, nuk i frikoheshin përkujtimit të përkujtuesit dhe nuk e dëgjonin këshillën e asnjë të mençuri. Ata në qetësi thanë: ç'është kjo që lllomotit dhe përzihesh në të, o Lut? Ata këtë e panë si lllomotitje! Luti a.s. u tha: o populli im, All-llahu është Një, nuk ka shoq, vetëm Ai duhet adhuruar, kjo është esenca e adhurimit, truri dhe zemra e tij.

Duke u përqeshur ata thanë: ku është ky All-llahu? Luti a.s. tha: Ai është afër, e nuk është larg, Ai është më afër se damari i qafës. Ata pyetën: e çfarë të bëjmë ne me idhujtë të cilët na ofrojnë më afër Tij? Luti a.s. tha: ato nuk u ofrojnë tek Ai, por u largojnë prej Tij, ata nuk mund t'i bëjnë vetes kurrfarë dëmi as dobie, e si t'u bëjnë juve dobi dhe t'u sjellin ndonjë hajr?

U larguan nga ai duke u përqeshur, i mbisundoi shejtani, duke i tërhequr në mëkate dhe duke u zbukuruar atyre epshtet. Kur Luti a.s. pa largimin e tyre prej bindjes ndaj tij, i frikësoi me dënimin e All-llahut, por ata nuk i vunë veshin qortimit të tij dhe u përqeshen me premtimin e tij, i thanë: “... nëse e thua të vërtetën, na sill dënimin nga All-llahu?” (kaptina El-Ankebutë : 29).

Ata kishin vendosur të përgënjeshtrojnë atë dhe besonin se ai nuk ka mundësi për këtë. Mirëpo në zemrën e Lutit a.s., e cila ishte e mbushur me iman, nuk depërtoi kurrfarë pesimizmi, ai vazhdoi me thirrjen e tij dhe e shpalli në mesin e tyre shpalljen e Zotit të tij.

Banorët e Sodomës u lëshuan në të këqijat e tyre, vazhduan në gjynahe, madje edhe e shtuan mosbesimin dhe kryeneqësinë e tyre, si dhe filluan të mendojnë si ta largojnë Lutin a.s. prej thirrjes së tij? Ata u tubuan që të diskutojnë, disa prej tyre thanë: kur Luti na fton që të ulemi tek ai, ne nuk do të ulemi tek ai dhe nuk do të dëgjojmë asnjë fjalë prej tij. Disa të tjerë thanë: përse nuk e pengojmë atë dhe t'i themi atij: o Lut, ti je duke folur fjalë të ndyta, a po na ndalon të adhurojmë ata që baballarët tanë i kanë adhuruar dhe ne i kemi pasuar në këtë?

Kurse disa të tjerë thanë: përse nuk e dëbojmë atë dhe pasuesit e tij prej qytetit tonë, sepse ata janë njerëz që spastrohen? Ata dëshirojnë të dëbojnë të Dërguarin e All-llahut dhe pasuesit e tij, sepse ata janë spastruar prej gjynaheve.

Një grua plakë tha: nëse dëshironi prishjen e thirrjes së Lutit, para jush e keni gruan e Lutit, Valihen? Të pranishmit pyetën: si? Ajo grua plakë tha: kur gruaja e Lutit t'u shoqërojë në atë që ju veproni, do të priset thirrja e tij ndaj jush. Njëri nga të pranishmit tha: por ti e di se ne nuk kemi kurrfarë nevojë për gra. Plaka u përgjigj: unë e di atë, por ne dëshirojmë që gruaja e Lutit të na udhëzojë tek ata burra që i dëshironi. Thanë: po..po.

Luti a.s. doli nga shtëpia e tij, kurse gruaja plakë u tërhoq si gjarpër dhe shkoi në shtëpinë e tij. Luti a.s. u tha banorëve të Sodomës: o populli im,

unë jam një këshilltar i singertë i juaji, u ftoj që të adhuronit All-llahun, të Vetmin i Cili nuk ka shoq dhe u ndaloj që të veproni këto punë të urrejtura. Thanë: nëse ti dëshiron shpërblim për këtë, ne do të shpërblejmë, e ti largohu nga kjo. Luti a.s. tha: o populli im, unë nuk lakmoj përfitim, nuk kam ndonjë interes, as nuk shpresoj ndonjë udhëheqësi, nuk kërkoj nga ju ndonjë shpërblim për udhëzim dhe nuk kërkoj pagesë për këshillë, shpërblimin tim unë e pres prej Zotit të botëve.

Ata u përqeshën me të dhe e sfiduan atë t'u sjellë atyre dënimin dhe t'u zbresë atyre ndëshkimin që e meritojnë. Gruaja plakë shkoi në shtëpinë e Lutit a.s. dhe filloi t'i flasë fjalë të ëmbëla Valihës, derisa e përfitoi zemrën e saj. Pastaj gruaja plakë shikoi dy vajzat e Lutit, Riten dhe Ra'zijen. Atëherë nëna e tyre kërkoi nga ato të dyja të lëshojnë atë vend e ato u ngritën duke shikuar gruan plakë me sy që i mbulonin dyshimi dhe habia.

Gruaja plakë iu afrua gruas së Lutit dhe i tha: oj bija ime, ç'është puna me burrin tënd dhe me banorët e Sodomës? Ata shpresojnë kënaqësinë e cila është burim i pasurimit për ata që i ndihmojnë. Valiheja pyeti: çfarë ke për qëllim me burimin e pasurimit për ata që i ndihmojnë? Gruaja plakë, duke e futur në dorë një copë të argjendit, i tha: punë e lehtë, ti je në një shtëpi në të cilën vijnë rinia dhe burra që ta vizitojnë burrin tënd, të cilët i ka mashtruar thirrja e tij. Kur ata të jenë këtu, ti dërgo Ritën apo Ra'zijen në klubin e popullit që t'u tregojnë atyre. Pastaj plaka u ngrit dhe i tha duke u buzëqeshur me një buzëqeshje të kuptimtë: ose eja ti vetë dhe informo popullin.

Valiheja i tha: unë kam një propozim më të mirë. Plaka pyeti: cili është ai? Gruaja e Lutit a.s. tha: kur vijnë mysafirët te Luti, unë do të ndez zjarr që kështu ta kuptojnë banorët e Sodomës se kanë ardhur mysafirët. Plaka u buzëqesh, e përqafoi Valihen dhe e gëzuar i tha: propozim i mrekullueshëm.

I Dërguari i All-llahut, Luti a.s., i këshilloi me vendosmëri banorët e Sodomës dhe ua përkujtoi atyre përfundimin e keq, por ata nuk u tërhoqën nga gjendja në të cilën ishin në veçanti kur kuptuan se gruaja e tij nuk i besoi burrit të saj në atë që ai ftonte, nuk e pasoi atë madje edhe i informonte ata se kush po e pason atë prej banorëve të Sodomës, e Luti a.s. kishte marrë besën prej gruas së tij të mos përhapë asgjë nga sekretet e mysafirëve të tij.

Thanë: o Lut, ne të ndalojmë të pranosh mysafirë të huaj, sepse ne dëshirojmë të bëjmë me ta amoralitet dhe mos na qorto për asnjë njeri me të cilin dëshirojmë të bëjmë amoralitet. O Lut, na lejo neve që të pranojmë mysafir nga burrat.

Kryeneqësia e banorëve të Sodomës ndaj thirrjes së Lutit a.s. mbushte gjoksin e tij me mosshpresë dhe pikëllim ndaj atyre të cilët këmbëngulnin në mosbesimin e tyre, që nuk dëshironin të pastroheshin nga ndytësitë e amoralitetit, sulmimit dhe shkatërrimit.

Valiheja vazhdoi ta shoqërojë popullin e saj në atë që ata vepronin dhe i informonte ata për arritjen e mysafirëve te burri i saj, qofshin ata të rinjë apo burra.

Kur Luti a.s. vërejti tek ata mosbindje ndaj tij, iu lut Zotit të tij që ta ndihmojë kundër atij populli shkatërrimtar, t'u hedhë atyre dënim të dhembshëm dhe kërkoi prej Tij t'i dënojë për kryeneqësinë, mosbesimin dhe amoralitetin e tyre: *"Ai tha: "O Zoti im, më ndihmo kundër popullit të prishur!"* (kaptina El-Ankebutë : 30).

All-llahu i madhërishëm iu përgjigj lutjes së të Dërguarit të tij, prandaj i dërgoi melekët e Tij: Xhibrilin, Mikailin dhe Israfilin, të cilët shkuan te Halilurr-Rrahman (Ibrahimi a.s.) në pamjen e tre djelmoshave dhe ai mendoi se ata janë mysafirë.

Thuhet se: ishin nëntë veta.

Është thënë: ata ishin njëmbëdhjetë melekë në pamje të djelmoshave me fytyra të bukura, të ndritura dhe me bukuri mahnitëse, ata thanë: "paqe", babai i mysafirëve u përgjigj: "paqe".

Ibrahimi a.s. mendoi se ata ishin udhëtarë, prandaj i mirëpriti, ua theri një viç të majmë, e shpejtoi pjekjen e tij me gurë të djegur derisa e skuqi, por ata nuk hëngrën ushqim: *"Ai ndjeu prej tyre njëfarë frike", e ata i thanë: "Mos u frikëso, ne jemi dërguar te populli i Luti."* (kaptina Hudë : 70).

Atëherë babai i peygamberëve u tha: *"E çka është, pra, çështja juaj, o të dërguar?"* Thanë: *"Ne jemi dërguar te një popull i prishur!"* (kaptina El-Hixhr : 57-58).

Pikëllimi i Halilurr-Rrahmanit u rrit. Ai shpresonte vonimin e dënimit, duke shpresuar se banorët e Sodomës do të tërhiqen nga veprimi i mëkateve dhe gabimeve, e kështu të largohen nga ato amoralitete dhe punë të urrejtura. Babai i peygamberëve u frikësua në mos do ta godasë ndonjë e keqe edhe djaln e vëllait të tij, Lutin a.s., e kur melekët vërejtën pikëllimin e Halilurr-Rrahmanit, i thanë: *"Me përjashtim të familjes së Lutit. Ata do t'i shpëtojmë të gjithë. Përpos gruas së tij. Ne kemi vendosur, ajo të mbetet me ata të dënuarit."* (kaptina El-Hixhr : 59-60).

U qetësua shpirti i Ibrahimit a.s. kur kuptoi se familjen e Lutit a.s. nuk do ta prekë kurrfarë e keqe dhe se gruaja e tij, Valiheja, do të jetë me të shkatërruarit. Mirëpo, babai i peygamberëve vazhdoi t'i pyesë ata: a e shkatërroi qytetin në të cilin janë katërqind besimtarë? U përgjigjen melekët: jo. Babai i mysafirëve pyeti: a e shkatërroi qytetin në të cilin janë treqind besimtarë? Thanë: jo. Babai i peygamberëve pyeti: a e shkatërroi qytetin në të cilin ka dyqind besimtarë? U përgjigjën: jo. Halilurr-Rrahmani tha: a e shkatërroi qytetin në të cilin gjenden njëqind besimtarë? U përgjigjën: jo. Ibrahimi a.s. pyeti: a e shkatërroi qytetin në të cilin gjenden dyzet besimtarë? Thanë: jo. Halilurr-Rrahmani tha: a e shkatërroi qytetin në të cilin ka katërmëdhjetë besimtarë? Ibrahimi a.s. i numëronte katërmëdhjetë besimtarë ata që ishin me Lutin a.s. duke numëruar edhe

gruan e tij. Melekët u përgjigjen: jo. Babai i pejgamberëve tha: a e shkatërroni qytetin në të cilin gjenden pesë besimtarë? Thanë: jo. Babai i pejgamberëve tha: a e shkatërroni qytetin në të cilin gjendet një besimtar? Thanë: jo.

Transmetohet prej ithtarëve të Librit se babai i pejgamberëve pyeti: o Zot, a i shkatërron ata, kur në mesin e tyre gjenden pesëdhjetë burra të mirë? All-llahu i madhërishëm tha: nuk i shkatërroj derisa në mesin e tyre gjenden pesëdhjetë njerëz të mirë. Pastaj ai zbriti në dhjetë, e All-llahu i madhërishëm tha: unë nuk i shkatërroj derisa në mesin e tyre gjenden dhjetë njerëz të mirë. Atëherë u qetësua shpirti i Ibrahimit, Halilurr-Rahmanit.

Kur melekët u ndanë nga Halilurr-Rahmani, erdhën në tokën e Sodomës në pamjen e disa djelmoshave të bukur. Ata arritën te lumi i Sodomës në mesditë dhe aty takuan vajzën e Lutit Riten, e cila bartte ujë, i thanë asaj: oj vashëz, a ka ndonjë shtëpi? Rita, vajza e Lutit a.s., tha: po, qëndroni këtu derisa të kthehem. Ajo bartte ujë dhe u frikësua për ta nga populli i saj dhe mendoi se është e dobët që t'i mbrojë ata, ajo iu frikësua popullit të saj, kështu që shkoi te babai i saj, Luti a.s., i cili punonte në një tokë të tij dhe i tha: o babai im, disa djelmosha po të kërkojnë në hyrje të qytetit dhe nuk kam parë fytyra më të bukura se të tyre, nuk kam parë fytyra më të ndritura se fytyrat e tyre, prandaj kam frikë që populli yt të dijë për ta, e t'i poshtërojnë ata.

Luti a.s. u habit, ndërsa populli i tij ia kishin ndaluar të pranojë ndonjë mysafir. Mirëpo ai vazhdoi ta pyesë vajzën e tij, Riten, për ta. Kërkoj t'i flasë më shumë për ta dhe filloi ta pyesë për rrugët më të mira të cilat i ndjek ajo.

Luti a.s. u hamend që të nxitojë në pritjen e tyre. Mendoi t'u kërkojë arsye atyre, kështu të shpëtojë nga shtytja e popullit të tij dhe ta lënë atë dhe çështjen e tij.

Mirëpo, fisnikëria e tij e shtyri atë që t'i zvoglojë të gjitha ato vështirësi, i konsideroi ato pengesa të lehta dhe doli tek ata në fshehtësi, derisa u takua me melekët, të cilët i pritën me gëzim dhe fytyrë të buzëqeshur. Ata kërkuar që t'i pranojë si mysafirë, por Luti a.s. u turpërua prej tyre dhe pastaj si do t'i mbrojë ata?

I thanë: dëshirojmë të na pranosh sonte si mysafirë. Luti a.s. u tha: a nuk keni dëgjuar për punën e këtij populli? Ata pyetën: e çfarë është puna e tyre? I Dërguari i All-llahut, Luti a.s., u tha: dëshmoj All-llahun se ata janë populli më i keq mbi tokë. All-llahu i madhërishëm u kishte thënë melekëve të Tij: popullin e Sodomës mos e shkatërroni, përderisa Luti a.s. të mos dëshmojë kundër tyre katër dëshmi. E kur Luti a.s. e tha këtë thënie, Xhibrili a.s. tha: kjo është një dëshmi.

Filluan ata të bisedojnë ndërmjet vete derisa Luti a.s. e përsëriti dëshminë e tij katër herë. Pastaj hyri me ta në qytet.

Thuhet se Luti a.s. pyeti: ju jeni disa njerëz që nuk u njoh, atëherë çfarë dëshironi? Ata heshtën. Luti a.s. tha: pasha All-llahun, o ju njerëz, nuk njoh mbi fytyrën e tokës banorë të ndonjë qyteti më të prishur se këta. A thua, a e kuptuan ata se ai po kërkon nga ata që të largohen nga ai dhe ta lënë në çështjen e tij? Ata kuptuan nga era e fjalëve të tij se ai po i refuzon ata. Atëherë Xhibrili a.s. tha: kjo është një dëshmi.

Pastaj ecën edhe pak, e ai tha: pasha All-llahun, o ju njerëz, nuk njoh mbi fytyrën e tokës ndonjë qytet më të prishur se këta. Ata (melekët) ishin urdhëruar që të mos e shkatërrojnë popullin e Lutit a.s. derisa ai të mos dëshmojë kundër tyre katër dëshmi.

Luti a.s. filloi prapë të thotë: pasha All-llahun, o ju njerëz, nuk njoh mbi fytyrën e tokës ndonjë qytet më të prishur se këta. Dhe Luti a.s. e përsëriti këtë thënie të tij për së katërti herë. Ata pastaj shkuan në shtëpinë e Lutit a.s..

Valiheja, gruaja e Lutit a.s., e cila bashkëpunonte me popullin sipas metodës së tyre, kur i pa melekët në pamjen më të bukur, në pamjen e disa djelmoshëve me fytyra të bukura, doli te populli i saj dhe i informoi ata për ta dhe u tha: në shtëpinë e Lutit a.s. janë disa burra me fytyra aq të bukura, çfarë nuk kam parë kurrë.

Ata shkuan atje duke u ngutur dhe duke vrapuar: *“E kur të dërguarit tanë i erdhën Lutit, ai u keqësua për ta dhe u ngushtua rëndë me ardhjen e tyre e tha: “Kjo është ditë e vështirë!”* (kaptina Hudë :77). Atë e keqësoi ardhja e tyre, iu ngushtua gjoksi me ardhjen e tyre dhe tha: kjo është një ditë e sherrit të madh. Ai u frikësua që t’u ndodhë ndonjë e keqe prej popullit të tij.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Dhjetë cilësi janë prej veprimeve të popullit të Lutit: lëshimi i flokëve, zgjidhja e pantollonëve, hedhja me gogla (sfera), hedhja e gurëve, të luajturit me pëllumba fluturues, fishkëllima me gishtërinj, krisma me shputa, zgjatja e pantollonëve, shpërthekimi i pullave, konsumimi i alkoolit dhe afrimi meshkujve (homoseksualizmi).”**

Banorët e Sodomës erdhën të gëzuar, kurse Luti a.s. u frikësua kur pa popullin se ishin tubuar duke dëshiruar të bëjnë amoralitet dhe punë të urrejtura, ai i luti ata t’i frikohen All-llahut, i ftoi ata t’i mbulojnë poshtërsitë e tyre dhe të ndalohen nga të këqijat e tyre.

Pastaj u tha atyre: *“O populli im, qe këto bijat e mia (gratë e atij vendi), janë më të pastra për ju, kinie frikë pra All-llahun e mos më turpëroni me mysafirët e mi, a nuk ka ndër ju ndonjë njeri të mençur (e t’ ju ndalojë nga e keqja)?”* (kaptina Hudë : 78).

Thuhet se: ai kishte dy bija, Riten dhe Ra’zijen, kurse banorët e Sodomës i kishin dy udhëheqës të respektuar, e ai dëshiroi t’i martojë dy vajzat e tij me ta dhe kërkoi nga ata që të bëjnë kurorë.

Dhe thuhet se: është fjala për gratë në përgjithësi, sepse peygamberi i një populli është babai i tyre. Poashtu është thënë: ai ua tha këtë që ata të largohen.

Ibn Abbasi r.a. tha: udhëheqësit e tyre kishin kërkuar nga ai që të fejohen me vajzat e tij, e ai kishte refuzuar, e në këtë ditë ai dëshiroi të sakrifikojë vajzat e tij për hirë të mysafirëve.

Por banorët e Sodomës nuk respektuan sinjalizimin e tij dhe nuk dëgjuan thirrjen e tij. Ai i udhëzoi që t'i kaplojnë gratë e tyre të cilat ua ka bërë All-llahu hallall atyre, i urdhëroi që të largohen nga kjo traditë e keqe dhe të ruhen prej përfundimit të keq të këtyre të urrejturave, por ata nuk përfunduan, madje edhe e shtuan vendosmërinë për atë që kishin ardhur kur kishin vendosur të bëjnë amoralitet.

Thanë: o Lut, ti e di që ne nuk kemi kurrfarë të drejte në vajzat tua, ne nuk kemi kurrfarë nevojë, as dëshirë për gra dhe ti e di se çfarë ne po dëshirojmë.

U mbyllën para Lutit a.s. të gjitha dyert e shpresës. Iu ngushtuan rrugët. Atë e mundi populli i tij dhe menduan t'ia thejnë derën. Atë e goditi fatkeqësia dhe vështirësia, të cilat e bënë të kërkojë shpëtim për mysafirët e tij nga populli i tij, e tha: *“Ah, sikur të kisha fuqi kundër jush (t'ju zbraps), ose të kisha mbështetje në ndonjë përkrahje (të fisit) të fortë!”* (kaptina Hudë : 80).

Atëherë ata djelmoshat e bukur i thanë: *“O Lut, ne jemi të dërguarit e Zotit tënd, ata (populli) nuk kanë për t'u afruar te ti...”* (kaptina Hudë : 81).

Melekët u pikëlluan për Lutin a.s. kur tha: *“... ose të kisha mbështetje në ndonjë përkrahje të fortë”*, e i thanë: mbështetja jote është shumë e fortë.

U gëzua Luti a.s. kur i treguan ata se janë melekë, se janë të dërguar të All-llahut dhe se banorët e Sodomës nuk mund të arrijnë tek ata.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“All-llahu e mëshiroftë Lutin, ai vërtet ishte mbështetur në një mbështetje shumë të fortë** (ai nuk kishte farefis, ndonjë forcë penguese apo njerëz të shumtë, por ai u mbështet në All-llahun e fortë).”

Kur Luti a.s. kuptoi se ata ishin të dërguar të All-llahut, e hapi derën e shtëpisë së tij dhe ua mundësoi hyrjen popullit të tij, atëherë Xhibrili a.s. e mori një grusht dhe, të cilin e hodhi në fytyrat e tyre, e All-llahu e futi atë dhe në sytë e atyre që ishin afër dhe të atyre që ishin larg, ua fshiu sytë atyre dhe ata humbën rrugën, nuk ditën të kthehën në shtëpitë e tyre dhe filluan të thonë: shpëtim, shpëtim, se në shtëpinë e Lutit janë disa njerëz të cilët janë magjistarët më të mëdhenj mbi fytyrë të tokës, ata na bënë magji dhe na i verbuan sytë.

Pastaj ata filluan t'i kërcënohen Lutit a.s. dhe i thanë: o Lut, qëndro ti aty derisa të gdhijë, e nesër do të shohim.

Thuhet se: Xhibrili a.s. doli para banorëve të Sodomës dhe i goditi fytyrat e tyre me një pjesë të krahëve të tij, me ç'rast ua verboi sytë, duke mos u

mbetur atyre asnjë gjurmë në sytë e tyre. Atëherë u kthyen në shtëpitë e tyre duke hulumtuar muret, pastaj iu kërcënuan Lutit a.s. dhe i thanë: nesër, ai dhe ne kemi punë.

“Ata deshën t’u afrohen mysafirëve të tij. Ne ua verbëruam sytë atyre, pra përjetoni ndëshkimin Tim dhe qortimet e Mia!” (kaptina El-Kamer : 37).

Pastaj All-llahu i madhërishëm thotë: *“.. e ti kah fundi i natës udhëto me familjen tënde dhe askush prej jush të mos vështrojë mbrapa, pos gruas sate, ajo do të jetë e goditur me çka do të goditen edhe ata. Afati i tyre është mëngjesi...”* (kaptina Hudë : 81).

Në ato momente Luti a.s. u tha: zhdukni ata tani. Xhibrili a.s. i tha: *“Afati i tyre është mëngjesi, a nuk është mëngjesi afër?”*

Kur arriti koha e paraagimit, doli Luti a.s. me dy vajzat e tij, Riten dhe Ra’zijen, dhe e lanë Valihen, kur ata u ndanë nga Sodoma, të papikëlluar për të, u shkoi mbrapa gruaja e tij, Valiheja, por All-llahu ia kishte ndaluar të Dërguarit të tij, Lutit a.s. dhe atyre që ishin me të të shikojnë mbrapa.

Urdhri i All-llahut erdh dhe dënimi i Tij zbriti mbi popullin e Lutit a.s., toka u dridh fort, kurse Xhibrili a.s. i barti fshatrat e popullit të Lutit a.s.: Saja, Sa’re, Gamra, Duma dhe Sodomën, duke i ngritur ato në krahët e tij në mes të qiellit dhe tokës derisa dëgjuan banorët e qiellit të dun’jas lehjen e qenve dhe pastaj i shkatërroi ato duke i goditur njërën me tjetrën dhe bëri që lartësitë e tyre të bëhen ultësira: *“Kur erdhi urdhri ynë, ne përmbysëm të gjitha ato (fshatrat e tyre) duke kthyer çdo gjë nga lart poshtë...”* (kaptina Hudë : 82).

Kur Valiheja dëgjoi krismën, u kthyeu të shikojë dhe tha: ah, për popullin tim! Atëherë, atë e goditi një gur dhe e mbyti. E All-llahu e shpëtoi Lutin a.s. dhe familjen e tij, përveç gruas së tij, Valihes.

Kur ato fshatra u rrotulluan, u zbriti All-llahu atyre gurë të fortë: *“... dhe mbi ta reshëm gurë të fortë pa ia nda.”* (kaptina Hudë : 82).

Sodoma dhe çdo gjë rreth saj u shndërruan në gërmadha të shkatërruara si shkak i mizorisë së tyre: *“Vërtet në këtë ka argument, por shumica e tyre nuk ishin besimtarë.”* (kaptina Esh-Shuara : 8).

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: **“Katër persona gdhijnë në hidhërim të All-llahut të madhërishëm dhe ngrysin në hidhërim të Tij”**. Shokët e tij thanë: kush janë ata, o i Dërguar i All-llahut? I Sinqerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: **“Ata burra të cilët u përngjajnë grave dhe ato gra të cilat u përngjajnë burrave, ai që bënë marrëdhënie me shtazën dhe mashkulli që bënë marrëdhënie me mashkullin (homoseksualizmi).”** (transmetuan Taberani dhe El-Bejhekiu).

Ai s.a.v.s. poashtu tha: **“All-llahu nuk e shikon një njeri i cili bënë marrëdhënie me mashkullin dhe një njeri që bënë marrëdhënie me gruan e tij në anal.”** (transmetoi Ibn Maxhe prej Ebu Hurejres).

Transmetohet se kur mashkulli hip mbi mashkullin, dridhet Arshi (Froni) i All-llahut të Gjithëmëshirshëm nga frika e hidhërimit të All-llahut të

madhërishëm dhe gati qiejt binë mbi tokë, por melekët kapin ato në skajet e tyre dhe lexojnë: *“Thuaj: Ai All-llahu është Një i Vetëm”*. Kështu derisa të qetësohet hidhërimi i All-llahut të madhërishëm.

I Sinqerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: **“Shtatë persona i mallkon All-llahu, nuk i shikon ata në Ditën e Kijametit dhe u thotë: hyni në zjarr me ata që hyjnë; vepruesin dhe të vepruarin me të (homoseksualët), atë që bën marrëdhënie me shtazën, atë që bën marrëdhënie me nënën dhe vajzën e tij dhe masturbuesin me dorën e tij, përveç nëse pendohen.”**

Është transmetuar se nga veprimet e popullit të Lutit ishin: bixhozi, garimi me pëllumba, ngërsyerja e qenve, ngërsyerja e deshëve, ngërsyerja e gjelave, hyrja në banjo pa pantollona dhe mashtrimi në matje dhe peshojë.

Valiheja, gruaja e Lutit a.s., ishte mësim dhe këshillë, të cilën e paraqiti si shembull I Larti dhe I Urti për ata të cilët nuk besuan: *“Atyre që mohuan, All-llahu u sjell shembull gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato të dyja ishin në kurorë të dy robërve të mirë nga robërit tanë, por ato të dyja i tradhtuan (në fe) ata të dy dhe këta të dy nuk mund t’i mbrojnë ato fare tek All-llahu, e atyre dyjave u thuhet: “Hyni të dyjat në zjarr së bashku me ata që hyjnë!”* (kaptina Et-Tahrimë : 10).

UMMU XHEMIL BINTU HARB

Ishte shtëpia e Ebu Lehebit, Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutal-libit, xhaxhait të Muhammed Ibn Abdullahut s.a.v.s. vetëm disa hapa larg Qabes, afër kodrës Safa dhe ai ishte fqinji i Muhammedit s.a.v.s.. Ummu Xhemil bintu Harb ishte motra e Ebu Sufjan Ibn Harbit, zotriu i tregtarëve të Mekkes, e cila quhej El-Avra. Ajo ishte një shembull njerëzor e cila kishte bashkuar në vete urrejtjen, lakminë dhe egoizmin, a thua a lanë këto të meta në gjoksin e saj urrejtje për të gjithë njerëzimin? Çfarë përfiton prapa nxitimit të bartjes së fjalëve në mes të njerëzve dhe shpifjeve? Ajo gjen lumturinë e saj të thellë kur ndizet sherri në mes të njerëzve që ata t’i kthejnë shpinën njëri-tjetrit dhe t’i ndërprejnë lidhjet e tyre pas afërsisë dhe dashurisë?

Ummu Xhemil ishte e preokupuar me atë që i preokuponte shumicën e njerëzve. Njerëzit pritnin dërgimin e pejgamberit, të cilin e përshkruanin ithtarët e Librit; ai është një arab, nga banorët e Qabes të cilën e vizitojnë arabët, nga fisi Kurejsh, largohet nga padrejtësitë, ndalesat, i mban lidhjet farefisnore dhe urdhëron të ruhen ato, ai rrjedh nga prindër fisnikë.

Ëndërrat e Ummu Xhemiles ishin të mëdha, ajo shpresonte që burri i saj Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutalib të jetë pejgamber ose të ketë mbretëri si mbretëria e Kisras. Ajo nxiti në Ebu Lehebin aspiratën për udhëheqës, i zgjeroi atij horizontet për mbisundim dhe pastaj e bëri që të lakmojë në profetësi.

Pse Abdul-Uzzaja të mos jetë vula e pejgamberëve? Ai është aristokrat dhe i biri i zotriut të respektuar të Kurejshitëve Abdul-Mutalib Ibn Hashimit. Ai është poashtu nga banorët e Qabes, të cilën e vizitojnë arabët dhe është Kureshit. Por, Ebu Lehebi është një pijanec, i cili luan edhe bixhoz, sikur ta linte konsumimin e alkoolit dhe bixhozin. Megjithëkëtë, a mund të varroset në dheun e harresës vjedhja e tij e dy drenushave të arta? Si të harrojnë njerëzit se kur Abdul-Mutalibi plaku i Benu Hashimëve hapi pusin e Zemzemit, gjeti aty shpata, mburoja dhe dy drenusha të arta, të cilat i kishin fshehur fisi Xhurhum. Abdul-Mutalibi i vjerri ato dy drenusha në Qabe. Një ditë iu harxhua vera Ebu Lehebit dhe disa shokëve të tij, ata kuptuan se një karvan është duke ardhur prej Shamit dhe me vete kanë verë. Ata u morën vesh që ta vjedhin njërin nga dy drenushat, të cilat ishin të vjerra në Qabe dhe me të të blejnë verë. Derisa Abdullah Ibn Xhed'ani dhe disa burra të fisit Kurejsh ishin duke bërë tavaf rreth Qabes, nuk e panë njërin drenushë, atëherë shkuan me të shpejtë te plaku i Benu Hashimëve dhe e informuan për atë që kishin parë. Paria e Kurejshëve e kuptuan atë që kishte ndodhur me Ebu Lehebin dhe shokët e tij, kështu që disa nga ata i zunë, kurse disa të tjerë ikën. Në mesin e atyre që ikën ishte edhe Ebu Lehebi, ai kishte ikur te dajat e tij të fisit Huza'a, të cilët e mbrojtën atë. Për këtë arsye Ebu Lehebi shquhej si: vjedhësi i drenushës së Qabes.

Kur drenusha e artë u rikthye në Qabe, zotriu i Kurejshëve e ndërtoi me to prej ari derën e Qabes, pra Abdul-Mutalibi është i pari i cili e bëri derën e Qabes prej ari. Por, a do ta harrojnë njerëzit ndodhinë e drenushës?

Nëse profetësia e huçi Ebu Lehebin nuk do ta huçë Ebu Sufjan Ibn Harbin, atij vërtet i takon kjo profetësi, ai është zotriu i tregtarëve të Mekkës, ai është fisnik, ka pasuri dhe është i rritur, çfarë i mungon atij që të jetë pejgamberi i këtij ummeti? Por zotriu i Mekkës dhe zotriu i Benu Ummejëve nuk është i interesuar me këto profetësi, të cilat i kanë preokupuar mendjet e atyre që pritnin atë shfaqje. Atij i interesonte fitimi i tregtisë së tij. Sikur t'i kushtonte pak interesim asaj (profetësisë) dhe të largohej pak nga lakmia, amoraliteti dhe paturpësia e tij? Poashtu Ebu Sufjani nuk ishte prej atyre që largohen nga padrejtësitë dhe ndalesat.

Një ditë Ebu Lehebi shkoi te Zejd Ibn Amr Ibn Nufejli, i cili ishte thelluar në librat e ithtarëve të Librit (hebrenj e të krishterë) dhe kishte pasuar fenë e Ibrahimit a.s., e i tha: jam informuar se ti po pretendon se është afruar koha e shfaqjes së një pejgamberi, prandaj më trego ç'është pejgamberi? Zejd Ibn Nufeli i tha: është ai që merr lajme prej All-llahut të madhërishtëm. Atëherë, Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutalibi pyeti: e çdo të thotë merr lajme prej All-llahut? Zejd Ibn Amr Ibn Nufejli u përgjigj: e dërgon një njeri të veçantë, të cilit i dërgon Xhibrilin a.s. dhe ai e sheh atë me sytë e tij.

Ebu Lehebi e lëshoi mexhlisin e Zejd Ibn Amr Ibn Nufejlit duke vendosur të veshë petkun e profetësisë, ashtu si veshin murgjërit palltot e tyre. Kur ai

u kthye në shtëpi, gruaja e tij, Ummu Xhemilja, e informoi se dy djemtë e tij, Utbe dhe Utejbë, po dëshirojnë të fejojnë Rukijen dhe Ummu Kulthumin, dy vajzat e Muhammedit (s.a.v.s.). Ebu Lehebi shkoi te djali i vëllait të tij dhe ai e priti xhaxhain e tij me mikpritje të nxehtë.

Pak më vonë u përhap në Ummul-Kura (Mekke) se Muhammedi s.a.v.s. po supozon se është peygamberi i këtij ummeti dhe se All-llahu e dërgoi atë përgëzues dhe qortues.

U rrit urrejtja e Ummu Xhemiles pas kësaj; a nuk gjeti Zoti i Muhammedit përveç këtij jetimi të Kurejshëve? Ai nuk është Muhammed (i lavdëruar), por ai është mudhemmem (i neveritur). Nëse shpallja e huçi burrin e saj Ebu Lehebin, si ka mundësi ta huqë vëllain e saj, Ebu Sufjan Ibn Harbin? Udhëheqja e Kurejshëve është qëllim i tij, madje ky është i gjithë shpresimi i tij, epiqendra e mendimit të tij, burimi i veprimit të tij, i mbisunduar në të gjitha sjelljet dhe lidhjet e tij me njerëzit, ai udhëtoi në Persi dhe hyri te Kisraja, bëri marrëveshje me mbretërit e Hires, çështja e tij u lartësua dhe nuk gjet në fisin Kurejsh asnjë që mund të garante me të për udhëheqje, ai ëndërronte që udhëheqësia të kalonte në shtëpinë emevite nga ajo hashimite.

Nëse Muhammedi s.a.v.s. filloi të ftojë në fe të re dhe thotë se: ai është peygamber, të cilit po i vijnë shpalljet nga qielli, atëherë patjetër Ummu Xhemilja, burri i saj Ebu Lehebi dhe vëllai i saj, Ebu Sufjan Ibn Harbi, do t'i dalin përballë thirrjes së tij dhe do ta luftojnë atë me forcë, sepse fisnikërinë e profetësisë nuk mund ta arrijë kurrfarë fisnikërie, e sikur kjo thirrje të mbetet në tokë, asnjë shtëpi nuk mund të arrijë atë fisnikëri të cilën do ta arrijë shtëpia hashimite, sado që të jetë ajo e lartë.

Ummu Xhemilja e gjeti veten e saj duke thënë mes dhëmbëve: pasha Latin e Uzan dhe të gjithë zotat që i adhuruan arabët, nuk do t'i besoj Muhammedit kurrë dhe nuk do ta vërtetoj atë.

Ajo e dinte se Muhammedi s.a.v.s. është i sinqertë, ai nuk rrenë, por ai erdh me një çështje, e cila nuk la pas vete asnjë lavdatë.

Ebu Lehebi iu afrua gruas së tij dhe e pyeti: a të ka arritur lajmi për Muhammedin? Ummu Xhemilja, kinse duke mos i vurë vesh, tha: po, dhe unë jam betuar se nuk do t'i besoj atij.

Atëherë Ebu Lehebi i tha: kurse unë do ta kundërshtoj thirrjen e tij, do t'i nxis parinë e popullit të tij dhe mendjelehtët e tyre kundër djalit të vëllait tim, i cili po dëshiron të grabisë udhëheqësinë dhe fisnikërinë.

Një mëngjes Muhammedi s.a.v.s. u ngjit në kodrën Safa dhe thirri: sulmi, o ju njerëz (sikur armiku dëshiron të sulmojë). Ummu Xhemilja dhe burri i saj Abdul-Uzza u zgjuan nga zëri i Ebul-Kasimit s.a.v.s., i tha ajo Ebu Lehebit: kush është pronari i këtij zëri, i cili po i fton njerëzit në këtë mëngjes dhe çfarë po dëshiron? Ebu Lehebi mendohej t'i hapë kapakët e syve të tij nga therrat e gjumit, sepse ai kishte kaluar natën i zgjuar me shokët e tij duke luajtur bixhoz dhe duke pirë verë derisa zbardhi drita.

I tha Ebu Lehebi gruas së tij: sa grua e keqe që je, çka po më intereson mua se kush po bërtet në këtë orë të mëngjesit. Por zëri i të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. depërtoi tek ata dy: **“O grumbull kureshit, sikur t’u them se poshtë atij mali janë disa kalorës të cilët dëshirojnë t’ju sulmojnë, a do të më besoni?”** Ebu Lehebi e njeh këtë zë, ai nuk është i huaj për veshin e tij, u mrrol dhe u mundua ta koncentrojë mendjen e tij, të cilën e turbullonte ende alkooli. Njerëzit thonin: ne nuk të kemi gjetur gënjeshtar kurrë, pastaj Ebu Lehebi bërtiti: ky djali i vëllait tim, Muhammedi, çfarë po dëshiron? Me siguri po na fton ai në ndonjë çështje.

Ummu Xhemilja tha: ndoshta ka në të diçka që nuk mund të arrijmë prapa kësaj. U lëshua Abdul-Uzzaja te kodra e Safas dhe në atë moment i arriti zëri i Muhammedit s.a.v.s. duke thënë: **“O fisi Beni Ka’b Ibn Luij, shpëtojeni veten tuaj nga Zjarri, o fisi Benu Murre, shpëtojeni veten tuaj nga Zjarri, o fisi Benu Hashim, shpëtojeni vetën tuaj nga Zjarri, o fisi Benu Abdush-Shems, shpëtojeni veten tuaj nga Zjarri, oj Fatimja, e bija e Muhammedit, shpëtoje veten tënde nga Zjarri, oj Safija e bija e Abdul-Mutalibit, halla e Muhammedit, shpëtoje veten tënde nga Zjarri, sepse unë nuk posedoj për ju para All-llahut asgjë, nuk posedoj për ju kurrfarë pjese nga kjo botë e as nga bota tjetër përveç nëse thuani: La ilahe il-llah (mos vazhdoni në mosbesimin tuaj, duke u mbështetur në afërsinë time me ju)!”**

Ebu Lehebi ndjeu mosshpresë, a për këtë i ka tubuar Muhammedi s.a.v.s.? Ata menduan se Muhammedi s.a.v.s. i ka tubuar për ndonjë pasuri që do ta fitojnë, kurse ai erdhi që t’i ftojë në një çështje, e cila përmban premtim dhe kërcënim? Atëherë vloi gjoksi i Ebu Lehebit nga urrejtja dhe bërtiti me ngushtësi: qofshë i mallkuar tërë ditën e mbetur, a për këtë na ke tubuar?

Pastaj ai sinjalizoi me dorën e tij: shpërndahuni, o ju njerëz. Kështu që njerëzit u shpërndanë.

U kthye Ebu Lehebi në shtëpinë e tij dhe e gjeti gruan e tij duke e pritur, e cila e pyeti: me çka u ktheve o Ebu Utbe (babai i Utbes)? Tha Ebu Lehebi: me çka të kthehem nga i biri i vëllait tim, i cili na fton që ta pasojmë atë? Ummu Xhemilja duke u habitur i tha: po u fton që ta pasoni? Kur do të jemi ne pasuesit e tij? A mos po dëshiron ai që ne të jemi si robërit të cilët e kanë pasuar: Bilali, Hababi dhe Suhejb Err-Rrumiji? E pamundur është të ecim në karvanin e nënshtrimit dhe poshtërimit.

Ebu Lehebi i tha: na duhet ta luftojmë atë me fanatizëm dhe urrejtje. Ummu Xhemilja ia ktheu: do të tuboj therra dhe do t’i vendos para shtëpisë së tij, që kur ai të dalë...

Ebu Lehebi tha: do t’u them njerëzve se djali i vëllait tim është gënjeshtar, përse Zoti i tij zgjodhi një njeri si Muhammedin dhe nuk më dërgoi mua pejgamber, a nuk jam unë nga paria e Kurejshëve?

Ummu Xhemilja tha: nuk i kam besuar, as nuk do t’i besoj se Zoti i tij e dërgoi te ne. A mos All-llahu i foli ndonjë njeriu? Abdul-Uzza Ibn Abdul-

Mutalibi tha: djali i vëllait tim po dëshiron që të jetë më i larti në tokë. Ummu Xhemilja tha: pasha Latin dhe Uzzan, nuk do të ndodhë kjo përderisa do të shkel mbi këtë tokë.

Ummu Xhemilja lëshoi flakë për gojën e saj, ajo bartte për Ebul-Kasimin urrejtje të fshehur në zemrën e saj para shumë viteve pa ditur ndonjë arsye. A thua, çfarë do të jetë gjendja e saj kur ajo të kuptojë se Muhammedi s.a.v.s. do ta godasë zullumqarin në dorën e tij dhe do t'i ndihmojë atij që i është bërë mizori, do ta kapë për dore të dobtin, do të ngre shtyllën e të vërtetës dhe të drejtësisë, do të përhapë flamurin e përmirësimit në një shoqëri në të cilën mbisundon mizoria, devijimi e fesadi dhe se do të zhbijë sundimin e parisë kurejshite? Si do të realizohet kjo kur vetëm sinjalizimet e tyre ishin urdhër, kurse fjalët e tyre ishin ligj? Ai i ftonte njerëzit fshehtë, e pasuan disa robër dhe disa fisnikë si Ebu Bekr Ibn Kuhafe, Zubejr Ibnul-Avvami, Sa'd Ibn Ebi Vekkasi dhe Othman Ibn Affani.

Kur Muhammedi s.a.v.s. filloi të thërrasë haptazi, Ummu Xhemilja i tha burrit të saj: o Ebu Utbe, a do ta lëshë djalin e vëllait tënd që të veçohet prej teje me udhëheqësi dhe respekt, tani ai ka filluar t'i ftojë njerëzit haptazi në fenë e tij të re, derisa i ftonte më herët në fshehtësi?

Atëherë Abdul-Uzzaja shkoi te Muhammedi s.a.v.s. dhe i tha: çfarë do të kem unë nëse të besoj ty? Ebul-Kasimi s.a.v.s. i tha: atë që kanë edhe muslimanët e tjerë. Ebu Lehebi pyeti: a nuk kam unë vleftë mbi ta? I Singerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: e çfarë po dëshiron ti? Ebu Lehebi lëvizi dorën e tij dhe tha duke fryer në dorën e tij: e mallkuar qoftë kjo fe, kur unë dhe këta (kishte për qëllim muslimanët e dobët si Bilal Ibn Rebahin, Abdullah Ibn Mes'udin, Suhejb Ibn Sinanin err-Rrumiun, Habab Ibnul-Eretin dhe Ammar Ibn Jasirin) të jemi të barabartë?

Atëherë All-llahu i madhërishëm zbriti kaptinën El-Mesed: *“Qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi, e ai më është shkatërruar! Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo çka fitoi! Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë. E edhe gruaja e tij, ajo që barti dru (ferra). E në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur.”* (kaptina El-Mesed).

Abdullah Ibn Abbasi r.a. tha: kur All-llahu i madhërishëm e krijoi lapsin i tha: shkruaje atë që do të jetë. E nga ajo që ai kishte shkruar ishte edhe *“qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi, e ai është shkatërruar.”*

Është pyetur Hasen El-Basriu për fjalën e All-llahut *“qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi, e ai është shkatërruar”*, a ka qenë kjo e shkruar në Ummul-Kitab (në pllakën e ruajtur)? Dhe a ka pasur mundësi Ebu Lehebi të shmanget nga Zjarri? Hasen El-Basriu u përgjigj: pasha All-llahun, ai nuk ka pasur mundësi përveçse të hyjë në të dhe kjo është shkruar në Ummul-Kitab para se të krijohet Ebu Lehebi dhe babai i tij.

Ummu Xhemilja nuk u ndal edhe më tutje duke vendosur drunj dhe therra para shtëpisë së të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. dhe në rrugën e tij.

Në Mekke u përhap lajmi i kaptinës El-Mesed. Kur Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutalibi dëgjoi për të, u çmend, vloi hidhërimi i tij dhe pyeti: djali i vëllait tim po më përgëzon mua me dënim të Zjarrit? Pastaj duke u përqeshur qeshi dhe vazhdoi: a mendon ai se ne i besojmë për atë që thotë për Xhennetin dhe Zjarrin? Ne nuk besojmë se ka ringjallje, sepse është vetëm kjo jeta jonë në këtë botë, vdesim dhe jetojmë, e nuk na zhduk përveçse koha.

Ummu Xhemilja tha: a Muhammedi po supozon se fisnikja e kurejshëve do të bartë drunj dhe se një litar nga zjarri do të më mbështillet në qafën time? Mjer për ty prej meje, o i neveritur. Pastaj ajo u lëshua kah Qabja e mbushur me hidhërim dhe mllef, kur ajo e pa Ebul-Kasimin, e mori një gur dhe u drejtua nga ai. Kur pothuajse u afrua afër, Ebu Bekri r.a. i tha të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s.: o i Dërguar i All-llahut, ja ku është Ummu Xhemil bintu Harb duke ardhur kah ne, ajo është një grua me gjuhë të papastër, sikur të largohesh nga këtu, sepse pasha All-llahun ajo do të fyejë. I Singerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: **“Ajo nuk do të më shohë.”** Atëherë ajo u afrua dhe tha: o Ebu Bekr, shoku yt më ka fyer. Ebu Bekr Ibn Kuhafe i tha: pasha Zotin e Qabës, ai nuk të ka fyer.

Me këtë betim Ebu Bekri ishte i singertë, sepse në realitet All-llahu i madhërishëm mbi qiellin e shtatë e ka fyer atë dhe burrin e saj në Kur'an dhe i përgëzoi me zjarr të Xhehennemit, prandaj nuk e kishte fyer Ebul-Kasimi s.a.v.s..

Atëherë, Ummu Xhemilja tha: ai thuri kundër meje poezi. Ebu Bekri r.a. u përgjigj: pasha All-llahun, shoku im nuk është poet dhe nuk e di se ç'është poezia. Ajo i tha: pasha yjet ndriçues, ai është poet, e edhe unë jam poete, prandaj do ta fyej:

*Muhammedin e kemi urrejtur
Fenë e tij e kemi refuzuar
Dhe urdhërin e tij e kemi kundërshtuar.*

Pas kësaj Ummu Xhemilja u kthye në shtëpinë e vëllait të saj Sufjan Ibn Harbit. Ebu Bekri r.a. tha: o i Dërguar i All-llahut, ajo bartte një gur dhe të dëshironte ty. I Singerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: **“All-llahu vendosi në mes meje dhe saj pengesë, ndërhyri në mes meje dhe saj Xhibrili a.s..”** Ummu Xhemilja shkoi te vëllai i saj Ebu Sufjani plot hidhërim dhe ai e pyeti: ç'është me ty, oj motra ime? Ajo i tha: mjer për ty, o trim, a nuk hidhërohesh që Muhammedi më ka fyer? Ebu Sufjan Ibn Harbi i tha: unë do ta heq qafe ty atë. Pastaj e mori shpatën dhe doli..Ummu Xhemilja i fshiu duart e saj nga gëzimi dhe tha: përfundoi Muhammedi dhe çështja e tij. Nuk shkoi shumë dhe Ebu Sufjani u kthye. Ajo e pyeti: a e vrave? U ul Ebu Sufjani duke dihat, pastaj tha: oj motra ime, a kishe dëshiruar që koka e vëllait tënd të ishte në gojën e një gjarpri?!

Ummu Xhemil bintu Harb tha: jo, pasha All-llahun! Atëherë Ebu Sufjani, duke fshirë djersen nga balli i tij, tha: e pra, kjo gati sa ndodhi tani (ai e pa një gjarpër që sikur t'i afrohej Ebul-Kasimit s.a.v.s. do t'ia gëlltite kokën e tij, prandaj e kishte kapluar frika).

Ummu Xhemilja u kthye në shtëpinë e saj duke i vluar gjoksi i saj nga urrejtja, hidhërimi dhe pikëllimi, aty gjeti burrin e saj, Ebu Lehebin, të cilit i tha: çfarë po dëshiron Muhammedi? Ebu Lehebi i tha: me siguri ai po dëshiron pasuri dhe pozitë. Ummu Xhemilja i tha: përse nuk i armiqësojmë Kurejshët kundër të urrejturit? Përse nuk i shpallim atij luftë të egër, e cila nuk do të lërë asgjë? Ebu Lehebi u përgjigj: më ka ndritur mua në mendje një ide, e cila do të rëndojë shpinën e Muhammedit me pikëllim, frikë dhe preokupim. Ajo me përkushtim i tha: ma trego atë.

Atëherë Ebu Lehebi e ftoi djalin e tij, Utben dhe i tha: koka ime është haram për kokën tënde nëse nuk e lëshon vajzën e Muhammedit (Rukijen). Utbeja e lëshoi atë menjëherë dhe ende nuk kishte hyrë me të. Pastaj Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutalibi i tha djalit të tij, Utejbës: koka ime është haram për kokën tënde nëse nuk e lëshon vajzën e Muhammedit (Ummu Kulthumin), të cilën ai e kishte martuar, por ende nuk kishte hyrë me të. Utejbe i hidhëruar tha: do ta lëshoj atë dhe do të shkoj te babai i saj dhe do t'ia fyej Zotin e tij.

Shkoi Utejbe Ibn Abdul-Uzzaja ta kërkoj të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s. dhe e kuptoi se ai është te xhaxhai i tij, Ebu Talibi. Kur e pa atë e shajti Zotin e tij dhe e pështyu në fytyrë, por pështyma e tij nuk e goditi fytyrën e Ebul-Kasimit s.a.v.s., pastaj i tha: o Muhammed, unë nuk besoj në Zotin tënd dhe jam armik i fesë tënde.

Atëherë peygamberi i mëshirës s.a.v.s. tha duke u lutur: **“O All-llah, dërgoja atij një qen prej qenve Tu** (ndonjë egërsirë që ta shqyejë).” Ebu Talibi, i befasuar plotësisht prej lutjes së të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. kundër djalit të vëllait të tij, Utejbës, tha: do të kishte mjaftuar, o djali i vëllait tim, nga kjo lutje.

Kur Ebu Lehebi kuptoi se Muhammedi s.a.v.s. u lut kundër birit të tij Utejbës, e kaploi zemrën e tij frika dhe rrëqethja, sepse ai e dinte që Ebul-Kasimit s.a.v.s. i pranohet lutja.

Një paradite Ummu Xhemilja shkoi në shtëpinë e vëllait të saj, Ebu Sufjanit dhe aty e gjeti burrin e saj, Ebu Lehebin, duke pirë me të verë, të cilëve u tha: Muhammedi ka dalë në Dhul-Mexhaz, aty ku tubohen njerëzit dhe ka filluar t'i ftojë në adhurimin e Zotit të tij.

Vëllai i saj, Ebu Sufjani, pyeti: si e kuptove këtë, oj motra ime? Ajo tha: e kuptova nga një grua, e cila e kishte parë atë bashkë me disa pasues të tij.

Ebu Sufjan Ibn Harbi tha: pak më herët e pashë duke shkuar dhe me të ishin Ebu Bekri, Ali Ibn Ebu Talibi dhe xhaxhai i tij, Hamz Ibn Abdul-Mutalibi.

Ebu Lehebi, duke u ngritur prej vendit të tij, tha: pasha Latin dhe Uzzan, nuk do ta lë atë të vetmohet me njerëzit, do të ndërhyj në mes të tij dhe atyre dhe do ta shpall para të gjithëve se ai është gënjeshtar.

Posa arriti Ebu Lehebi në Dhul-Mexhaz, e gjeti djalin e vëllait të tij s.a.v.s. të cilin e kishin rrethuar njerëzit, të cilët e dëgjonin me vëmendje dhe ai u thoshte: **“O njerëz, thuani La ilahe il-Allah që të shpëtoni.”**

Ebu Lehebi e hodhi me gurë dhe njerëzit filluan të shikojnë kah ai, e u tha: o njerëz, mos i besoni se ai është gënjeshtar. Disa nga ata filluan të pyesin: kush është ky që po e gjuan me gurë dhe po e quan gënjeshtar? Disa të tjerë thanë: ky është xhaxhai i tij, Abdul-uzza Ibn Abdul-Mutalibi. Atëherë, njerëzit u larguan duke thënë: familja e tij e njohin atë më mirë.

Kur Ebu Lehebi pa se njerëzit u shpërndan prej Ebul-Kasimit s.a.v.s., buzëqeshi me një buzëqeshje tradhtare dhe u kthye në shtëpinë e tij, i kënaqur dhe i gëzuar.

Uthman Ibn Affani r.a. u martua me Rukijen, të bijen e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. dhe emigroi bashkë me të në Etiopi.

Një ditë Ebu Lehebi me djalin e tij, Utejbën dhe disa burra të fisit Kurejsh dolën me një karvan për në Sham (Siri) dhe rrugës u ndalën në një vend, aty i pa një prift nga faltorja e tij dhe u tha: vërtet kjo tokë është e mbushur me egërsira. Në atë moment Ebu Lehebit iu kujtua lutja e Muhammedit s.a.v.s. kundër djalit të tij, kështu që i plasi frika në brendësinë e tij dhe u tha atyre që ishin me të: ju vërtet e dini prejardhjen dhe të drejtën time. Ata i thanë: po, o Ebu Leheb. Atëherë Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutalibi tha: o grumbulli Kurejshit, na ndihmoni këtë natë, sepse unë i frikohem lutjes së Muhammedit kundër djalit tim, Utejbës. Ata pyetën: çfarë duhet të veprojmë, o babai i Utejbës? Ebu Lehebi tha: tuboni plaçkat tuaja në këtë faltore, pastaj shtrone vendin e djalit tim dhe pastaj ju grumbullohuni rreth tij.

Njerëzit i tubuan plaçkat e tyre në faltore dhe e bënë një rreth në mes të të cilit e vendosën Utejb Ibn Ebu Lehebin. Kur errësira mbuloi çdo gjë, atyre iu afrua një luan, zemrat e tyre arritën fytin nga frika kur luani filloi të nuhasë fytyrat e tyre. Pastaj ai iu drejtua mesit të atij rrethit sikur kërkonte një njeri të veçantë, kur ai iu afrua Utejbe Ibn Ebu Lehebit, kërceu mbi të dhe pastaj e rrëmbeu atë. Ai duke nxjerrë frymën e tij të fundit tha: kjo është lutja e Muhammedit, a nuk u kam thënë se Muhammedi është njeriu me fjalët më të vërteta? (transmetoi Ebu Neimi).

Vdiq Utejbe Ibn Ebu Lehebi dhe kështu u ndez edhe më tepër zjarri i urrejtjes në gjoksin e Ebu Lehebit dhe të gruas së tij kundër Islamit dhe pejgamberit të tij.

Kur Kurejshët u obliguan embargo të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., Beni Abdul-Mutalibëve dhe Beni Hashimëve në luginën e Ebu Talibit, Ebu Lehebi dhe gruaja e tij iu bashkuan Kurejshëve dhe një ditë Abdul-Uzzaja

takoi Hindin, të bijen e Utbes, gruan e Ebu Sufjanit, të cilës i tha: si e sheh ndihmën time ndaj Latit dhe Uzzas? Ajo i tha: je i shkëlqyeshëm.

Emigrantët e Etiopisë u kthyen kur dëgjuan se Omer Ibnul-Hattabi kishte pranuar Islamin, Ebul-Hakem Ibn Hishamin (Ebu Xhehli) e kaploi një hidhërim i madh kur dëgjoi se Ebu Seleme (Abdullah Ibn Abdul-Esed El-Mahzumi) kishte pranuar poashtu Islamin. A mund të pranojë Ebul-Hakem Ibn Hishami që trazira të hyjë në shtëpitë e Benu Mahzumëve? A nuk mjafton që El-Erkam Ibnul-Erkam El-Mahzumi kishte pranuar Islamin dhe e kishte bërë shtëpinë e tij shtëpi të Islamit, ku takoheshin Muhammedi s.a.v.s. dhe shokët e tij? Ebul-Hakem Ibn Hishami sa herë që dëgjonte se një njeri e pasonte Muhammed Ibn Abdullahun s.a.v.s., i shtoej vrazhdësia dhe mosbesimi. Ai lufton që të ngulfatë çdo zë, i cili dëshiron të marrë fisnikërinë, pushtetin dhe krenarinë. Paria kurejshite urrenin thirrjen e Muhammedit s.a.v.s., ata e dinin me saktësi se shfaqja e tij është fshehja e tyre, në ngritjen e tij është ulja e tyre dhe triumfi i tij është zhdukje e pushtetit të tyre dhe humbje e udhëheqësisë nga duart e tyre, sepse ajo me të cilën ka ardhur Muhammed Ibn Abdullahu s.a.v.s. dridh tokën nën këmbët e tyre, si ka mundësi ajo fe e re të barazojë robin me zotriun e tij? Si ka mundësi që Ebu Seleme El-Mahzumi të vërtetojë shpalljen e një jetimi kureshit? Amr Ibn Hishami shpejtoi në shtëpinë e Ebu Selemes, por nuk e gjeti aty. Kur ai kuptoi se ai kishte ikur te daja i tij Ebu Talib Ibn Abdul-Mutalibi, Ebul-Hakemi shkoi tek ai me të shpejtë me një grup nga fisi Benu Mahzum dhe i thanë: o Ebu Talib, e ke mbrojtur prej nesh djalin e vëllait tënd (Muhammedin s.a.v.s.), e çfarë ke që po e mbron prej nesh shokun tonë (d.m.th. Ebu Selemen)? Ebu Talibi u tha: ai kërkoi strehim tek unë dhe ai është djali i motrës sime, nëse unë nuk e mbroj djalin e motrës sime, nuk do ta mbroj as djalin e vëllait tim.

Ebu Lehebi ishte aty ulur dhe i hidhëruar tha: o grumbulli kureshit, pasha All-llahun, e keni shpeshtuar ndaj meje këtë çështje, ju vazhdoni të ngriteni kundër tij për strehimin që i bënë popullit të tij, pasha All-llahun ose do të largoheni nga ai, ose edhe ne do të rreshtohemi me të në çdo qëndrim të cilin ai e dëshiron.

Ebul-Hakemi u frikësua që edhe Ebu Lehebi do t'u dalë nga dora, ose do ta kaplojë atë fanatizmi për fis, e kështu do t'i bashkëngjitet djalit të vëllait të tij dhe kështu do të përforcohet thirrja e tij, prandaj tha: ne menjëherë do të largohemi nga ajo që e urren, o Ebu Utbe.

Atëherë njerëzit u shpërndanë, kurse Amr Ibn Hishami u largua duke ndjerë poshtërim.

Më vonë vdiq Ebu Talibi, pastaj vdiq edhe Hatixhja, kështu që u shtua armiqësia e kurejshitëve kundër të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s., kurse Ummu Xhemilja u gëzua pa masë dhe tha: vdiq ai që e ndihmonte dhe vdiq ajo që e përforconte në përhapjen e thirrjes së tij.

Mbet i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. pa ndihmës dhe pa përkrahës (përveç All-llahut), kështu që Kurejshët filluan ta dëmtojnë Ebul-Kasimin s.a.v.s. ashtu si nuk kishin mundësi ta bënë në kohën e xhaxhait të tij Ebu Talibit, derisa një ditë, një mendjelehtë i kureshitëve i hodhi dhe në kokën e tij dhe ai hyri me atë dhe në shtëpinë e tij, kurse bija e tij, Fatimja r.a. filloi t'ia pastrojë fytyrën dhe duart e tij me ujë, ndërsa Muhammedi s.a.v.s. tha: oj bija ime, mos iu friko tradhtisë, e as poshtërimit të babait tënd, sepse All-llahu do ta mbrojë babain tënd.

Pastaj vula e të gjithë pejgamberëve s.a.v.s. e uli kokën e tij dhe tha: nuk më kanë bërë Kurejshët diç që kam urrejtur derisa nuk vdiq Ebu Talibi.

Ebul-Kasimi s.a.v.s. u mbyll në shtëpinë e tij dhe dilte jashtë rrallëherë, e cila gjë arriti në veshët e Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutalibit, prandaj ai erdh dhe i tha: o Muhammed, vazhdo në atë që dëshiron dhe atë që veproje kur Ebu Talibi ishte gjallë, bëje edhe tani, sepse pasha Latin dhe Uzan, nuk do të të ndodhë ty asgjë derisa unë të vdes.

Një ditë Ibnul-Gajta e shau të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s., të cilin Ebu Lehebi e qortoi ashpër, e ai iku duke bërë titur: o grumbulli kureshit, Ebu Utbe ka ndërruar fenë e tij (është bërë mysliman). Atëherë paria kureshite shpejtuan të shtëpia e Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutalibit, u ndalën te dera e tij dhe thanë: a është e vërtetë ajo që kemi dëgjuar, o Ebu Utbe? Ai pyeti: e çfarë keni dëgjuar? Thanë: ti ke ndërruar fenë dhe ke pasuar djalin e vëllait tënd! Ebu Lehebi u përgjigj: kush e tha këtë? I thanë: njerëzit po e thonë këtë. Atëherë Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutalibi tha: a mos është e metë e bartjes së lajmeve përveçse transmetimi i tyre. I thanë: a nuk e ke ndryshuar fenë? Tha Ebu Lehebi: nuk e kam lënë fenë e Abdul-Mutalibit, por unë e mbroj djalin e vëllait tim që t'i bëhet padrejtësi dhe të vazhdojë në atë që dëshiron.

Atëherë paria kureshite, duke u përqeshur, tha: je i mirë, je i shkëlqyeshëm dhe ke mbajtur lidhjen farefisnore.

Paria kureshite nuk dëshironte ta kundërshtonin Ebu Lehebin që kështu ai të mos këmbëngulte në ndihmesën dhe mbrojtjen e djalit të vëllait të tij s.a.v.s., ata e dinin se ai është pijanec dhe se është mendjelehtë, mund të tërhiqet prej tyre dhe mund ta kaplojë fanatizmi e t'i bashkëngjitet Ebul-Kasimit s.a.v.s. dhe kështu të përforcohet thirrja e tij.

Me një rast erdhën Ebu Xhehl Ibn Hishami dhe Ukbetu Ibn Muiti te Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutalibi, të cilët i thanë: o Ebu Utbe, a të ka informuar djali i vëllait tënd se ku do të hyjë Abdul-Mutalibi? Ebu Lehebi tha: jo. Ebu Xhehli dhe Ukbeja i thanë: shko dhe pyete. Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutalibi shkoi me të shpejtë te djali i vëllait të tij s.a.v.s. dhe e pyeti: o Muhammed, ku do të hyjë Abdul-Mutalibi? I Singerti dhe i Vërtetuari s.a.v.s. tha: **“Do të hyjë me popullin e tij.”**

Ebu Utbeja u kthye te Ebu Xhehli dhe Ukbe Ibn Muiti, të cilëve u tha: e pyeta dhe më tha se do të hyjë me popullin e tij. Atëherë ata i thanë: ai

mendon se do të hyjë në Zjarr. Ai edhe një herë u kthye te i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. dhe e pyeti: o Muhammed, a do të hyjë Abdul-Mutalibi në Zjarr? Pejgamberi i mëshirës s.a.v.s. u përgjigj: **“Edhe të gjithë ata që vdesin në atë që vdiq Abdul-Mutalibi, do të hyjnë në Zjarr.”**

Me këtë rast Ebu Lehebi i kërceu hidhërimi, urrejtja e budallallëku dhe tha: do të jem armik yti gjithmonë, përderisa ti mendon se Abdul-Mutalibi është në Zjarr.

Kështu Ebu Lehebi, gruaja e tij dhe kureshitët e tjerë u bënë armiqë edhe më të ashpër dhe më të dëmshëm për vulën e pejgamberëve s.a.v.s. dhe shokët e tij.

Kur paria kureshite kuptuan se Ebul-Kasimit s.a.v.s. i dhanë betimin Ensarët (Evsit dhe Hazrexhi, fiset e Medinës) që ta mbrojnë atë ashtu si i mbrojnë gratë dhe fëmijët e tyre, u shtua edhe më tepër armiqësia e tyre kundër atyre që e pasuan.

Kështu shokët e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. ikën me fenë e tyre prej Mekës në Jethrib (Medine). Kurejshët filluan të ndiejnë se Muhammedi s.a.v.s. filloi të ketë përkrahës dhe shokë përveç muhaxhirinëve (banorët e Mekës). U frikuan që të dalë Ebul-Kasimi tek ata dhe e kuptuan se sikur ai të emigrojë në Jethrib, do t'i tubojë njerëzit në luftën kundër kureshitëve dhe do t'ia prejë rrugën tregtisë së tyre për në Sham (Siri).

Ata e vendosën që të marrin nga një djalë të ri, të fuqishëm dhe nga çdo fis, t'i jepet çdonjërit prej tyre nga një shpatë e mprehtë, pastaj ata të shkojnë tek Ebul-Kasimi s.a.v.s. dhe ta godasin si të ishin një trup, e kështu të shpërndahet gjaku i tij në të gjitha fiset, që kështu të mos kenë mundësi Benu Abdul-Mutalibët të luftojnë kundër gjithë popullit.

Kur nata mbuloi çdo gjë, u tubuan ata rreth shtëpisë së tij s.a.v.s., mirëpo ai doli tek ata duke u hedhur dhe me dorën e tij mbi kokat e tyre, derisa i Larti dhe i Plotfuqishmi u kishte marrë shikimet atyre, kështu që nuk e panë. Ai emigroi bashkë me Siddikun (Ebu Bekrin) në Jethrib, pastaj atyre iu bashkëngjiti edhe Ali Ibn Ebu Talibi, pasi që ktheu disa emanete te pronarët e tyre, ishin ato emanete te Kurejshëve që gjindeshin tek i Dërguari i All-llahut s.a.v.s..

Ebu Lehebi tepër i hidhëruar tha: mbisundoni shtëpitë dhe pasuritë e të ikurve në Jethrib dhe burgosni muslimanët e dobët që të mos u bashkohen vëllezërve të tyre.

Kur ndodhi beteja e Bedrit, dolën të gjithë kureshitët të çrrënjosin ekzistencën e Ibn Abdullahut s.a.v.s. dhe nuk mungoi nga ajo asnjë nga paria e Mekës, përveç Abdul-Uzza Ibn Abdul-Mutalibit. Ai në vend të vetin e dërgoi El-As Ibn Hisham Ibnul-Mugiren, i cili kishte luajtur me të bixhoz dhe kishte humbur pasurinë e tij. Pastaj, ai kishte luajtur me lirinë e tij, të cilën poashtu e humbi dhe kështu u bë rob i Ebu Lehebit, pasiqë fisi i tij, Benu Mahzumët, kishin refuzuar t'i dhurojnë atij katër mijë dirhem si këmbim për lirinë e tij.

I pari i cili erdh nga fushëbeteja e Bedrit në Mekkë ishte El-Hujseman Ibn Amr El-Huzaiu, të cilin Safvan Ibn Umejje e pyeti: çfarë ka pas teje? El-Hujseman Ibn Amri tha: pas meje ka erëra dhe fortuna, të cilat dyshohet të na çrrënjoshin prej Mekkës. Janë vrarë të gjithë ata që Muhammedi është lutur kundër tyre, shpatat e shokëve të tij kanë coptuar: Utbe Ibn Rebian, Shejbe Ibn Rebian, Ebul-Hakem Ibn Hishamin, Zem'a Ibnul-Esvedin, Ebul-Buhteriu, Umejje Ibnu Halefin, Nebihun dhe Munebbihun dy bijtë e El-Haxhaxhit, Handhale Ibn Ebu Sufjanin, dhe..

Të pranishmit në Qabe thanë: mjafton kjo që the? Pasha Latin dhe Uzan, kjo nuk mund të kuptohet!

Pak më vonë erdhën Amr Ibn Abdu Vuddi, kalorësi i arabëve dhe Ikreme Ibn Ebu Xhehli, të cilët të pranishmit i pyetën: çfarë ka pas jush? Ata u përgjigjën: kemi lënë pas nesh eshtra në mes të shkretëtirës, na janë coptuar mushkëritë tona dhe bashkë me këtë kemi lënë pas nesh armët dhe përgatitjet tona plaçkë për Muhammedin dhe shokët e tij.

Të pranishmit u habitën: a ka mundësi të kenë pësuar disfatë Kurejshët të cilët kanë dalë me përgatitjen dhe numrin e tyre të madh?! A mund të jetë e vërtetë se janë vrarë udhëheqësit e Kurejshëve? A ka mundësi që një grup i vogël të triumfojë mbi një grup të madh?

Nuk shkoi shumë dhe erdhë Ebu Sufjan Ibnul-Harith Ibn Abdul-Mutalibi tek i cili u ngrit Ebu Lehebi dhe i tha: eja tek unë, o djali i vëllait tim, sepse ti me siguri ke lajme të sakta, më trego si qe puna e njerëzve?

Ebu Sufjan Ibnul-Harithi tha: pasha All-llahun, posa takuam ata njerëz, menjëherë ua dorëzuam krahorrët tanë, na vritnin dhe na zinin rob ashtu siç dëshironin? **Megjithëkëtë, pasha All-llahun, nuk i akuzoj njerëzit, sepse ne takuam disa njerëz të bardhë në kuaj të larmë në mes të qiellit dhe tokës, të cilëve nuk u përngjante asgjë dhe nuk mund t'u dilte atyre përpara asgjë.**

Aty ishte prezent Ebu Rafiu, djaloshi i El-Abbas Ibn Abdul-Mutalibit, i cili tha: pasha All-llahun, ata ishin melekët. Atëherë Ebu Lehebin e kaploi urrejtja dhe hidhërimi, kështu që e goditi Ebu Rafiun me shuplakë të fortë në fytyrën e tij dhe ata u përleshën. Ebu Rafiu ishte njeri i dobët, kështu që Ebu Lehebi e rrëzoi për toke, iu gjuajt mbi gjoksin e tij dhe filloi ta godasë. Aty afër e ulur ishte Ummul-Fadl, gruaja e El-Abbas Ibn Abdul-Mutalibit, të cilën e kishin gëzuar lajmet e Bedrit, edhe pse burri i saj, El-Abbasi, kishte dalë i detyruar me Kurejshët që të luftojë kundër djalit të vëllait të tij s.a.v.s. Ajo me atë rast e kapi një shtyllë nga shtyllat e asaj dhome, e goditi me të Ebu Lehebin në kokën e tij dhe i tha: o armik i All-llahut, e konsideron të dobët, meqë i mungon zotri i tij?

Ajo me këtë rast ia gërvishi kokën Ebu Lehebit në një masë të madhe, kështu që ai u ngrit, duke tërhequr këmbët i poshtëruar derisa u ul në dhomë.

U kthyen grupacionet e ushtrisë kureshite dhe filluan pikëpyetjet: ku është Suhejl Ibn Amri? Thanë: e ka zënë rob Ebul-Jusr Ka'b Ibn Amr El-Ensariu. Ebu Sufjan Ibn Harbi tha: a nuk e ka parë askush djalin tim, Handhalen, apo djalin tim, Amrin? Thanë: i pari është vrarë, kurse të dytin e kanë zënë rob shokët e Muhammedit. Edhe Ummul-Fadli pyeti: çfarë ka ndodhur me Ebul-Fadlin (xhaxhai i Muhammedit s.a.v.s.)? I thanë: është zënë rob. Atëherë, Ummul-Fadli falënderoi All-llahun dhe bëri një sexhde falënderimi për Të.

Disfata e Kurejshëve në Bedr ishte një lajm që zbriti mbi ta si të ishte një murmurimë e cila ndezi zemrat e tyre me urrejtje, hidhërim dhe pikëllim.

Nuk kaluan shtatë net prej rastit kur Ummul-Fadli, gruaja e El-Abbas Ibn Abdul-Mutalibit, kishte goditur Ebu Lehebin me shtyllë në kokën e tij, derisa atë e goditi brizhtiza (el-adesë: e cila ishte një varrë e pashpresë për arabët), poashtu filloi të ankohej edhe Ummu Xhemilja, të cilën e rëndoi sëmundja, por megjithëkëtë, ajo mendonte si të nxitë kureshitët dhe arabët, si të ndezë zjarrin në gjoksa që të hakmirren për Bedrin, kështu që ajo vetë hypi mbi shtazën e saj të nxitojë në ndezjen e gjoksave me urrejtje kundër pejgamberit të Islamit s.a.v.s.. Por shtaza e saj u ngatërrua, ajo u rrëzua në tokë dhe e shkeli shtaza e saj. E bartën te shtëpia e saj, duke dhënë frymën e saj të fundit. Bijtë e Ebu Lehebit u larguan nga ai derisa vdiq, sikur të ishte një qen i çartur, xhenazja e tij mbeti tri ditë, duke mos iu afrua askush dhe pa e varrosur, e kur ata iu frikuan sharjes dhe fyerjes, kurse era e tij e ndytë kishte ngulfatur hundët, i bënë një gropë në të cilën e shtynë me një shtyllë dhe e gjuajtën me gurë derisa e mbuluan, sikur të ishte një prostitutë. Ummu Xhemilja iu bashkëngjiti burrit të saj, kështu që vdekja e Ebu Lehebit dhe e gruas së tij ishte mësim për të gjithë ata që kundërshtuan All-llahun dhe të Dërguarin e Tij:

“E s’ka dyshim se ata, të cilët e fyejnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, ata i ka mallkuar All-llahu në dun’ja e në ahiret dhe për ta ka përgatitur një dënim të dhembshëm.” (kaptina El-Ahzabë : 57).

A mund të ketë dënim dhe poshtërim më të madh se dënimi me zjarrin e Xhehennemit?